Zot' i mađ ε i vertεte kwrkoa drεjtesine, miresine, đenjεne, mer t' aferite, đε ndalon te ligate, te ɲauđate εđε djaλezite. Behi te drεjte nd' uđer te Zotit, mos ɲrisni bεn ε bεsen' ε fjalene, qe beni, se kini vene Zotne deɵmimetar. Mos i ɵembeλεni asâj gruase, q'ε drεđ mire ɲεne ɲa i çdriđεte ɲraɲe. Ay, qe bent e mirene đε i ɲrû bεse Zotit, no grua qofte, no buɲe, Zoti i fal ɳe jεte fat-barđe ε ɳe çɲerblim te mire.
Zoti eɵte mε ata, qe bejne miresine.
Kuɵ ben miresine, ε' ben per ɵɲirtit te tija. Kuɵ ben ligesine ε ben ɲer vεthε. Kuɵ mεr uđen' ε drεjte, dεl ne ɵɲetimt, kuɵ mergohεte sojε, vεtε n' aɲatit.
Mos u fole ɳεrezise mε te kεq, đε mos ε mos qerto,, ɲo fole mε ndεr. behu i ɲoɵtere ɲara syrεɵ ε ji ɲlot mε emblesire; đε kerko per ta nga Zoti meɵire.
Zot' i vertεte i ɳeh zemerat' ε ɳεrezise. Nuk' ε ɲerne ate, qe kđεhεte ndaj sojet, dukε ɲεndohure mε giđe zemer' ε dukε hεqure dore se ligaɵ.
Eɲu t'aferεt ate q'u duhεte, đε te varferεt, εɲu, ɳεrezise ç'u kε maɲ' ε ç'u kε hua; geme mos ε ɲriɵ ɲa ɲun' ε ɲa nεvoje. Πriɵesite jane te veλεzerit' ε djaλit. Ne mos u ndihç dot atyrε, qe kane nεvoje, fola ɲrâ fjaleń ε embele.
Mos ε ɵtrengo dorene ɵume, ɲo mos ε haɲ đε farε, sε Zoti hεr' i εɲ te mirate mε dore ɲlot ε hεre mε mase.

Mergohi nga kurverija, sε eɵte mekat′ turɲ i maƌ εƌε ɲun′ ε lige; vrasja eɵte mekat′ ε temεrete!
Lokmanit i fali Zoti urtesine; ɲa i ƌ ate birt:
Biro! Mos i bej ɵoke Πεrendise, sε eɵt ε maƌε mekate. Duaj aten′ εmemene. Bej miresine ε hiqu nga ligesite. Faliu Zotit εƌε bεso-jε . hiqi mε durim te keqijate ne te gεçine. Mos u fole kupe likɵt ɳεrezise ε mos ɵɲerndero ɳεri kupe. T′ εcurite mos ε ki kupe mε sqime, sε Zoti s′i do ata qe mbahεne te rende. Giko tâ vogelojɵ çaɲń ε tâ uɳe zene, sε m′i ligu i zerεvεt eɵte zer′ i gomarit. Nuke ɵεh si keλεt. Zoti natene ne ditet ε ditene ne natet?
I ɵɵh anijate si çjne dεne ɲer te gεture ƌuratat′ ε Zotit?
Kur ε ɲɵjελene valete ɲosi rεja, ɳεrezite i lutane Zotit mε bεs′ ε mε gide zemere; ɲo mε te ɵɲetuar′ ε mε te vene kembe ne tεrete, te ɵumet ε haɲojne!
O ɳεres! Ç′do ɳεri dotâ ɵohe ɵijeń ε vdekjεse! Γiƌe dote dεlni ɲerɲara Zotit te vertεte! I miri dote jεte ne ɲrehj′ ε me ɲaɲajse, i ligu me mundim ε me εketεɲe!
Mos vrisni kupe ɳeri. Mos vini dore ne ɵer te varferise. Eɲni ç′ kini folure. Kur matni mbuɵεni: ɵasene. Πεɵoni mε te drεjte; sεkjo u del mė mire. Mos hiq, mos ɵaj, mos qerto ε mos kaλεzo ɳeri kupe. Dote ɲyεti ɲer ç′do gė, qe kini bere, ɲer ç′do gė qe kini ɲare, ɲer ç′do gė qe kini deguare εɲ ɲer te giƌa.
Mos εceni dukε tundure mbi ƌėt. Te giƌa keto jane te liga ε te merzitura ndaj Zotit. Zoti eɵte ε vertεta vεte. S′i do te liqt′ ε geɳeɵtarete. Nem′ ε Zotit eɵte mi mundoɳesite.
Zot′ i vertεte n kâ ngaλure, dot u vdεse: ɲa dot u ngaλne se riɵ.
O ɳεres! Faljuni Zotit, q′eɵte ɳė ε i vertεte, Zot′ i maƌ meɵire- ɵume, Zot′ i giƌesise ɲa ɵok ε ɲa ndihmes. Eƌε beni miresine, qe te jinni fat-barƌe.
Lum ata qe bεsojne Πεrendine, q′i falεne mε ɲoɵtesi, qe s′ƌone kupe fjale turɲɵimε, q′ i aɲene varferise, qe s′ bejne kupe te ɲanƌe, qe mbajne fjalen′ ε besεne; εƌε mergohεne

nga giđe te keqijate. Ata jane ɳɛrezit' e Πɛrenđise.
O ɞɲirt' i mire! kđɛhu te Zoti yt i gezuare! S' ɛ ɞihni mɛ urtesi ɛ beri Zoti giđesine! ɞtijɛ ɞih ɛ ngaλ mɛ tė giđe bimerat' ɛ đɛut; yjt' ɛ hena levrijne mɛ urđerit te íí, ɛđɛ diɛλi i vjen ɲɛđ ɳe tjatri! Ner keto ki ɞume ɞeɳa ɲer t' urtete! Beri kafɞete, q'i ɲerdorni me ç'do ɲune! Beri driđet' ɛ ɲɛmete. Иani ç'u đa Zoti ɛ mos mbiλni farea' ɛ ligesivɛt mbi đέt te Πɛrendise. Zoti krɛu ɳɛrine nga balta! ɲasdaj nga ɳe ɲike uje beri ɲike gak, nga ɲik ɛ gakut bɛri ɳe coɲe miɞ, nga coɲ' ɛ miɞit krɛu kockate. ɲa i vɛɞi mɛ miɞera, đɛ nxori ɳɛrine ne jete! I đa ɲerjɛń ɛ dergimne, i đa mentt' ɛ zemerene! Ne giđe keto kâ mrsimɛ ɲer ata, qe kuɲetojne!
E tere giđesija eɞt' ɛ Zotit te vertɛte. Ajy ngaλ, ajy vdɛs, đɛ tɛk ajy kđɛhi gide se riɞ. Pɞt' i urt ɛ fuqi-mađ ɛđɛ meɞire-umes.
O: ɳɛres! Mos i hiqnipas djaλit ner ɲunera te liga đɛne mekat' ɛ ne turɲt. sɛ Zoti u ɞɛh. te mos iɞtɛ meɞir' ɛ miresi' ɛ tija ɛ mađɛ, dot' u mundontɛ ɞume.
Ata qe ɲunojne te keqijate, mundohɛne đɛ ne kete jɛte ɛđɛ ne tjateret.
O ɳɛrezit' ɛ Πɛrendise! Mos hiqni ne ɞteɲit te huaj kupe ɲa mape lɛje nga te zott' ɛ saj ɛ ɲa falur' atyrɛ, ne mos gɛçi ɳɛri, mos hyni brenda. N'u đençine mos hyni, ikeni: Uɳui syte kur hyni, ɛ kijɛni zemerene te qeruare.
Zot, i vertɛte urđeron ɛ đote:
Grate t' uɳine syt' ɛ te ruajne ndɛre. te mos pefɛjne kraheror' ɛ ɲulɲat' ɛ λerete ne te huaj.
Keâđɛni zemerene nga Zot' i vertɛte, te jinni fat-barδa. Lɛte martohɛne te ɲamartuarit' ɛ te ɲamartuarate. Eđɛ ɞerbetoret' ɛ ɞerbetorɛte, q'u ɞerbɛjne, martojini đɛ ɛɲuni gė nga ç'u fali Zoti. Ata qe s'kane gė lɛte pine ɲamartuare ɛ te ɲrɛsine sa t'u aɲe Πɛrendija, ɲot e qendrojne n' uđet te Zotit ɛ ne nɛrt te tyrɛ.
Mjɛr' ata qe đone fjale te liga ɲer grate ɛ ngrɛhine te ɲabene! sɛ Πɛrendija dot i mundoɳe.

O ɳεres! Mos ɕkεlni mi gurmet te djaλit, q'eɕte armiku juaj, sε Zoti dot' u gykoɳe. i miri dote gεɳe miresine, i ligu ligesine.
Te mirete dote jεne ne ɳrehjε ε ne ɲaɲajse ɳate Zotit. Engeλite dot' u done: Παq' ε Zotit qofte mi ju.
Te liqte dote ƌone: Ah te qenekεɕime bere balte!
Zot i vertεte eɕte drit' ε qiεjεt ƌε ε ƌεut. Ajo drit' eɕte si ɳe vatre, ne te cilet eɕte ɳe flake ɳe flake brenda ne ɳe qεlqε ne ɳe qεlqε si ɳ'yλ i ndriture; ajo flaka ndizεte mε vajt te ɳe druri te bεkuare; te ɳ'uλiri, qe s'eɕt' as nga linda as nga perendimi, ƌε vaji ndrin ɲa vene zjar, Pɕte drite ni drite. Zot' i vertεte hεq drεjt drites' se tija ata qe do.
Πunerat' ε te ligat ɕembeελjne me ɲe anije, ε cila eɕte ne mεst te rενε te hapura mi ɳe dεt te ƌελe, q'ε mbulojne valete kerceλime-ɕuma, pa mbi ata εƌc te tjεra vale ngrihεne, pasdaj ɳe mjεrguλe vjεn, pas asaj εpesire mi εpesire behεte! ɳeriuriu pat dorene ε s'ε ɕεh dot! Πo s'i ƌa Zoti ɳeeriut drite, ku dotâ gεɳe?
Nuk' ε di sε ç'jane ner qiej ε nde ƌε pefεjene miresin' ε Πεrendise! εƌε ɕɲεste, qe jane ɕɲεst, duke haɲure krahete! Ç'do gw di faljεn' ε ƌenjεn' ε levdates' se Zotit. Eƌε Zoti i di ɲunerat' ε atyrε.
Mberεteri ε qiεjvεt εƌε ε ƌεut eɕt' ε tija. S'kε vene rε s ii ɕtyn nga dalε rεte? qyɕ i mbeleƌ ε i baɕkon? ɲasdaj ɕεh qe pjεƌ nga gir' i tyrε ɕiu i ɕume! ngadiɕ u ɲriɕ syte ɳerezise vεtetim' ε gemimit!
Gerbetoret' ε Meɕire-ɕumit jan' ataqe gejne giƌeɳe miresine, ε s'bejne kupe te liga.
Ibrahimi i ƌa t' εt ε se ɕoqese; Zot' i vertεte eɕte ɳe, Zot' i giƌesise qe me krεu ε me kaλi n' uƌet te drεjte: qe m'uɕqεu ε m'εɲ te ɳi; qe me ɕeron kur jam i semure; qe dote na vdεs' ε te na ngaλɳe ɲraɲe; qe ɕɲrεs te me ndjεɳ' ε te me falɳe te mεrate kur te vεtε ndaj sojε.
Zot' εɲ-me fuqi ε ve-me me raƌet t' atyrε, qe jane te drεjte. Fal-me guhen' ε se vertεtese sa te ɲoɳ ε a te jem. Ve- me

ne kopɵtit te ɲrehjese. Ndjɛ-me t'im ate, sɛ eɵt i apatisure. Mos me turɲero ne ditet te mbledhjes' se ɳɛrezise. N' ate dite qe kamija ƌɛ femija s'hyn me ɲune; ɲerveç sɛ ɳe qe vjɛn mɛ zemere ɲa faj.
Hiqni ɲas bɛses' s'Ibrahimit mɛ zemere te barƌe.
Zoti eɵte mɛ mire-beɳesite.
Zot' i vertɛte krɛu giƌe ç'jane nde jɛte ƌɛ ɲraɲe giƌe hyjne ne git te ti. Dote kƌɛhi ndaj sojɛ. Faljuni Zotit mbrem' ɛ mengɛs; se ƌɛ ne qiej ɛƌɛ nde ƌėt maƌerija eɵt' ɛ tija, faljuni giƌeɳe. Sindekur ɵtijɛ ɵin ɛ ngaλ ƌɛn' ɛ vdɛkure, aɵtu ngaλ ƌɛ te vdɛkurite. Иe ɵeɳ' ɛ fuqis' se ti eɵte berj' ɛ ɳɛriut nga ƌėu, ƌɛ mbarim' i ti se giƌas' ɛƌɛ ɳe ɵeɳ eɵte kejo. Q'u ƌa grate, te cilate i krɛu juɵ, qe t'i kini ɵoqɛ; ɲa u ƌa daɵuri' ɛ miqesine. Kâ ketu mesimɛ ɲer ata qe mɛjtihɛne. Qiɛjte, ƌɛu, guhene, ndryɵim' i fytyravɛt, gumi, deɵir ɛ kamjɛse, vɛtetima, ɵiu, giƌe jane ɵeɳa ɲer ata qe kane ment.
Bupat ɛƌɛ grate qe jane se giƌa te Πɛrendise, qe kane bɛɵe, ɛ jane t emir' ɛ te drɛte, qe kane durimne, qe jane t' ulete, q' aɲene te varferɛt, qe s'hane pen' ɛ botese, qe jane zemere-barƌe qe kujtojne kurdohɛre Πɛrendine, dote kɛne ndjɛsen' ɛ uraten' ɛ Πɛrendise.
Levdate ɲast Ayj! Qe kruɛu giƌesine, te tere i beri ɲar, si lulɛte qe dalene nga ƌɵa aɵtu ƌɛ ɳɛrezia ɛƌɛ te tjɛrate qe s' i di ɳɛriu.
Pɵte ɳe ɵeɳe nata, kur vjɛn, ƌɛ ɳɛrɛzit' i mbulon ɛpesira. Pɵte ɳe ɵeɳe ɲrape ƌiɛλi, qe vjɛn ɲɛƌ me vɛthɛ. Eƌɛ hena, qe ndryɵohɛte gɛr sa benɛte si ɳe dɛg'ɛ ƌate ƌ'ɛ kƌryɛre ɲrɛj ɲɛmɛ. Diɛλi s' ɲerɲiqɛte dot mɛ henene, as nata s'baɵkonɛte mɛ ditene: ç do yλ ɲotaλohɛte me vɛthɛ.
Levdate ɲast' Ay, qe ka giƌesine ne dore! Γiƌe dote kƌɛhi ndaj sojɛ.
Nuk' iɵtɛ ɳe nga ɵerbetoret' ɛ Zotit mɛ bɛse. ndaloj ɳɛrezine nga te ligate ƌɛ u pefen nƌen' ɛ Πɛrendise.
Zoti ɛ ɵɲetoj Nλλuhne, q' iɵ me te drɛjte ƌɛ femijen' ɛ tija, ɲa te ligt'i mbyti.

Пaq' ε Zotit qofte ɲer jεte mi Nuhne!
Nga far' ε Nuhut iɵ Ibrahimi, q'iɵ nga ɵerbetoret' ε Zotit. I ɲru Zotit ɳe zemere te qeruare, u pεfεn ɳεrezise uđen' ε Zotit. Nεmruti ε hođi me zjart. ɲo Zoti ε ɵɲetoj. Пaq' ε Zotit te vertεte qofte mi Ibrahimne, mi Israhakne, mi Ismaile, mi Jakuɲni' ε mi Isufne đε mi gide te miret' ε mi gide ɵerbetoret' ε Zotit.
Isufn' ε hođe ne ɲustte veλεzerit' uđataret' ε nxope đ' ε ɵitue n' Egyɲte. Isufi s'jû aferua ligesise kupe, u fali đε fajne veλεzerεt, ɲa Zoti ε ndεroj đ' ε lartesoj. Kɵu uâ çɲerblεu Zoti miresine te mirevεt
Zoti ε đεɵ Musan' ε Harune, i ɵɲetoj ted y εđε kombin' ε tyrε nga te keqijate, ɲa u fali uđen' ε drεjte. Пaq' ε Zotit te vertεte qofte mi Musan' ε mi Harune. Dautit i fali Zoti zė te bukure đε daɵrin' ε Zotit ε uđen' ε drεjte đε mbrεteroj. Sylεmanit i đa urtesi te ɵum' ε mbrεteri te mađε. Te dy qεne ɵerbetoret' ε Zotit.
Пia ɲraɲ' iɵ i drejt' ε i mire đε ɵerbetor' i Zotit mε bεse.
Eđε Jonuzi, q' ε ɵɲetoj Zoti mε te mađt te ti nga ç'do pεzik. Kɵu đε Zaharia ε Jahjaj εđε tė' tjerė' te ɲar' ε te ɲasdajme qεne te vertεt' ε tw mire đε n' uđet te Zotit. Пer ç'do komɲ Zoti dergoj ɵerbetoret' ε tij, q' u pefyεne, uđen' ε drεjte. Иerezija te derguarit ε Zotit i mundoj, ɲo Zoti ata i ndεroj ε i lartesoj.
Пa i dergoj engeλine Marise, δ' ε ndεroj ate đε Kriɵtin' ε ɵerbetoret' ε tija. Пaq' ε urat' ε Zotit te vertεte qofte mi giđe keta ε mi giđe ɲεrezit' ε mire ditene qe lintne, ditene qe vdiqne, đε ditene qe dote ngrihεne se riɵ εđε ɲer jεte.
Levdate ɲASTE Zoti! Zot' i mađ ε i vertεte, Zot' i giđesise, q' eɵte mire-beɳe, meɵire- ɵume, dreite-đenes ε uđe-ɲefεɳes.
Engeλite, ç'kâ ner qiεj, ç'mba đεu, ε ç'gjendεte ne mεs te tyrε trεgojne Mađerin' ε Zotit đε đone levdatat' ε ti.
O ɳεres mεrni uđen'ε drεjte, beni miresine, ɲraɲsi nga ligesite, ε mos εceni mi gurmet te djaλit.

Zoti engeλεt u ƌa: faljuńi ɳεriut, gide engeλite J' ufale, veç djaλit s'ƌεɞ sε uhoq me te larta, andaj mori uemene. Πa giƌ' ataq' i vεne ɲas, jane te maλekuare. Faljuni Zotit te vertεte mε bεse te qeruare ε mε zemere barƌe.

Zot' i vertεte eɞt' i maƌ ε i larte, eɞte Zot' i giƌesise fuqi -ɞum' ε meɞires- maƌ. Иεrezite mire- beɳes s' jane ɳė mε te liqte. Πalεte mεjtohεne ɲake ɳεrezizija!

Zoti ka ƌene ƌipmeni, t'u ɲergigεm. Vertεt Πεrendija eɞte ɲlot meɞire ɲer ɳεrezine, ɲo mė te ɞumet' ε ɳεrezεt s'ja dine. Zot' i vertεte s' eɞte mundoɳes i ɳεrezise, ɲo eɞte ndjεɳes ε meɞire- maƌ. Nem'ε Zotit qofte mi mundoɳesite! Zoti eɞt'-ajy, q' u kâ bere! εƌεç' te bukure fytyre u ƌa! Qoft' i bεkuare Zot' i giƌesise!

Bejt' ε qiεjεt ƌ 'ε ƌεut eɞte ɲune m' ε maƌe sε berj' ε ɳεriut. ' Qiεjte εƌε ƌεu mer duart te Πεrendise jane si ɳe dore ɲluhur! Πo ɳεriu s'ε kuɲeton ç'eɞte Πεndija!

Zoti eɞt' i gaƛ' ε s'vdεs kupe, s' kâ as nisje as faut, as ɲjεƛ as eɞte ɲjεƛe, s'kâ as ɞok, as te ngare! Pate m' i maƌ nga ç'ɲandεh ɳεriu!

Kuɞ bent e mire ε kâ ɲer ɞɲirtit te ti, kuɞ bent e ligene ε kâ mi vεthε. E mira ƌ' ε liga s'dlene me ɳe vent.

Daɞuri ' e Zotit vlεnmė ɞume sε giƌe ƌuratate, q'u fal mε te maƌit te ti ɲεrezise. Daɞurin' ε Zotit ε ɳhin'ata. Q' ε bεsojne ƌε εɲεne farε tε Zotit s'bejne kupe turɲε, s' mapene kupe gė me qafe.

Иo ata qe ndjεjne fajtore ƌε u, bejne mir' atyrε, qe kane ɲare te lige syreɞ, jane mė te uruare. Ata qe mundojne ɳεrezine, qe bejne te ɲahiret' ε ɞtremberine, kane ne kete jεte ƌε ne tjatrete mundimε. Durimi ƌε ndjεsa jane mesimεt ε urtesise nde jεte, ɲo te ɲaditurite s' bindεue.

Ud' ε Zotit eɞte te doje ɳεrin t' emen' ε t' ane,

Mema ε mban ne barkut mε mundimε, ƌ' ε bijε ne jεte mε mundimε, baɲa ƌε te ƌenete sise, gεr sa ti xvjεrƌɳe, duane triƌεte muaj! Vjεn mė se fundi ɳεriu me vεthε; ɲa kur mbuɞ vjεtte, ahεrε i lutεne Zotit, dukε ƌene: Zot i vertεte!

Meso-me te ŋoh miresit′ ε tua qe me fale, be-me te ɲunoŋ te mirate, qe te ɲelqεjne: be-me fat- varđe ne femijet.
Keđεhεm ɲraɲe tεk ti, sε jam mε ata, qe jane n′urđrrit tėnt. Keta ŋεres do Zoti.
Iini giđe veλεzere ne mεst tuaj, mos ɲɵoni kupe me ŋ′ ane, ɲo behi te drεjte; bupate te mos qεɵin′ ε te ɲerqεɵine ɵoku ɵokne đε grate ɵoqεja ɵoqεne. Mos kini đε nakar ε zemerimε; sε ligesija s′vjεn ɲas bεsese. Mos dyɵmoni ɵoku me ɵokne, mos đoni fjalw te lige ε mos hiqni ŋeri tjaterine.
O ŋεres! Jinni giđ djεmt′ ε ŋe mεmε đ′ε ŋe atε.
Mjεre te liqte! mjεre vjεđaraku ε vjεđarakεja! đε te keqijte ε te ɲabεsete,qe do te jεne ne sketεɲet!
Te miret′ ε t′ urtete dote jεne afere Πεrendise ne ɲapajset.
Vaλ a jane ne ata qe dine mε ata qe s′dine! Zoti eɵte burim′ i giđesise, ɲa giđe ç′jane kđεhεne atjε.
Πεrendija eɵt′ r vertεte.
S′ε ɵihni giđesine: Qiεjte, đεne, kafɵete, rεte ɵine e giđeç krεu Zot′ i mađ ε i vertεte? Vini rε, ô te ott′ ε mendjεse! Γiđesija ɲefεn mađeriu′ε Zotit.
Zot′ i vertεte eɵte ɵum′ afere tε ŋεriu, ε di ç′ka me zemere, ç′mεtohεte đε ç′ben ε ç′đote.
Dy engej i pinc ŋεriu, ŋeri me te djađte, tjεteri me te men-gere; dy ɵkroŋes te uruare jane q′ u dine ç′gė beni! Γyq’ i Zotit eɵt′ i vertεte.
Me te kđdεre tε Zot′ i vertεte ç’do ɵɲirt do e gykohεte, đε dote geŋe çɲerblimu′ ε te miratεt đε mundimn′ ε te ligavεt. Te tera jane ɵkruare.
Mjɵre geŋeɵri! Q′ eɵte ne ɲaditjε te đελe!
Lum i drεjti q′ ε kâ zemerene tε Zoti, i εɲ liɲesit ε ati qe s′kâ. Πake ɵeŋa kâ vaλe mbi đεy′, qe pefεjne fuqira′ ε Πεrendise ɲer ata, qe kane ment?
Nuke kâ ne vεthεt tûaj? S′ i ɵihni?
Mjεre te ɲabεset′ ε zemrec-zεste?
Γiđesija eɵt′ ε Πεrendise, te mirevεt u εɲ te mirate, te liqte s′ gεjne vεr, se ligese.

Zot' i vertεte krεu ɳerine, i ƌa fjalene ne guhet, diελi ƌε hena leverijne ɲas urƌerit te Zotit. Beri qiεjte, vû ɲεϐene, Πεϐene mε te drεjte. Druret' ε lulεte i falεne Zotit. Beri ƌεne per giƌe kombεte, mi ƌεt jane bimerat' ε ɲεmet' ε lulεte m'εre te mire.
Miresin' ε ɳεriut` εƌε çperblin' ε miresise Zoti sε humbεt kûɲe, sε Zoti kâ meϐire te maƌε ε ndjεse te ϐume.
Vuri vdεkjεne Zoti, ɲo ne vent t' atyrε, qw vdεsene, bijε te tjεre,q' u ngaj' atyrε, qe qεne gaλ me ɲare. Πa munt te sjελe ƌε ata vεte se riϐ me fytyre tjatere. E dini vaλe ç'qεte mė pare? Ajy u ngaλ ƌε u vdεs, ɲa u ngaλ se riϐ.
Nuke kini vene rέ ɲunet' ε bujqesise? S' ϐihni lulεte si mbijne se riϐ?
Kuϐ i εɲ buke kaλirit? Kuϐ ε xbret ϐine nga rεtε?
Иa zini ngojε εmerin'ε ati Zoti mε zemere te barƌe!
Kujt i εɲ djalene Zoti, ε kujt vaϐene, a jâ εɲ te giƌa, ɲo ɲritεni mε gas ç'do gė q' u fal Zoti.
Sε Ajy ε di mė mire sε ju ɲunene.
Fatn' εƌε uϐqimn' ε ɳεriut ε εɲ Zoti, ɲo mos behi makute.
Γiƌesija trεgon Maƌerin' ε Zotit. Ajy eϐte krεji, ƌε fundi.
Zot i maƌ ε i vertεte eϐte mε ju kudo te jinni; ɲa u ϐɲh ƌε di giƌe ç'beni; di fort bukure çmba zemr' ε ɳεriut εƌε ç'i vjεn ner ment.
Kuϐ if al Zotit hua! ɲ' ajy dote jû çɲerblεɳe mε dy ɲjεse.
E ϐihni sa ε ndεroj ɳεrine mε inentt ε mε fytyret, q' i ƌa.
Te mirete arijne me ϐkaλe te larte ndaj Zotit, ɲo te liqte ε ϐɲijεne vεthenn' ε tyrε ne funt te pukuλimese.
O Иεri! Zoti andaj te ƌa ment, qe te mεndohεϐ.
Qero zemerene, mo ski nakar ε meri εmos i bej ɳεriu kupe likϐt: ndruhu nga giƌe te keqijate.
Vertεt s'ε mbaron kup nde jεte urƌeri' ε Πεrendise. Πo Zoti kâ meϐire ϐum' ε ndjεse.
Nuke ndalihεt' ε mir' ε Zotit kupe: Ciu bijε, lumeɲte pjεδene: ƌεu mblεron, bimerate pitεne; arate vεϐti, koɲϐti, ε giƌe ƌεn, barerat ε drurete mbahene mε miresit te Zotit.

Mjɛr ajy, qe ɲɛɵon mɛ te ɲabɛse! Zoti vaλe s'ɛ ɲɛɵon ɲunen' ɛ tija.?

Beni miresin' ɛđ' ɛɲu-ni atyrɛ, qe s'kane, ɲa kujtoni ɛđ Πɛrendine, sɛ miresite i do Πɛrendija' đɛ te varferite jane t'aferit'ɛ Zotit

Mjɛr' ajy, qe ka makuterin' ɛ ɲanginɛsine! Mjɛr' ajy, qe qeɵ ɛ ɲerqɛɵ ɳɛrezine! Mjɛr' ajy, q'i falɛte Zotit ɲer faqɛ!

O ɳɛres' mos dɛlni kupe nga uđ' ɛ Zotit ɛ mos undani nga e drɛjta đɛ nga ɛ vertɛta.

Nga Zoti mos ɛ ɲrisni ɵɲrɛsene; n'u arđe ɳ' ɛ kɛqɛ, ɲas asj vjɛn δ' ɛ mira.

Πer dieλin' ɛ ɲer dritet, q' ɛɲ, ɲer henen' ɛ ɲer diten' ɛ ɲnatene, ɲer qiɛjt' ɛ ɲer ate, q'i beri, ɲer δɛn' ɛ ɲer te zotne, ɲer Πɛrendin' ɛ ɲer ɵɲirtine, ajy, q' ɛ mbɵ ɵɲirtine te qeru-are, dote jɛte fat-barđe, ajy, q'ɛ nx in, dote jɛte fat-zi.

E Πɛndis' ubeite.

| Ne faqɛ | rađe | te laditura | te drɛjtuara |
|---|---|---|---|
| 4 | 12 | Παrendi | Πɛrendi |
| 9 | 4 | merqon | mergon |
| " | 18 | jɛtene | jɛte ne |
| " | 20 | mireɵine | miresine |
| " | 21 | ligosine | ligesine |
| 12 | 3 | sitesit | ɵitesit |
| " | 4 | Hik | Hiq |
| 13 | 17 | qa | qe |
| 16 | 11 | zemere, Ati Zoti | zemere, Ati Zoti |
| " | 14 | vjɛen | vjɛn |
| " | 18 | hapesiret | haɲesiret |
| 17 | 26 | gravɛ | gravɛt |
| 18 | 1 | paɵure | pasure |
| " | 10 | etrembere | etrembera |

| | | | |
|---|---|---|---|
| " | 13 | qarjɛt | ɵarjɛt |
| " | 25 | tuat | tuaj |
| 19 | 4 | ɛƌ´ ates´ | ɛƌ´ ɛ ates´ |
| " | 20 | eɵtɵ | eɵte |
| " | 26 | guqi | guri |
| 20 | 6 | memese, | memese |
| " | 7 | vɛledijen´ | vɛtedijen´ |
| " | 12 | Doijni | Dojni |
| 22 | 16 | ƌuhɛte | duhɛte |
| " | 32 | knjdɛse | kujdɛse |
| " | 33 | perɲiɳi | perpiqi |
| 25 | 13 | iƌure | hiƌure |
| " | 23 | parɳehɛre! | perɳehɛre |
| 26 | 22 | jɛtevɛt | jɛtevɛt |
| " | 32 | drit | drite |
| " | 33 | nxjep | nxjer |
| 27 | 26 | qeqoɳ´ ɛ | qeroɳ´ ɛ |
| " | 30 | miresi | miresia |
| 28 | 28 | giƌe | giƌe |
| 29 | 15 | e' ɛp | ç' ɛɲ |
| " | 29 | kuqe | kûpe |
| 31 | 12 | vrasija | vrasja |
| 34 | 17 | mendjɛne, ɳɛh | mendjɛne, ɳɛf |
| 35 | 10 | eɵt´ ɛ vertɛta; | eɵt ɛ vertɛta; |
| 37 | 24 | veλɛzrveɛ | veλɛzrveɛ, |
| 39 | 32 | ti beɳe | t'i beɳe |
| 40 | 24 | Gqiɳetarevɛt | Gqipetarevɛt |
| 44 | 32 | uzure mi uzurɛ | ozure mi ozure, |
| 47 | 15 | heto | keto |

**H. Vehbi Dibra**

# Pjesë nga komentimi i sures "Fatiha"[1]

"Ihdinas-sirratal-mustekime. Na ço o Perëndi në rrugën e drejtë". Për të marrë vesht mirë e me hollësi kuptimin e këtij ajeti të naltë le ta vështrjmë pikësëpari fjalë për fjalë. Në kët ajet katër fjalë: a) ihdi, b) na, c) es'sirrata, d) el-mustekime. Fjala e parë "ihdi" asht kallzusi foljnër në mënyrë urdhënore qi çfaq lutjen, dëshirën dhe kërkesën tonë prej Perëndis. Fjala e dytë "na" asht përemën i vehtes së parë të numrit shumës dhe del kundrina e zhdrejtë e fjalis. Fjala e tretë "es sirrata" asht emën dhe kundrins e drejtë ase plotsor vendi si mbas shqipes. Fjala e katërt "el-mustekim" asht mbiemën qi cilson emnin. Pra si mbas këtij spiegimi kuptimi i versetit del kështu: "Na kallzo o Perëndi rrugën e drejtë" ose "Na ço o Perëndi; na pri, o Perëndi; na udhëhiq, o Perëndi, në rrugën e drejtë". Për tu ftillue mirë ky ajet asht nevoja të zgjanohemi; por lutemi te mos merziteni deri sa te dalim ne drite; sepse sikur mos të japim shkoqitjet e duhura, çashtja mbetet e errët dhe pa u zbërthye. E kemi thanë shpesh herë, vëllazën, se misioni i njeriut asht i naltë dhe plotsohet tue kapërcye disa etapa, disa shkallë, të cilat e përcjellin njerin kah amshimi i pasosun. Mbassi amshimi asht i pasosun edhe misjoni i njeriut asht i pasosun. Njeriu sat ë jetë gjall ka detyra, prej të cilavet nuk mund të shkarkohet, për pa u shkarkue nga fryma. Nga detyrat të cilat asht ngarkue njeriu, ajo ma e nalta mund të quhet me të vërtetë misjon ase ideal, asht " me njoftë Zotin". Këjo shkallë nuk mund të arrihet për pa njoftë edhe "rrobnin t'onë".

1. *Zani i Naltë, 6-7, shkurt-mars 1934, f. 169-176.*

Çvlerë ka ideja e jonë qi kemi formue për Zotin, në qoftë se ne nuk e dijmë vehten se jemi robët e Tij e se gjithmonë kemi nevojë për të? Kemi njoftë Zotin, në qoftë se kemi kutue mirë katër versetet e para të sures së Fatihaës deri në versetin "Maliqi jevinid-dini --- Ti, o Perëndi, je i Zoti i ditës së gjygjit". Keni njoftë robnin tonë, paaftësinë tonë dhe nevojën qi kemi për Zotin, në qoftë se e kemi kuptue mirë versetin " Ijjaqe naëbndu ve ijjaqë nesteinu ---Vetëm Ty, o Zot, të falemi e vetëm prej Teje, o Zot, kërkojmë ndihmë". Kur ti kemi bashkue këto dye tape të njohuris sonë, kur ta kemi njoftë Madhnin e Zotit tue mos harrue edhe robnin tonë vjen koha me shijue pemën e me pa dobin; atëherë themi "Ihdinas-sirratal-mustekime---Bana hidajet sirrati mustekimin, na kallzo rrugën e drejtë".
Çdo me thanë "Hidajet"?
Mbas Kadi Bejzavit(R.A) "Hidajet" don me thanë "me kallzue rrugën me të mirë e me të vutë. Llojet e hidajetit janë shumë, por farët e hidajetit janë katër:

1. Mendja dhe shqisat, me të cilat dallojmë të mirën e të keqen. Shqisat janë të jashtme e të mbrendëshme. Muteqel-liminët i mohojnë shqisat e mbrendëshme por skanë të drejtë.
2. Argumentat, me të cilat dallohet e vërteta nga gënjeshtra. Cilat janë këto argumënta? Krijesat objektive janë faktet qi na kallzojnë pushtetin krijues.
3. Profitët edhe librat e shenjtë.
4. Me diktue mnë zemër të msheftat dhe tinzit me të cilat kuptojmë realitetin e objekteve; I shofim gjanat si janë në të vërtetë e jo sin a duken mbas perdes. Këto çfaqje lejnë në zemër me tri mënyrë; a) me vahj, b)me ilham, c) me andra të vërteta.

Vahji(revelasioni) me ilhamin(inspirasioni) ndryshojnë midis tyne. Vahji asht për Profetët e Ilhami për të shenjtët. Vahji asht direkt, pa ndërmjetës, si vahji qi ka marrë Profiti ynë i Naltë natën e Miraxhit; edhe indirekt, me

ndërmjetës, me anën e Engjillit Xhebrail. A na lejnë neve kësi sekretesh, a ndijmë në zemrat tona? Perëndija na zgjoftë nga gjumi! Le të biem nji herë nji shehadet: "Esh-hehu en la ilahe il-la-llah ve esh-hedu enne Muhammeden abduhu ve Resulibil!"

Nga llojet e Hidajetit qi përmendëm ma sipër, ma i nalti asht Vahji e Ilham-i. me vahjë janë ba bidajet Pejgamberët e me ilham janë ba hidajet evlijat, njerzit e shenjt. Për këto njerëz të naltë e të lumtun urdhënon Perëndija me Madhni të vet në Kur'an: "Pejgamberët, edhe Evlijat si trashgimtarë të Pejgamberëve—vetëm këto i ka ba hidajet Perëndija". Si merret vesht nga ky verset i Kur'anit fara e katërtë e Hidajetit asht e posaçme vetëm për Profitët e për të shenjtët. Në këtë farë të Hidajetit ne skemi pjesë deri sat ë jemi avam; po mundëm me u naltësue, atëherë shpresohet se mund të na epet pjesë edhe neve. Perëndija na baftë në këtë kategori! Amin. Qe kjo asht rruga qi quhet "sirati mustekim" e qi e lusim kur, tue falë këndojmë versetin "Ihdinassiratal-mustekim"—o Zot na ban hidajet "si rati-mustekim" na difto rrugën e drejtë qi të njofim të vërtetat e gjanave. Qi të mbrijë njeriu në këtë shkallë duhet të bajë nji luftë të madhe me veset e liga e ta rruajë vehten jo vetëm nga haramet, por edhe nga gjanat e errta e të dyshimta. Për këtë pikën e fundit ka urdhnue Hazreti Pejgamberi në këtë Hadithi-Sherif: El-hallalu bejjinun velharamn bejjinum ve bejnehuma muste-shabihatun la jeëlaemuha qethirrun minennasi". Dmth: "Hallalli asht i qartë edhe harami asht i qartë; midis tyne ka gjana të errta e të dyshimta, të cilat shum njerëz nuk munden me i dallue a janë hallall a janë haram". Dijetarët e fesë i dijnë shume hollë këto pika por avamët e laikët skane dijeni kështu shum herë tue mos pyetë dijetarët kompetentë veprojnë me kokë të vet edhe e gjejnë be-lanë nga injoranca e nga krenija. Për shembull, nji gjuetar plagos nji shpezë e cila tue ikë fluturimthi vije në nji

urdhë a knetë. Gjuetari qi e ndjek, kur shkon në vend e gjen pa shpirtë gjahun e tij. tashti ky gjah po pat dhanë shpirt para se të bije nujë hahet, se asht hallall e po që mbytë në hurdhë a në kënetë, numrohet e ndordhun dhe nuk hahet se asht haram. Mirë po këtë gja nuk mund ta dallojë gjuetari i paditun; prandaj asht ma mirë qi most a hajë mbasi asht gja e dyshimtë. Kush rruhet nga dyshimi ka rrujtë fenë, shëndetin edhe nderin; aj qi srruhet bije në haram. "A doni nji shembull praktik?" ---urdhnon Resuli i Madh: "Ky njeri i ngjan atij bariu qi kullot dhent afër arës së tjatrit; asht afër menç se këto dhen mund të jyjnë narën të tjetrit." Sa mbretni ka në botë kanë kufit e tyne të caktuem e sdurojnë tu shkelen kta kufi. Kufit e Mbretnit të Hyjnueshëm janë haramet, kush guxon me shkelë nji urdhën të Zotit, ka shkelë kufinin e Mbretit të Gjithësisë e përashtu asht ba armik me Perëndin të Cilit smund ti ja dalë. Prandaj për haramin qi ban nji njeri duhet të pendohet shpejt, të hjekë dorë dhe ti lutet Perëndis qi ta falë. Tue punue haramet nxihet zemra dhe bahet e egër, e cila nuk shkëlqen ma; aty nuk ep dritë ma ndërgjegja. Njeriu qi ka zemrën të nxime e të ndryshkët asht për tu qa e për tu vajtue i mjeri; se ka humb nji thesar të çmueshëm; sensibilitetin e shqisavet të mbrendëshme, me anën e të cilavet njeriu mund të vjen në marrëdhanje me jetën e amshueëme, sikurse vjen në mardhanje me natyrën fizike me anën e shqisavet të jashtme.

Ç'asht zemra?

Zemra asht nji cop mish mbrenda në krahnuër; asht nji organ me randësi kryesore, ku varet jeta fizike. Ky organ rregullon lëvizjen dhe qarkullimin e gjakut. Sa ma i fuqishëm të jetë ky organ aq ma i shëndoshë e ma i rregulltë asht trupi e gjymtyrët; e kur ky organ çrregullohet e prishet çrrëgullohet e prishet edhe trupi me gjymtyrët tjera. Në këtë prgan ep dritë shpirti i amshuëm prandaj ktu i ndijmë fuqit shpirtnore, si vullnetin, energjinë, simpathi-

në, mëshirën, konshiencën e ndërgjegjen morale. Zemra e kullueme dhe e pa përlyeme fiton aftësin me i analizue e me i dallue rrezet e dritës shpirtënore me këtë mënyrë nisin me u kristalizue misteret e jetës së amshueëme. Vëllazën të dashun! Duhet ta dijmë se zemra asht panorama, ku veshtron Pushteti i Amshuëm; asht pra Empiri i vërtetë "Arshihakiki". Edhe në natyrë ka nji arsh, qi quhet "Empirmi formal ---Arshi Suri e qi përmendet në versetin "Er-rrahmanu alelarshisteva" qi shqip thuhet: "Perëndija ka hypë mbi fron". Hasha kjo sbahet kurrë; sepse Perëndija ska nevojë për fron; por këtu kuptimi asht metaforik dhe ka për qëllim me kallzue hijerarkin e autoriteti i tij qi asht shkalla ma naltë e hijerarkis. Mbas këtyne spjegimeve merret vesht se dometlianja e versetitt asht: "Perëndija asht i Zoti i Arshit, i Empirit". Arshi simbas filosofis së moçme asht nji enë madhështore qi ka mbështjellë gjithsin. Këtij arshi të moçmit i kan thanë "Feleqi Altllas". Arshi Hakiki(Fron i Vërtetë) i thonë zemrës. Cili asht ma i madh? Antyrisht Empiri real, Froni i vërtetë arshi Hakikija Zemra. Empiri formal asht vetëm "Mazhari Rahmet" domethanë asht shkëlqye vetëm me një lloj drite hyjnore, vetëm me dritën e mëshirës sepse në Kuran asht urdhnue "Er-rrahmanu alalarshi steva – All-llahu asht mbi fron.". Kur vijmë ke arshi hakikija ke zemra, ndryshou puna, këjo asht ba maz-har në të gjitha cilësit e amshuëme; kjo ka edhe "vetdije-shumr". Shkallën ma të naltë të kësaj vetëdije e lypim ne kur themi "Ihdinas-sirratal-mustekime"—O Zot na ban hidajet në rrugën e drejtë!".

Të zgjanohemi pak në këtë pik që të kuptohemi mirë: Manifestat e pasosuna qi çfaqen si objekte të natyrës, çjanë vallë? Këto janë pasqyra nëpër të cilat do ta shofim e do ta kuptojmë sekretin e vërtetë a pot ë vërtetën sekrete. Njeriut të pajuëm me vetë dije i duhet me njoftë të msheftën e mbulueme nën maskën e objekteve të natyrës. Të gjitha

gjanat janë nga nji pasqyrë e cilësivet të Zotit. Perëndija ka cilsië(attribute) e gjithsija asht libri ku duken këto cilësi të pasosuna të Zotit të pasosun. Gjithësija asht kuti e cilsitë e Zotit janë perlet dijamantët, inxhitë. Na duhet pra ta çelim kutinë e ti shofim këto inxhi. Çdo gja asht nji petkë, mbrenda së cilës asht mbështjellë nji cilsi e Zotit. Urdhnat e dispozitat e Sheriatit janë nga nji isharet për të vërtetën, e cila nuk asht gja e veçantë nga sheriati. Kush don me mbri në hakikat duhet me ndjekë pikë për pikë Sheriatin. Pa përshkue nëpër portën e Sheriatit nuk mund të gjindet rruga qi përcjellë të e vërteta. Të këthehemi te vetvetja: Shpirti asht si qielli e trupi si dheu. Midis tyne gjindet zemra, ku përpiqen këto dy bota. Zemra asht kutija ku shifen tinzit hyjnore. Punët e Perëndis nuk kanë shkak, por qëllim. Qëllimi i krijimit të njeriut asht që ta njofi Zotin e jo qi të hajë e të pijë. Duhet pra ti pastrojmë zemrat, ta njofim Zotin, ti hajmë rrobni eja mbaj urdhënat. Njeriu nuk e din vehten se asht nji pasqyrë për cilësit e Zotit. Pejgamberi Alejhiselam urdhënon: "Men arefe nefsehu fekad arefe Rab-behu" —Kush din vetvehten qi asht nji pasqyrë për cilësit e Zotit, e din me të vëretë Zotin". Njeriu asht gja e madhe asht arka e emanetit e duhet me ja dijtë vleftën vehtes. Duhet me ndjekë rrugën e Kuranit e me u largue nga cilësit shtazore. Në këtë udhë na përcjell drita e Hazreti Muhamedit Alejhisselam.

**Hafiz Ibrahim Dalliu**

# Qabeja është për të gjithë njerëzit[1]

*[Ue idh xhealnel-bejte methàbeten lin'nàsi ue emnen uet'tekhidhù min mekàmi Ibrahijme musal'len ue ahidnà ilà Ibrahijme ue Ismàijle en tah'hirà bejtije lit'tàifijne uel-àkifijne uerr'rruk'kei-s'suxhùdi]*

«I dashuri Im! Kujtoje edhe atë kohë, kur Ne, me madhërinë Tonë, e bëmë Qaben (Bejtin) vend shpërblimi (thevabi) e kthimi për njerëzit, e bëmë edhe vend të sigurt. (Ju që vizitoni Qaben) bëjeni Mekamin e Ibrahimit vend për t'u falur! Ne e kishim urhëruar Ibrahimin dhe Ismailin që ta pastronin shtëpinë Time (Bejtin) për ata që e vizitojnë, për ata që rrinë aty dhe për ata që bëjnë ruku e sexhde».

### *Shpjegime*

Fahri Raziu thotë se "Bejti" është për Qaben dhe për Haremi Sherifin që është rreth saj, sepse vend thevabi e sigurie nuk është vetëm Qabja, por edhe i gjithë Haremi Sherifi.

Qabes i është thënë Shtëpi e Zotit për nderim, por jo se ajo, me të vërtetë është vendbanim për Zotin. Asaj i është thënë edhe <u>Methabe</u>, vend thevabi sepse vizitorët e saj fitojnë thevabe të mëdha duke çuar në vend një detyrë të rëndësishme të fesë; është edhe vend kthimi, sepse

1. Titulli është i redaksisë. Marrë nga: Hafiz Ibrahim Dalliu, "Ajka e kuptimeve të Kur'ani Kerijmit", Tiranë, 2005, Sure "Bekare", ajetet 125-129, f. 134; Sure "Ali Imran", ajetet 96-97, f. 355-360.

vizitorët kthehen kah Allahu me gjithë zemër, duke lënë pas shpine gra e fëmijë, shtëpi e pasuri e gjëra të tjera; është vend kthimi, sepse vizitori ka dëshirë e qëllim të kthehet e të vijë përsëri në Qabe.

Qabes bashkë me rrethinat e saj i është thënë edhe vend sigurie, sepse ai që hyn aty, është siguruar prej armiqve të vet; madje edhe në kohën e padijes (xhehaletit, injorancës, para Islamit), ishte zakon që brenda Haremi Sherijfit nuk prekej as gjakësori.

Qabeja e madhërueshme me të vërtetë, është një vend dobish fetare dhe jetësore, sepse aty kryhet Haxh'xhi, që është njëra nga shtyllat e Islamit dhe aty fitohet shpërblimi i posaçëm. Në kohën e Haxh'xhit aty bëhen tregti e fitime; për Haxh'xh ndreqen e riparohen udhët; aty bisedojnë njëri me tjetrin banorët e qyteteve të ndryshme dhe i kuptojnë nevojat e shoku-shokut.

Mekami i Ibrahimit, është vendi i gurit që Ibrahimi vinte nën këmbë, kur ndërtonte Qabenë dhe ngrinte muret; vinte gurin e s'kishte nevojë të vinte gjë nën këmbë.

Ky urdhër për ne është Istihbàb, domethënë, ta bëjmë Mekami Ibrahimin vend faljeje, pra është mustehab dhe jo farz.

Pastrimi i Bejtit është: pastrim i saj nga idhujt dhe nga ndyrësitë.

<u>Taifijnë</u> u thotë atyre që vizitojnë Qaben dhe bëjnë Tavaf në të. <u>Akifijnë</u> quhen ata që rrinë e banojnë aty. (ruk'ke'i-s'suxhùd) është për ata njerëz që falen.

* * *

*[Ue idh kale Ibràhijmu rab'bixh'al hadhà beleden àminen uerzuk ehlehù mine-th'themeràti men àmene minhum bil'làhi uel-joumi-àkhiri kàlù ue men kefere feumet'tiuhù kalijlen thume adtarr'rruhù ilà adhàbi-n'nàri ue biësel-mesijru].*

«Kujtoje, o Muham'med, edhe atë kohë kur Ibrahimi (lutej e) tha: "O Zoti im! Bëjë këtë (Bejtin e rrethinat e saj) një qytet të sigurt (prej të gjitha fatkeqësive e frikës); ushqeji banorët e këtij qyteti me lloje të ndryshme frutash; ata që i besojnë Zotit e ditës së fundit (të shohin shpërblimin e besimit këtu në dynja)". Allahu urdhëroi e tha: "Edhe ata që mohojnë, do t'i ushqej për një kohë të shkurtër, pastaj me dhunë do t'i fut në ndëshkimin e zjarrit. Sa vend i keq ëshë ai ku do të shkojnë ata!"

Fahri Raziu thotë se qëllimi i të madhit Ibrahim ishte të lutej për gjithë popullin e Mek'kës, sepse ai vend është i thatë, në të as nuk mbillet e as nuk korret gjë. Prandaj, ai u lut që t'i ushqejë Zoti me mëshirën e vet, por pastaj e përveçoi lutjen vetëm për besimtarët, kur kujtoi se si imamati edhe ushqimi i dynjasë të ishte i veçantë për besimtarët. Allahu i tha se ushqimi në dynja është edhe për mohuesit derisa janë në këtë jetë, kurse në ahiret, ata do të vuajnë ndëshkimin e mohimit.

* * *

*[Ue idh jerfeu Ibrahijmul-kavàide minel-bejti ue Ismàijlu rab'benà tekab'bel min'nà in'neke ente-s'semij'ul-alijmu].*

«I dashuri Im! Kujtoje edhe atë kohë kur Ibrahimi e Ismaili i ngritën themelet e Bejtit (dhe u lutën kështu): "O Zoti ynë! Pranoje prej nesh (punën që bëmë). Ti je Dëgjuesi i (lutjeve tona) dhe Ti je Dijësi (i punës sonë)».

*[Rab'benà uexh'alnà muslimejni leke ue min dhurr'rrijetinà um'meten muslimeten leke ue erinà menàsikenà ue tub alejnà in'neke entet-tev'vàbu-rr'rrahijmu].*

«(At e bir thonë përsëri) O Zoti ynë! Ne të dy na bëj që të jemi të bindur ndaj urdhrave Tuaj! (Na bëj të qëndrueshëm në sinqeritet) thjeshtësinë e qëllimit, që ne ta

kryejmë adhurimin vetëm për kënaqësinë Tënde. Edhe nga pasardhësit tonë krijo një grup të bindur; na e trego edhe mynyrën e adhurimit e të punëve të haxhit tonë! Pranoje edhe teuben tonë! Pa dyshim, Ti je Pranuesi i teubes dhe Mëshiruesi i madh!».

*[Rab'benà ue-b'ath fijhim resùlen minhum jetlù alejhim àjà-tike ue jual'limuhul-kitàbe uel-hikmete ue juzek'kijhim in'neke entel-azijzul-hakijm]*

«O Zoti ynë! Dërgo tek ata (te njerëzit e bindur) një pejgamber nga mesi i tyre që t'u lexojë atyre ajetet e Tua dhe t'u mësojë atyre librin e hikmetin (urtësinë), t'i pastrojë ata (prej shirkut e prej fajesh të tjera); pa dyshim, Ti je i vetmi ngadhënjyes (askush nuk mund të të shmangë kurrgjë) dhe Ti çdo punë e bën me vend (hikmet)».

### *Shpjegime*

Bejzaviu, Hazini e Fahri Raziu thonë se fjala "resùl" është për Pejgamberin më të fundit; sepse prej skotës së Ismailit, përveç Pejgamberit tonë, nuk është dërguar asnjë Pejgamber tjetër. Pra lutja e Ibrahimit dhe e Ismailit është pranuar te Zoti. Pejgamberi ka thënë: *"Un jam lutja e Ibrahimit, sihariqi i Isait*[2] *dhe ëndrra e nënës sime"*. Kjo fjalë e shenjtë e forcon kuptimin e mësipërm.

Ëndrra që kishte parë nëna fatlume e Pejgamberit është si më poshtë:

Kur është afruar lindja e Resulull'llahut, e ëma pa në ëndërr një nur (dritë) dhe nën ndriçimin e tij, prej shtëpisë asaj i janë dukur pallatet e Damaskut.

Fjala ajet, është për ato argumente që tregojnë se Allahu është Një dhe se Muham'medi është i Dërguari i Tij, si dhe për ato ajete që kanë zbritur nga Zoti dhe

2. Sihariqi i Isait do të shpjegohet kur të përkthejmë suren "Es'sàf'fàt".

që Pejgamberi ia kumtoi ym'metit të vet. Libri është për Kur'anin; hikmeti është për dituritë fetare që plotësojnë shpirtërat njerëzorë, që dallojnë të drejtën nga e shtrembra dhe hallallin nga harami.

Në këtë ajet është treguar se Pejgamberi ka mishëruar në vet-vete të gjitha cilësitë që kërkohen për të plotësuar të metat e shpirtit njerëzor, sepse herën e parë është thënë: Ai t'i lexojë ym'metit ajetet që janë thelbi i sheriatit, t'i mësojë dispozitat e librit dhe çështjet fetare që janë të zbritura nga ana e Zotit dhe kështu t'i shpëtojë prej errësirës së padijes (xhahaletit); më pas, thotë t'i mësojë hikmetin, i cili shërben për punët e dynjasë dhe të ahiretit dhe, më në fund thotë që t'i pastrojë prej adhurimit të idhujve (shirkut) dhe prej fajesh të tjera të ndyra.

*[In'ne-s'safà uel-mervete min sheà'iri-l'làhi femen haxh'xhelbejte evië-temere felà*
*xhunàha alejhi en jet'tav'vefe bihimà khajren fe in'ne-ll'llàhe shàkirun alijmun]*

«Safaja dhe Merveja janë nga shenjat e fesë së Allahut; nuk rëndon ndonjë mëkat mbi këdo që bën nijet të kryejë haxh e umre, nëse bën tavàf në ato të dyja (dy kodrat). Kush dëshiron të bëjë ndonjë të mirë përveç tavàfit, (ajo i shpërblehet prej Zotit), sepse Allahu është Dhënësi i shpërbli-mit për punët e mira dhe Ai i di punët e robve».

Kuptimi: Dy kodrat e vogla, që janë në Mek'kë dhe që quhen Safà e Merve, janë shenja të vëna prej Zotit për të kryer njerëzit disa veprime të haxhit dhe nuk janë shenja padituri (xhehaleti). Ai njeri që do të kryejë haxh ose umre, nuk bën ndonjë mëkat nëse ai bën tavàf në këto dy kodra. Kushdo që bën ndonjë punë të mirë (nafile) jashtë punëve të detyrueshme, arrin shpërblimin (thevàbin), sepse Zoti është Shpërblimdhënësi për punë të mira dhe Ai i di shumë mirë punët që bëjnë robtë e Tij.

## *Shpjegime*

Komentuesit e Kur'anit thonë se shkaku i zbritjes së këtij ajeti është si vijon:

Në kohën para Islamit (e xhehaletit), në kodrën Safa ishte vendosur një idhull me merin Isaf dhe në kodrën Merve ishte vënë një idhull tjetër me emrin Nàile. Idhujtarët rrotulloheshin rreh këtyre dy kodrinave për të adhuruar dy idhujt. Por, pasi u çlirua Mek'ka, me urdhër të Pejgamberit edhe këto dy idhuj u thyen si të gjithë idhujt e tjerë. Ndërkaq, për dy idhujt e dy kodrave myslimanët patën dyshim dhe thanë: "A thua duhet bërë apo nuk duhet bërë tavàf në këto dy kodra?" Atëherë, për të hequr dyshimin e myslimanëve, Zoti zbriti ajetin dhe thotë: "Safaja e Merveja janë shenja të vëna nga ana e Zotit për të kryer ritualet (menàsiket) e haxhit dhe nuk janë shenja të kohës së xhehaletit.

"Haxh" në arabishte do të thotë "bëj nijet". Por këtu është për veprimet e haxhit që kryhen në kohë të caktuar e që janë:

I. Ihràmi; II. Vukùfi; III. Tavàfi.

Ihràm do të thotë "bëj nijet dhe them" (Leb'bejkell''àhume leb'bejk…).

Vukùf do të thotë "qëndroj në malin Arefàt ditën e Arefes".

Tavàf do të thotë "Rrotullohem shtatë herë rreth Qabes".

Ashtu siç u theksua më lart, haxhi kryhet në kohë të caktuar. Ka edhe një haxh të vogël që quhet umre, për të cilën nuk ka kohë të caktuar dhe kryhet në çdo muaj me këto veprime:

Ihràm, Tavàf, Saëj, Halk ose Taksijr.

Saëj është shkuarja e ardhja shtatë herë nga kodra Safa në kodrën Merve.

Halk është rruajtja e flokëve.

Taksijr është qethja e flokëve.

Veprimet e haxhit janë (farz) për çdo mysliman e myslimane që është në gjendje financiare dhe trupore për ta kryer këtë detyrë të shenjtë; kurse umrja është sun'net. Përveç (Menasikeve) që u përmendën më lart, haxhi e umre kanë edhe veprime të tjera që janë vàxhib ose sun'net.

Fahri Raziu thotë se tri janë detyrat që Zoti u ka ngarkuar robve:

I. Detyra për të cilat çdo njeri i mençur gjykon menjëherë se janë veprime të mira, për shëmbull, të përmendësh Zotin. Këtë urdhër i mençuri e gjykon menjëherë se është i mirë; sepse njeriu duhet patjetër ta përmendë e ta lavdrojë Atë që e ka nxjerrë në dritë e që i ka dhënë të gjitha të mirat.

Zoti ynë i ka theksuar të mirat e kësaj bote me urdhrin: (Fedhkurùnij edhkurukum)

II. Detyra për ta pranuar si të mirë diçka që nuk duket e tillë. Ka nga ato ndodhi që mendja e njeriut për herë të parë i shikon si të këqia e të dëm-shme, si p.sh: pësimet, sëmundjen, zinë, varfërinë etj. por kur Zoti thotë në Kur'an se këto ndodhi janë paracaktime (kader) e sprova të Zotit, me anën e të cilave kuptohen e dallohen të mirët e të këqijtë; gjithashtu edhe Pejgamberi thotë se në të tilla ndodhi ka shumë urtësi (hiqmete) dhe dobi, atëherë mendja e besimtarit i pranon për të mira, bën durim dhe nuk ankohet për to. Për këto lloje ndodhish, Zoti thekson në ajetin:

*[Ue lenebluvekum bi shej'in minel-khoufi…]*

III. Detyra të cilat mendja e njeriut nuk mund t'i gjykojë as për të mira e as për të këqija, si p.sh, haxhi e umrja etj. Mirëpo kur sheriati e tregon dhe thotë se të tilla detyra janë urdhra të Zotit dhe po t'i kryesh, ke shumë dobi, atëherë edhe mendja e pranon se ato janë të mira. Këtë pjesë të detyrave Zoti e ka theksuar në ajetin:

*[In'ne-s'safâ uel-mervete…]*

*[Kul sadeka-ll'llàhu fet'tebiù mil'lete Ibràhijme hanijfen ue mà kàne minel-mushrikijne]*

«(I dashuri Im!) Thuaju (atyre): Zoti ka thënë të vërtetën; prandaj ndiqni fenë e Ibrahimit, e cila ishte fe e pastër nga të gjitha ligësitë dhe Ibrahimi nuk ishte prej idhujtarëve».

* * *

Jehudinjtë e kundërshtonin profetësinë e Muham'medit, alejhis'selàm në dy pika. E para, se nuk bëhet anulim e as nuk është bërë ndonjëherë anulim në dispozitat e Allahut. Këtë thënie të jehudinjve e hodhi poshtë Zoti duke thënë se anulim dispozitash ka pasur edhe në sheriatin e tyre. E dyta, ata thoshin se Bejti Mukad'desi (Shtëpia e Shenjtë), që është më e virtytshmja e faltoreve të botës dhe kiblja e të gjithë pejgamberëve, meriton të jetë kible për të gjithë njerëzit: prandaj, nuk bën me u kthye nga Qabeja gjatë faljes së namazit! Për t'ua hedhur poshtë edhe këtë e për të treguar edhe shkakun e ndërrimit të kibles, që atyre tu largohej dyshimi dhe për t'iu thënë edhe se ju o jehudinj bashkë me të krishterët pretendoni se jeni në fenë e Ibrahimit, por nga ana tjetër e përbuzni kiblen e tij dhe, vajtja në Qabe është nga veprimet e Ibrahimit, por ju nuk shkoni atje, Zoti urdhëron e thotë:

*[In'ne ev'vele bejtin vudia lin'nàsi lel'ledhij bibek'kete mubàreken ue huden lil-àlemijne. Fijhi àjàtun bej'jinàtun mekàmu Ibràhijme ue men dekhalehù kàne àminen ue lil'làhi ale-n'nàsi hixh'xhul-bejti menistetà'a ilejhi sebijlen ue men kefere fe in'ne-ll'llàhe ganij'jun anil-àlemijne]*

«Shtëpia më e parë (më e ndershmja) që është caktuar për të gjithë njerëzit (për të kryer adhurimet e urdhëruara), është ajo që gjendet në Bek'ke. Ajo është shumë e uruar dhe udhërrëfyese (kible) për të gjithë njerëzit. Aty ka shenja të dukshme (që vërtetojnë se ajo është udhërëfyese). Ndër to është mekami i Ibrahimit. Kushdo që futet aty, është i siguruar (nga sulmi i armikut dhe nga çdo cënim); për (të fituar) kënaqësinë e Zotit, është bërë farz për njerëzit vizitimi i kësaj Shtëpie, për cilindo që ka mundësi të shkojë atje. Por kushdo që bëhet qafir (duke mohuar Zotin, ose duke mohuar detyrën e shenjtë, ose bëhet mosmirënjohës duke mos e kryer këtë detyrë), le të bëjë si të dojë, sepse Zoti nuk ka nevojë për asgjë të asnjë bote». Dhe jo më të ketë nevojë për adhurimin e atij që nuk e kryen detyrën.

## *Shpjegime*

*[In'ne ev'vele bejtin vudia lin'nàsi lel'ledhij bi Bek'kete]*

«Shtëpia më e parë që është caktuar për të gjithë njerëzit, është ajo që gjendet në Bek'ke…». Po. Më e ndershmja ngrehinë, më e vjetra ngrehinë në faqen e dheut, për të kryer të gjithë njerëzit adhurimet e urdhëruara, është ajo që gjendet në Bek'ke. Ajo është faltorja e parë e ndërtuar për t'u falur aty çdo fis e çdo popull, i çdo feje qoftë.

Pra, Qabeja, është faltorja e parë që është ndërtuar për të gjithë. Sa për faltoret e tjera, ato kanë qenë ndërtuar që aty të falej një fis ose një komb që ishin të së njejtës fe.

Kur e kanë pyetur Pejgamberin "cila faltore është ndërtuar më e para?" Pejgamberi, alejhis'selàm, ka thënë: "E para faltore është Qabeja, që ka ndërtuar Ibrahimi dhe pas dyzet vjetësh është ndërtuar Bejti Mukad'desi".

Fahri Raziu thotë: Për ndërtimin e parë të Qabes, janë

thënë fjalë të ndryshme. Por fjala më e vërtetë është se Qaben e kanë ngritur për herë të parë melekët me urdhrin e Zotit në shëmbëlltyrën e Bejti Maëmurit që është në qiell, dhe është ndërtuar para se të krijohej Ademi, që ai ta kishte atë kible në faljet dhe për të bërë tavàf të gjithë njerëzit rreth saj. Në sheriatin e Ademit, të Shitit, të Idrijsit dhe të Nuhut ka pasur falje me sexhde, dhe në të tilla falje, doemos që duhet një kible, një vënd për t'u kthyer në drejtim të tij. Më vonë, në tufanin e kohës së Nuhut, ajo ngrehinë ëshë ngritur. Për herën e dytë atë e ka ndërtuar i madhi Ibrahim bashkë me të birin, Ismail.

Nga kjo frazë e ajetit, nënkuptohet se faltoret e vjetra janë më të virtytshme se të rejat, sepse Zoti e vërtetoi Qabenë më të virtytshme se Bejti Mukad'desi. Fraza «In'ne ev'vele bejtin» u përkthye edhe me fjalët: (Më e ndershmja ngrehinë është Qabeja), Por, mund të thuhet se më e ndershmja ndërtesë në botë është Bejtull'llàhi, sepse Urdhëruesi i ndërtimit të saj është vetë Zoti, arkitekti i saj është Xhibrijl emijni dhe ndërtuesi i saj është i madhi Ibrahim, me të birin, Ismailin si shegert. Këto virtyte as nuk janë në ndonjë ngrehinë tjetër në botë dhe as që mund të jenë më vonë.

Qabeja është caktuar për të gjithë njerëzit. Po. Qabeja, është për të kryer aty adhurimet e urdhëruara të gjithë njerëzit.

«Lel'ledhij biBek'kete». Është ajo që gjendet në Bek'ke. E Bek'ke është qyteti i Mek'kës.

Disa thonë se Bek'ke quhet vendi, në të cilin haxhinjtë bëjnë tavàfin, rrotullimet rreth Qabes dhe Mek'kë është emri i gjithë Haremi Sherifit- vendeve të caktuara që njihen në atë qytet.

Vendit, ku është ndërtuar Qabeja dhe rrethinës së saj i është thënë "Bek'ke", për arësye se aty mblidhen njerëzit me shumicë. Thuhet edhe se Mek'ke quhet Qabeja, kurse Bek'ke është emri i atij qyteti.

*«mubàreken»*

«Shumë e uruar». Po. Qabja është shumë e begatshme dhe e vlefshme, si për banorët e saj, ashtu edhe për ata që vijnë nga jashtë. Rrethina e saj, është një vend i thatë, ku nuk mbillet e nuk korret asgjë. Megjithkëtë, aty kurrë nuk përjetohet zi e ngushticë për të ngrënë, etj. Ajo është shumë e uruar, sepse adhurimet që kryhen aty kanë shpërblime më të mëdha se adhurimet e kryera në vende të tjera.

Fahri Raziu thotë: Sa i uruar është ky vend, merret vesh kur njeriu të mendohet se ajo është një pikë qendrore. Rradhët e njerëzve që drejtohen andej janë si vargjet që e rrethojnë atë pike. Pra, kur njeriu e sjell parasysh se sa milona njerëz janë kthyer në drejtim të saj për të falur namaz, ndër të cilët, doemos ka edhe eulija, njerëz të shenjtë, shpirtkulluar e zemërndritur, atëherë e kupton se ai vend është shumë i uruar.

*«Ue huden lil-àlemijne»*

«Qabeja është edhe kible udhërryfyese për të gjithë njerëzit». Po. Qabeja është si një shtëpi që tregon se të gjithë njerëzit duhet të kthehen në drejtim të saj kur ata falen.

*«Fijhi àjàtun bej'jinàtun mekàmu Ibràhijme…»*

«Aty ka shenja të dukshme (që tregojnë se ajo është më e respektuar se faltoret e tjera) dhe, ndër këto shenja është edhe mekàmi i Ibrahimit».

"Makami i Ibrahimit", është për gurin që e vinte ai nën këmbë si skelë, kur ndërtonte Qaben dhe ngrinte muret e saj. Ai gur është zbutur në atë kohë dhe Ibrahimit i kanë humbur këmbët në të deri në nyja.

Pra, qenia e gurit në Qabe tregon qartë se ajo është më e virtytshme se Bejti Mukad'desi: Qaben e ka ndërtuar

i madhi Ibrahim dhe Bejti Mukad'desin e ka ndërtuar i madhi Sulejman; por, dihet se Ibrahimi është më i virtytshëm se Sulejmani.

*«Femen dekhalehù kàne àminen»*

«Dhe kushdo që futet në të, është i siguruar (nga sulmi i amikut dhe nga çdo cenim). Po. Ndër shenjat e dukshme që janë në Qabe, është edhe kjo: kushdo që hyn aty, është i siguruar nga sulmi i amikut dhe nga çdo cenim tjetër, sepse gjithmonë ka qenë zakon i arabëve që njeriu sapo të futej në Haremi Sherijf, nuk ngacmohej e nuk plaçkitej, as nuk vritej prej asnjë njeriu; ky zakon i moçëm, është ruajtur deri në ditët e sotme.

Transmetohet se i madhi Ymer ka thënë: "Sikur të shihja në Haremi Sherijf edhe vrasësin e babait tim, nuk do t'i bëja asgjë".

Ajeti nuk flet e nuk tregon se prej kujt është i siguruar ai njeri që futet në Qabe. Prandaj mund të thohet edhe se njeriu që futet aty, është i siguruar edhe prej sulmit të armikut, edhe prej ndëshkimit të Zotit në ahiret, pasi ai të kryejë detyrën e haxh'xhit, e patjetër, në qoftë se më pas nuk bën ndonjë gjynah të madh. Ky sigurim i njeriut, kuptohet edhe prej shumë fjalësh të shenjta të Pejgamberit.

Në këtë ajet Zoti është mjaftuar vetëm me tregimin e dy shenjave të dukshme - Mekani i Ibrahimit dhe sigurimi i atij që futet aty. Por komen-tuesit e Kur'anit kanë thënë se aty ka edhe shenja të tjera të dukshme:

1. Vizitorët e Qabes e shikojnë me sy: zogjtë vijnë në tufë për aty por sapo mbërrijnë mbi Qaben, shpërndahen dhe nuk fluturjnë sipër saj në tufë.

2. Në Haremi Sherijf nuk gjuajnë as zagarët e as skifterët, madje edhe kafshët e egra e shpendët e egër nuk e hanë e nuk e ngacmojnë njëri-tjetrin.

3. Në Minà, çdo haxhi gjuan dyzet e nëntë guralecë të sjellë prej larg. Atëherë aty duhej të bëhej një mal i tërë me guralecë, që gjuhen vit për vit nga qindra mijëra haxhinj. Por aty ka vetëm një sasi fare të vogël guralecësh. Se nga shpërndahen ato guralecë, nuk dihet. Aty afër nuk ka ndonjë zgavër që të thuash se guralecët futen aty, madje aty nuk ka as edhe ndonjë kodër që të thuash se aty fryn era dhe ajo i shpërndanë guralecët.

4. Aty nuk ka pasur mundësi të vijë as mbret, e as komandant që ta shembë e ta zhdukë Qaben. Ebrehenë me ushtrinë e tij (As'habi filët), që u afruan të rrënonin Qabenë, i vrau Zoti me gurët që lëshonin zogjt ebabijlë dhe kështu ai nuk mundi ta arrinte qëllimin. Kurse Bejti Mukad'desin e pati shembur dhe rrënuar Buhtu Nasri.

Në Qabe ka edhe shenja të tjera të dukshme.

* * *

Zoti, pasi tregoi virtytet morale e materiale të Qabes, për të treguar edhe se njerëzit duhet ta vizitojnë atë, urdhëron e thotë:

*«Ue lil'làhi ale-n'nàsi hixh'xhul-bejti menistetà'a ilejhi sebijlen»*

«Për të fituar kënaqësinë e Zotit, është bërë farz për njerëzit vizita e kësaj Shtëpie, për cilindo që ka mundësi të shkojë atje».

Po. Vetëm për të fituar kënaqësinë e Zotit, njerëzit janë ngarkuar me detyrën e shenjtë që të vizitojnë Qaben - kuptohet, kushdo që ka shëndet dhe mundësi financiare për të shkuar deri atje dhe për t'u kthyer prej andej.

Sikurse dihet, vajtja në Qabe për t'u bërë haxhi është urdhër i Zotit (farz), për ata njerëz që kanë mundësi financiare dhe janë të shëndetshëm. Ai që shkon në haxh, duhet të ketë pasuri që t'i mjaftojë për vajtje-ardhje dhe

t'u lërë edhe familjes e fëmijëve ushqimin e duhur derisa të kthehet pranë tyre. Ai duhet të jetë edhe i shëndetshëm, që të ketë mundësi të përballojë udhëtimin dhe lëvizjet e haxhit. Ndryshe, ai nuk e ka detyrë të shkojë atje.

Meqenëse kryerja e haxhit është njëra nga pesë shenjat e mëdha të Islamit, kur zbriti ajeti i mësipërm, Pejgamberi thirri myslimanët dhe disa jehudinj, pasi ata kishin thënë se ishin myslimanë. Pejgamberi ua kumtoi urdhërin e Zotit të gjithëve. Myslimanët e pranuan në çast, kurse jehudinjtë nuk pranuan të shkonin atje. Atëherë zbriti fundi i ajetit:

*«ue men kefere fe in'ne-ll'llàhe ganij'jun anil-àlemijne»*

«Por, kushdo që bëhet qafir (duke mohuar Zotin, ose duke mohuar detyrën e shejtë, ose bëhet mosmirënjohës duke mos e kryer atë detyrë), le të bëjë si të dojë ai, sepse Zoti nuk ka nevojë për asgjë në të gjitha botët». Dhe jo më të ketë nevojë për adhurimin e atij që nuk e kryen detyrën. D.m.th: Me u bë haxhi, është urdhër i Zotit dhe ai që e mohon Zotin, ose mohon se haxhi[3] është detyrë e shejtë, ose bëhet mosmirënjohës dhe nuk e falenderon Zotin për të mirat i ka dhënë, duke mos e kryer atë detyrë, ai le të shkojë ku të dojë dhe lë të bëjë si të dojë, sepse Zoti, jo vetëm që nuk ka nevojë për adhurimin e tij, por nuk ka nevojë për asgjë të asnjë bote.

Komentuesit e Kur'anit kanë thënë: Zoti, për të theksuar rëndësinë e vajtjes për t'u bërë haxhi, e ka përforcuar urdhrin me fjalë të rrepta. Ato tregojnë se ata që veprojnë kundër këtij urdhri, meritojnë ndëshkim tepër të rëndë. Dhe, ajeti përfundon me këto fjalë: "Por ai që bëhet qafir, le të bëhet, sepse Zoti nuk ka nevojë për kurgjë të asnjë bote". Pra, ai që e lë pas dore këtë urdhër, ka vepruar si ata që mohojnë Zotin, ose si ata që mohojnë urdhrin

3. Dhe kështu ai bëhet qafir (mohues).

e Zotit dhe kështu bëhet mohues e do të dënohet me ndëshkim të përjetshëm, ose bëhet mosmirënjohës dhe nuk e falenderon Zotin për të mirat që i ka dhënë; edhe në këtë rast, ai le të shkojë ku të dojë dhe le të bëjë si të dojë, sepse Zoti nuk ka nevojë për kurgjë të botës e jo më të ketë nevojë për adhurimin e një njeriu.

*"PËRKTHYESI":*

{Shumë vetave mund t'u shkojë ndër mend e të thonë: Përse vallë Zoti e ka forcuar aq shumë urdhrin për të shkuar në Qabe dhe i ka dhënë aq rëndësi vajtjes në Qabe për t'u bërë haxhi? Këtë pyetje e bëjnë më shumë ata që nuk i dinë qëllimet themelore të fesë islame, që janë: krijimi i paqes botërore dhe i vllazërimit të të gjithë popujve[4], duke vendosur një barazi të plotë në mes tyre dhe duke ndrequr e plotësuar moralet njerëzore. Këto qëllime të shenjta, kuptohen qartë nga ajetet e Kur'anit dhe nga fjalët e shenjta të Pejgamberit.

Pra, vajtja në Qabe, në atë vend të uruar e të sigurisë, ku mblidhen njerëz prej të gjitha vendeve jo vetëm që sjell dobi të mëdha shëndetsore, ekonomike, shoqërore e politike, por siguron edhe qëllimet e fesë islame; sepse në atë vend të uruar e të sigurtë, mblidhen njerëz nga të gjitha vendet dhe, pasi ata kryejnë detyrat e haxhit me qëllim e vetëm për të fituar këna-qësinë e Allahut, mësojnë e marrin vesht edhe për hallet që ka çdo popull dhe kështu mund të merren masat e duhura për nevojat e përgjithshme}.

4. Rrënjos në zemra një fe të ndërtuar mbi Njësimin e Allahut.

**Hafiz Ismet Dibra**

# Një tjetër fakt që vërteton qenien e Zotit*

Një tjetër fakt që na e vërteton e na e forcon idenë e qenies së Zotit është inspirata (*frymëzimi)* që duket ndër kafshët e insektet. Inspirata është cilësi natyrore; ajo duket në veprat e mrekullueshme të frymorëve, që habisin mendjen e njeriut. Po të studiohet me vëmendje mënyra sesi shtazët i rrisin të vegjlit, si i sigurojnë nga rreziqet, si kujdesohen për jetën e pjellës së tyre derisa t'i bëjnë të aftë të jetojnë me fuqinë e vet e pa ndihmën e të tjerëve, nuk mundet njeriu të rrijë indeferent (mënjanës) dhe të mos kërkojë Edukuesin e vërtetë e të ditur që u mëson këtyre nga një sistem të veçantë për çdo farë kafshe në përshtatje me rrethanat e jetës së tyre.

Materialistët e gjorë, kur pyeten se fazat e mrekullueshme të jetës së shtazëve dhe instinktet që u inspirohen, a nuk provojnë qenien e domosdoshme të Rregulluesit Universal, përgjigjen: "Këto cilësi të çuditshme që shihen ndër shtazë janë trashëgime të rrjedhura nga të parët e tyre." Kjo përgjigje na nxit të mendojmë se [1] nuk kanë ndërgjegje të kulluar, nuk kanë veshë e nuk kanë sy. Këta njerëz janë objekti, ku duket (gjen shprehje) ajeti kur'anor:

*"Khatemell-llahu ala kulubihim ue ala sem'ihim ue ala ebsarihim gishaue – Zoti i vulosi zemrat e veshët e tyre edhe në sy kanë perde e nuk shikojnë."* (Sure "El Bekare", ajeti 7)

**Titulli është i redaksisë. Marrë nga: Hafiz Ismet Dibra, "A ka dyshim në qenien e Zotit?", Tiranë, 2007, f. 109-118.*

Më tutje, materialistët, për të na mësuar edhe mënyrën

1. *Materialistët.*

sesi u shtjelluan e u plotësuan këto cilësi të shtazëve, thonë: Pas kalimit të një kohe shumë të gjatë, dalëngadalë, cilësitë e fituara u përvetësuan e u ngulitën vetvetiu te kafshët.

Natyrisht, është vendi për kritikën: Po përse vallë, cilësitë u plotësuan "pas shumë kohësh" e nuk u dukën qysh në fillim, kur nisi jeta e farës së tyre? E kanë menduar dhe e kanë pritur kritikën materialistët, prandaj, para se të pyeten, janë munduar të na përgjigjen: Derisa arritën në gjendjen e tyre të sotme, sasi të panumërta kafshësh të ndryshme janë zhdukur; ato që kanë mundur të shpëtonin, i janë përshtatur ligjit të evolucionit e modalitetit derisa janë normalizuar."

Dihet se këto përgjigje të papërligjura nuk mund ta kënaqin ndërgjegjen e njerëzisë. Megjithkëtë, në shekullin modern, shkenca është zhvilluar e zgjeruar shumë në çdo degë e ka bërë kërkime e zbulime të habitshme edhe në zoologji. Po të studiohen me pak kujdes këto hetime e zbulime zoologjike, shihet se para së vërtetës së diktuar, ashtu si shkrihet kripa në ujë, falimentojnë edhe bien poshtë të gjitha supozimet dhe hipotezat e pathemelta të materialistëve. Kur të paraqesim këtu më poshtë disa hetime zoologjike, do të kuptojnë lexuesit e ndershëm të "Zanit të Naltë" [2] se shekulli modern paralajmëron se doktrina e gabuar e materialistëve është kah perëndon përgjithmonë, sepse dëmtoi së tepërmi botëkuptimin e njerëzisë.[3]

Të marrësh një nga një të gjitha kërkimet dhe zbulimet që kanë arritur shkencëtarët nuk është punë që bëhet me disa konferenca të përmbledhura si këto tonat. Prandaj

2. Revista "Zani i Naltë" botohej nga Komuniteti Mysliman i Shqipërisë. Hafiz Ismeti i botonte konferencat e tij publike në atë (revistë).

3. Le t'i kujtojmë lexuesit tonë shkencëtarin bashkëkohor turk, Harun JAHJA, autorin e librit "Mrekullitë e Kur'anit", i cili, sot, pas më shumë se 70 vjetësh vërteton shkencërisht atë që thoshte profesori ynë i madh, Hafiz Ismet Dibra në konferencat e tij publike në xhamitë e Tiranës.

parapëlqyem të përmendim vetëm pak nga ato, që kanë bërë shkencëtarët më të rinj për insektet.

**Flutura**

Siç dihet, ky insekt, derisa zhvillohet që të marrë emrin *flutur*, kalon disa metamorfoza:

a) Flutura pjell vezët e saj përmbi një gjethe.
b) Krimbi del nga vezët dhe ushqehet me gjethe.
c) Nga krimbi del nusja (nimfa).
d) Nuses i dalin krahët dhe bëhet flutur.

Ta marrim në shqyrtim e të mendojmë. Edhe në këtë rast lind një pyetje: Si ndodh që, kur doli krimbi nga veza, nëna e tij, flutura, ishte zhdukur? Si e dinte flutura dhe kush ia pati mësuar fluturës që u zhduk se pjella e saj që do të dalë vetiu nga veza, në fillim ka nevojë të ushqehet me gjethe e prandaj i vendos vezët mbi fletët e gjelbra, mbi gjethe? Cili mund të jetë mësuesi i këtij insekti përveç një Parashikuesi të Amshuar?
Në këtë dukuri, a nuk shkëlqen sekreti i ajetit: "A ka dyshim në Qenien e Zotit?"

**Nekrofora**

Është një krijesë e njohur tash vonë. Kjo krijesë, porsa të pjellë vezët, ngordh. Nekrofora nuk e ka fatin ta shohë pjellën e vet, as pjella të ëmën. Është vënë re se para se të lëshojë vezët, nekrofora mbledh insekte të ngordhura dhe i depoziton atje ku do të pjellë dhe kështu i përgatit ushqimin e parë pjellës së vet. Kjo ngjarje a nuk dëshmon hirin e një pushteti misterioz? Me këtë fakt a nuk provohet sekreti i ajetit: "A ka dyshim në Qenien e Zotit?"

**Bombici**

Të vegjëlit e këtij insekti, porsa të lindin, kanë nevojë të ushqehen si parazitë në shtatin e shtazëve të tjera; prandaj e ëma i lëshon vezët në shtatin e shtazëve.

**Sfinksi**

Të vegjëlit e këtij insekti, me të dalë nga veza, kanë nevojë të ushqehen me lëndë me origjinë prej frymorësh të gjallë. Prandaj, e ëma, pasi i lëshon vezët, gjuan insekte, të cilat nuk i ngordh, por i rreh mirë derisa t'i trullosë e t'i bëjë të pazonja për të lëvizur vendit. Kur çelin vezët, pjella e re gjen gati gjallesat, me të cilat ushqehet.

**Eksileguja**

Ky insekt është një nga më interesantët që e habit tepër mendjen e njeriut me mençurinë e frymëzuar. Këtë insekt e studion Mil Eduardi, profesor i Universitetit të Sorbonës në Francë. Ai thotë: "Kjo kafshë e vogël fluturon në verë, jeton në vetmi, pjell vezët e veta pa prekur gjëkundi dhe ngordh sapo të lëshojë vezët. Eksileguja nuk e sheh pjellën e vet, as pjellat nuk e shohin nënën e tyre. Të vegjëlit janë larva pa këmbë e pa fuqi të mbrojnë veten, as nuk janë në gjendje të sigurojnë ushqimin e nevojshëm. Për të plotësuar zhvillimin fiziologjik, kanë nevojë të rrinë të qeta një motmot (një vit) në çerdhet e tyre, të cilat ua pati përgatitur e ëma kur ishte gjallë. Po qe se çerdhja nuk i përmbush kushtet e nevojshme, ky insekt kishte për t'u zhdukur. Prandaj, është interesant ta vështrosh çerdhen se me sa kujdes është ndërtuar.

Eksileguja e përgatit çerdhen duke punuar për një vit për të hapur një vrimë të thellë në një copë dërrasë. Pastaj nis të mbledhë nga lulet e nga gjethet e bimëve e të depozitojë shujtën (*ushqimin*) që do t'u lypset larvave për nji vit. Kur afrohet koha e lëshimit të vezëve, eksileguja nis të radhitë një pjesë të ushqimit në fund të çerdhes; aty lëshon edhe një vezë dhe e mbulon me brumin të cilin e gatuan me pluhurin e dërrasës që e siguron gjatë gërryerjes. Pastaj, mbi këtë brumë shtron përsëri një sasi ushqimi që ka mbledhur e mbi të lëshon vezën e dytë që, gjithashtu, e mbulon me brumin e pluhurit të dërrasës

si herën e parë. Duke e përsëritur disa herë këtë veprim shumë të kujdesshëm e shërbim të përkushtuar, arrin të ngrejë një ndërtesë me aq kate, sa është numri i vezëve që ka lëshuar. Pas këtij cikli veprimesh, eksileguja vdes. Të gjithë brezat që zhvillohen në çerdhen e familjes së tyre i përmbahen ecurisë së mënyrës së tyre të jetesës si edhe brezat pararendës. Ata e ruajnë me rreptësi racën e tyre.
Profesori Eduard që ka gjurmuar zhvillimin e këtij insekti dhe na informoi për shumë hollësira nga jeta e tij e çuditshme, shton: *"Kjo panoramë e mrekullueshme duhet t'i trondisë të gjithë ata që kujtojnë se krijimi i Gjithësisë ndodhi vetvetiu dhe papandehur."*
Përfundimi modest i Profesorit, që sapo e cituam, nga ana tjetër nënvizon edhe ligësitë e arsyetimit të atyre që e mohojnë Krijuesin rregullimtar dhe mëtojnë se Gjithësia qenka krijuar vetiu. Ky Profesor i lartë, me frazën e fundit a nuk i shtrohet ajetit të madhërueshëm: *"A ka dyshim në Qenien e Zotit?"*

* * *

Na duket vendi i përshtatshëm të paraqesim tani në formë deduksioni studimet e Dr. Gustav ZHULJESË për inspirimin (frymëzimin) e kafshëve. Doktor Zhulje, me veprën që ka hartuar kundër Darvinizmit e kundër përkrahësit të tij, Lamarkut, dëfton se zbulimet e reja janë kah udhëtojnë drejt idesë së divinitetit (hyjnorisë, të qenies së Zotit). G. Zhulje thotë: Frymëzimet që shihen në jetën e kafshëve, siç dihet, janë të panumërta. Edhe habia e mendjes përpara këtyre frymëzimeve është e pakufishme. Këto frymëzime i karakterizon një veçori e përbashkët: përpjekja për të siguruar jetën, por kjo përpjekje rrjedh vetvetiu e nuk është përfundimi i ndonjë arsyetimi logjik të shtazëve. Frymëzimi natyror e përcjell kafshën në nji finalitet (përfundim), ku nuk mund ta çojë

as mendja, as edukata, as koha e gjatë. Me fuqinë e këtij inspirimi, çdo kafshë ruan individualitetin (vetësinë) dhe farën e saj.

Duket se inspirimi është njësoj tek të gjithë individët e llojeve shtazore. Që ta tjetërsosh këtë inspirim është aq punë e vështirë sa tjetërsimi i llojit; prandaj themi se inspirimi është cilësia karakteristike dhe thelbësore e çdo lloji. Inspirimet shtazore janë të ndryshme, ashtu si ndryshojnë edhe organizmat fizikë të llojeve. Çdo inspirim i përshtatet natyrës së llojit. Inspirimet nuk janë as pasojë e seleksionimit, sikurse pretendon Darvini, e as pasojë e mjedisit sikur thotë Lamarku. Atje ku shfaqet më qartë inspirimi ndër qeniet e gjalla është jeta e insekteve.

Dr. Faber[4], në librin e tij që flet mbi jetën e kafshëve, ka provuar se me anën e teorive të Darvinit e të Lamarkut *është e pamundur të analizosh shkallën e ndryshimit të inspirimit të insekteve e patundshmërinë e këtij inspirimi;* në këtë të provuar ka parashtruar shumë argumente sensibilizuese (ndjeshmëruese). Bergson[5], dijetari i shkëlqyer i shekullit tonë (shek. XX) ka zbuluar një insekt të vogël me emrin *sitaris*, i cili i lëshon vezët e veta në çerdhen e një blete që quhet *entofer*. Nga këto vezë dalin dy krimba që rrinë në pritë dhe, porsa afrohet bleta mashkull, i ngjiten dhe jetojnë si parazitë në trup të saj (mashkullit) derisa vjen koha e çiftëzimit të bletëve. Kur përfundon procesi i çiftëzimit te bletët, krimbat shpërngulen nga meshkujt dhe u ngjiten bletëve femra, ku rrojnë si parazitë derisa pjellin bletët. Me të pjellë të këtyre bletëve, paraziti hiqet nga *bleta* femër dhe zë vend në vezët e bletës e kur çelin vezët, paraziti plotëson metamorfozën e parë dhe tani ushqehet me mjaltë.

Sa mrekulli! Sitarisi e di se në hojen (huallin) e bletës më

4. ***Faber*** *(Fabre, Fahbuhr, Jean Henri Casimir 1823 – 1915) natyralist francez, u mor tërë jetën me studimin e kandrrave dhe të merimangave.*
5. ***Bergson Anri*** *(Bergson Henry, 1859 – 1941), filozof francez.*

parë kalon mashkulli; e di edhe se mashkulli do të takojë me femrën kur çiftëzohen; e di se femra bën vezët; e di, më në fund se aty në atë çerdhe bleta do të sjellë edhe mjaltë. Habia më e madhe është se sitarisi ka dijeni se pjella di t'i ndjekë këto faza. Shekulli modern, duke hetuar dukuri të habitshme të inspirimeve shtazore, po i detyron dijetarët t'i binden me hir e me pahir Madhështisë së Zotit. Çelësin e këtyre zbulimeve të mrekullueshme ia ka dhënë Kur'ani i Madhëruar, i cili urdhëron në këtë ajet: "*Hatta idha eteu ala uadin nemli kalet nemletun ja ej-juhan nemlud-khulu mesakinekum la jahtimennekum Sulejmanu ue xhunuduhu ue hum la jesh'urun*", që do të thotë: Kur Hazreti Sulejmani me ushtrinë e tij arritën në një vend ku kishte shumë thnegla, një thnegël u tha shoqeve: *"O thnegla, hyni në tëbanat tuaja* e *mos rrini jashtë, që të mos ju shtypin Sulejmani e ushtarët e tij, që nuk dinë* (se jeni ju këtu)." (Sure "En Neml", 18)
Me këtë mënyrë Kur'ani i lartë, katërmbëdhjetë shekuj më parë na njofton punët e habitshme të insekteve dhe kjo gjë për njerëzit modestë e inteligjentë është një provë e qartë që dëshmon se burimi i kulturës së Hazretit Muhammedit është amshimi.

**Himenoptera**
**(Hymenopteres Gaboyeurs)**

Një tjetër gjallesë e habitshme, që dëshmon qenien e një Krijuesi Parashikues, është himenoptera.
Ky insekt, kur del prej veze, ka nevojë të ushqehet prej një qenieje tjetër të gjallë, e cila duhet që të mos lëvizë fare; përndryshe, po të lëvizë para çeljes dëmton vezët, e pas çeljes dëmton kandrrën (insektin, gjallesën e lindur). Nëna, që ta shmangë këtë rrezik, gjahun që zë, e injekton (i fut helmin) me një mënyrë që t'ia pengojë vetëm lëvizjen e jo ta mbysë.

Kjo gjallesë e vogël, për të arritur në qëllimin që u përmend, po të kishte pasur idenë e parashikimit, do të gjykohej se ka dituri tepër të hollë, sepse që t'ia zhdukë gjahut të saj mundësinë e lëvizjes, duhet të dijë sasinë e helmit që lypset t'i injektojë për këtë qëllim.

Helmi nuk duhet të jetë as më tepër, as më pak, veçse aq sa lypset; përpjesëtimi i helmit ndryshon edhe sipas strukturës së presë. Në anën tjetër, për të caktuar edhe vendin se ku duhet të bëhet injeksioni, lypsen edhe njohuri të hollësishme për anatominë e fiziologjinë. Mirëpo, insekti i vogël nuk e ka mësuar prej kujt mjeshtërinë e hollë e të çuditshme sepse nuk i sheh fare prindërit e vet, të cilët kanë ngordhur para se të lindte pasardhësi, ashtu sikurse do të ngordhë edhe ky para pasardhësve të vet. Merret vesh, pra se veprimet e çuditshme që vihen re te himenoptera, nuk janë rezultat imitimi, as edukimi; përkundrazi, janë cilësi që gjenden në natyrën e insektit. Para veprave të këtij insekti përulet mendja e njeriut dhe pohon se udhëheqësi i këtij insekti është frymëzimi i Zotit. Natyralistët thonë se ky inspirim është zakon shtazor që formohet dalëngadalë dhe, kur plotësohet, i mbetet trashëgim pjellës së re.

*Faberi*, që është një nga ata që kërkojnë hollësi për çdo gjë, *pretendimin* e *natyralistëve e gjen absurd* (*të pabazuar*) dhe thotë se, sado supozime që të pranojmë për nënën e parë të kësaj shtaze, prapëseprapë do të jemi të paaftë për të provuar origjinën dhe burimin e inspirimit që shfaqet te kjo gjallesë.

O natyralistë!

Rasti dhe nevoja - ashtu qëlloi dhe ashtu e deshi nevoja - që i keni pranuar si fillim dhe burim të të gjitha ngjarjeve të natyrës kurrsesi nuk mund të na e shpjegojnë se si femra e parë e *himenopterës* mundi të gjente qendrën e

sistemit nervor të gjahut të vet që kështu, të mos e mbyste prenë, por t'ia dobësonte funksionin e nervave që shkaktojnë lëvizjen. Nuk ka asnjë shkak që ta shtyjë këtë insekt të parapëlqejë qendrën nervore. Përse nuk mësyu më sipër ose më poshtë? Nuk mund të thoni: ky insekt, mbasi e mësyu prenë e saj në disa vende, ia qëlloi edhe qendrës nervore, sepse po të mos e qëllonte shenjën për herën e parë, ishte në rrezik. Insekti është i pagabueshëm në veprimin e tij, për të siguruar ushqimin e pjellës.
Me këto studime të gjata *Faberi na provon se natyra* e *krijuar te kafshët nuk* është *pasojë e rastit dhe e nevojës që ka qëlluar verbërisht e papandehur*. Dr. Gustav ZHULJE që na transmeton studimet e FABERIT, thotë se është e pamundur të shpjegohet se si e përdor ky insekt gjilpërën e injeksionit - thumbin e helmit - e si u duk në krye të herës kjo kafshë e vogël.
U zgjatëm mjaft me këtë çështje; prandaj, që ta mbyllim, themi se nga studimet plot kompetencë të dijetarëve që përmendëm, del që *teoritë për agjentët e natyrës që zhvilluan krijesat e Gjithësisë - teori të shpifura nga fantazia e Darvinit dhe e Lamarkut*[6], *janë kryekëput sofizma*.[7] Kur përpara mendjes sonë parakalojnë ngjarjet e ndryshme e të shumëllojshme të mbretëreshës "Gjithësi", nuk mbetet rrugë tjetër, përveçse t'ia atribuojmë Mjeshtërit dhe Krijuesit të Amshuar. Të gjitha këto çudira janë vepra të atij Zoti të madh që na e shpjegon Kur'ani me fjalën e Hazreti Musait në këtë ajet: "*Rabbunal ledhi a'ta kul-le shej-in halkahu thumme heda*" që do të thotë: **"Zoti ynë është Ai që krijoi çdo gjë, pastaj e drejtoi."** (Surja "TaHa", 50 )[8] [9]

6. ***Lamark*** *(Lamark), botanist zoolog francez (vdiq më 1829).*
7. *sofizëm argumentim ose përfundim logjik që duket i drejtë nga ana e jashtme, por që në thelb është i gabuar dhe përdoret për të shtrembëruar të vërtetën.*
8. *Shih edhe këtë përkthim: "Zoti ynë është Ai që i dha trajtën dhe natyrën e saj çdo gjëje (të krijuar) dhe më tej, i dha drejtimin (udhëheqësinë)."*
9. *Allahu e jep udhëheqësinë e Tij me anë të të Dërguarve të Tij dhe të Shenjave të Tij.*

**Prandaj:** "A *ka dyshim në qenien* e *Zotit*?" **i përgjigjemi: Me të vërtetë, nuk ka dyshim në qenien** e **Zotit. Prandaj duhet të besojmë se ka Një Zot.**

**H. Ali Korça**

# Kurani i Madhënushim e Thelbi i Tij

21 korrik 1926, Shkodër, Shtypshkronja "Ora e Shkodrës".

NJ'A DY FJALE

Para dhjetë vjet e vënë shumë lloje Tefsirë përpara pata shkruar gjërë e gjatë mjaftë tefsirë, por për qitjen e tij në dritë duheshin më shumë se dymijë napoljona; pra shtypjen e këtij e lashe për një kohë më vonë dhe tani për tani e pashë unë conveable (munasib) shtypjen e thelbit të H. Kur'anit. Nga menti s'jam larguar as pak, por me plotësuem kupëtimin kam shtuar edhe disa fjalë të cilat i kam shkruar me shkronja të shtrembërta. më shumë vise kam mbajtur edhe më not. Këndunojsit në faqen e djathtë kanë me këndum H. Kur'anin e në trajtët faqe kanë pa thelbin e palcën e tij me një mënyrë që të mos mërziten as pak. Zoti na ndihmoftë që ta qitim krejt në dritë sa të mundim pa gabim.

H. Ali

Sure[1] e Fatihasë[2] është Meqqore dhe përmban shtat' ajete.

1. Sure, quhet e ndamja e nji ndërtese pote-pate. Në Kur'an. Sure quhet një pjesë e Kur'an q' e pakta të ketë tre ajete. Ajet është një pjesë e Kur'anit qi fare pak si në këndim ashtu dhe në shkrim të ketë gjashtë harfe. Në Kur'an ka 111 Sure 6666 ajete.
2. Me qene se Kur'ani çilet me të dhe namazi fillohet me të qajt Fatiha, "çelës". ka edhe këto emra Mama e Kur'anit, Sure e Lavdërimit, S.Qafije, Vafije, se këndimi i saj mjafton nde nemaz. Thohet S.Methani, se ndahet në dy gjysma përshtjell gjysmën e thelbit të Kur'anit edhe tjetra gjysmën e thelbit të Kur'anit dhe tjetra gjysmën. Thohet edhe S.Shafije,

Me emrin e All-llahut mëshirë-math dhimsë-shumët.
Lavdërim a çdo lëvdim asht vetëm i All-llahu[3] [4] i Zotit të botëve, i mëshirëmadhit e dhimsë-shumëtit[5] i të vetmit Zot të ditës të pasosme.[6]A i të vetmit mbretit të ditës të çperblimit. vetëm ty të falemi edhe vetëm prej teje kërkojmë ndihme. Qëndrona nd'udhën e drejtë, nd'udhën e atyre q'u ke plotësuar mirësitë, jo nd'udhën e të mallkushmëve[7] t'atyre q'u ke zënë mëri edhe as nd'udhën e të humbëve t'aty, e qi kanë mbetur nd'errësirë. Pranoni lutjen!
Sure Bekare (Lopë) Medinore, ka 266 a 287 ajete.[8]
Me emrin e All-llahut mëshirë-math dhimsë-shumët.
Elif-lam-Mim[9] Ky qi po ju këndon Muhammedi është qitab i mbarushim qi dërgimi i tij është shënur në librat e para s'ka fare dyshim ndër të, nga an' e Zotit asht. Për ndrjtësit është udhërrëfenjës, ësht një drejt-tërheqje e

---

se asht shëndet; S. esas'se asht si rranj e Kur'anit, S. salat, se me të flat namazi, e tj....

3. në gjuht arabishte "el" jep këta kuptime si: El-hamdu 1) Lavdërimi 2) ç'do velvdim, 3 lloji levdim, 4 ç'quhet levdim etj...

4. Rabb, Zot, rabbu-l-mali i Zoti i mallit. Rabbu-l-alemin - I Zot' i botëve

5. maliq dhe meliq -- Zot ajy q'e ka ne dore. maliqu-l-muliq - ajy q'e e ka tokën ne dore. meliq thuhet mbret

6. Javmi din, dita e posaçme e ahiretit qi kanë me ngjan gjitha punët, e do të ç'perblehet ç'do e mirë e ç'do e keqe.

7. Jahudijtë të cilët vranë Pejgamberet dhe te miret.

8. Kjo sure është quajtur sure e lopës, se flet ma tepër përmbi çifutët e Medinese. Pra u kujton ngjarjen e lopës q'u kerkoj pët t'u therur në kohët të Muajit dhe i goditi se çifutët kanë patur vetije lopë aq sa viçin e artë të Samiriut e adoptuan Zoti e i u fallen e tij..

9. Për fjalën Elif-Lam Mim edhe si për shoqet e saja qi ndodhen përpara Sureve, fliten shume fjalë. 1. Janë disa shifra të mbylltta e rumuze të fellta midis Zotit dhe Pejgamberit të cilët quhen (arabisht) të përngjashme dhe që i di vetëm Zoti e Pejgamberi. 2. Mendjet me qene se janë shkallë-shkallë, atë q'e kupton Pejgamberi të tjetër smundin ta kuptojnë. Këto sjanë fjalë të kotta, domosdo nga jji thelb e kanë. Po ata qi thonë ri, nuk i rremojnë as pak; ata qi thonë se edhe na di ç'dimë mundohen edhe nji qilin nji thelb kshtu: "un jam Zot i ditçmi fort". Kanë thanë dhe ndryshe për këta kam shkruar nji libre të veçante

fjeshtë pë rata që kanë frilë Zotin, të cilët besojnë të papamen a pa parë[10] edhe për kënaqësinë e Zotit ngrehin nemazin fallen edhe nga ç'u kemi dhënë falin japin ndë nevojtarët. Ndrojtësit janë ata që besojnë ç'të zbriti ty dhe ç'iu zbrit Profetëve para teje[11] ata edhe ahiretin ditën e pasme e besojnë padyshim. Të vetmit këta q'u çfarësuan janë në Huda[12] çelsirët prej Zotit të tyre edhe të vetmit këta janë të shpëtueshmit, të lumturit.[13] Vërtet qafirët si Ebu xhehli me shokët i trembke s'i trembke sa pë rata ësht njëj, s'kanë për të besuar.[14] Zoti zembrat eshe veshët e tyre i a u ka vulosur **kellkatur** edhe përbi sytë kanë një cipë të trashë pë rata. Edhe prej njësive disa munafikë thonë All-llahun dhe ditën e pasme e besuan, halli s'janë besimtarë me të vërtetë.[15] Me ksi fjalësh rrahin të gënjejnë Zotin dhe mumininët, mirë po, veç gënjejnë veheten e tyre jo tjetër, halli se nuk e çquajnë[16] qi ata po rrejnë vehten e vet. Në zemërët t'atyre munafikëve ka një sëmundje dyshimi dhe naksi të rreptë që Zoti veç i a u shotftë një sëmundje t'atillë; nga shkaku që gënjejnë dyk e thanë besuam, do të kenë edhe një mundim përzhitës e pikëllonjës. Edhe kur n thuhet: mos bëni fesad turbullim e ngatarrim në dhët me anën e mosbesimit, thonë: na s'jemi veç se njërez mirsi prurës e botëndreqës.

10. Zoti ktu lëvdon ndrojtësit dyk e thane se ata pa parë me sy fare, e besojnë Zotin, ëngjejt dhe ditn e Ahiretit me gjith punët e saj ashtusikur e kanë parë me sy.
11. Kur'ani, Tevrali, Inxhili e librat e tjerë
12. Huda drejtësi udhë eshe çelsire, se kur asht udha e drejtë dhe e çelët udhëtari s'humbet.
13. Këta tre ajete lëvdojën muttekjne "Zot-ndrejtësit"
14. Si mjekësi që të smurit i jep myzhde edhe frikeë, keshtu edhe Pejgamberët kanë qënë beshir myzhde-dhanës edhe medhir frikë-shtuese.
15. Njerëzia ndahet në tri, munim "besimtarë" qafir, dyk e ditur se asht e vërtetë mundohet ta mbuloj me gënjeshtra a nga anda dhe Musa-fik, një i me dy faqe e me dy gojë; 3 ajete e parë lëvdojnë munit 2 të pasmit kallzume sjelljen e keqe te munafikëve
16. Se ç'dokunteshtin q'i i thuhet Pejgamberit, quhet se i asht ere drejtë për drejtë Zotit.

Muhammed! Ki mendjen, mos u gabo, padyshim atajanë të vetmit trubëllim-sjelllësit, mirë po vetëm që nuk e pikasin, edhe kur u thuhet besoni si besuan bota shokët e Muhammedit, thonë: a besojnë, si besuan thatët të paditçmit? Muhammed qoftë lark! Mbildhe! Truthatë me të vërtetë ata janë vetë, po nuk e dinë qi janë. Munafikët kur piqshin me muminit u thoshin: prumë imamë po kur ndaheshim prej tyresh edhe këtheheshin në dreqët[17] me të parët e tyre u thoshin: padyshim jemibashkë me ju, me të vërtetë s'kemi gjë vetëm se jemi tallës me muminët. Zoti i a u çpërblebn qesëndinë dhe u mënon e i a u zgjat të shtrihen të habitçim në harbimin e në kryengritjen së tyre. Këta q'e blenë errësirën me çelesirë dhanë Hudanë blenë dalaletin, tregëti e tyre fitim s'u dha edhe udhëgjetës s'u bënë. Shemblimi i atyre munafikëve është si shëmbëllimi që natën t'errët ndezi një zjarr, po zjari sa e ndriti vendin rreth e rrotull, Zoti dreitën e tyre i a u mori e fiku edhe aya i la ndër errësirat qi ma s'shohin ç'kanë rrotull.[18] Ata janë të shurdhët, memecë, të verbët. Pra kur janë si pashpirt ata s'kthehen në dritë s'dëgjojnë, s'flasin e s'shikojnë rrugën e drejtë. A'halli i munafikëve shembëllen si disa q'i ka zanë një shi i fortë qi rrjeth prej resë që ndër atë ka errësira e gjymime e vetimë e madhe. Kta q'i ka plakosur shiu për të mos ndigjuar a për të mos parë ç'del prej rrufeve ngulin gishtërinjtë në veshët e tyre nga frikë e vdekjes. Por Zoti me anen e diturisë dhe fuqisë qi ka qafirët i ka për të shftjellë, s'shpëtojnë dot nga dor e tij. Per pak (gati) vetëtima i u rrmben sytë. Atyre kur do herë që u ndrit ecin nepër atë dritë edhe kur u errësonet mbeten në këmbë të huteshim atje ku ndodhen po Zoti sikur të dontë veshët e syt i a u merte me anën e gjyminës i shurdhonte me anën e vetimës i verbonte ashtu s ii u ka verbuar edhe zemrat. Allahu është shumë i Zoti permbi

17. Shejtanë ishin Abdullah Seluhi me shokë
18. Të këtilla shëmbëllta ndoshen shumë në librat e tjera qiellorë

si çdo send, d.m.th ka fuqi të plotë ban ç'do.[19] O njerës! Faljuni Zotit t'uaj që iu ka krijuar dhe ata qi kanë ardhur përpara jush, bëhet se do të ndruhi nga zemërimi dhe mundimi i tij.[20] I cili Zot që dhënë i a u bani një shtesë dhe qjellë ndërtesë, edhe prej resë zbriti ujë, pra ç'i keni zbritur robit t'onë Muhammeditaherë sillini njerës të një copëz sure shëmbëll qi t'i përnjasë pak edhe në qenqi të vërtëtë në fjalët qi thoni Kuranin Muhammedi flet vetë thërrisni dhe Prendit t'uaja qi po i u faleni për ndënë Zotin edhe të ju ndihmojë. Sikur në mos bëfshi shembull dhe që keni për të bërë dot ase nuk e keni në dorë pra ndruhi prej zjarit që ndezja. Ajy zjar është përgatitur.[21] Ehe sihariqej ata besuan e punuan punët e mira që pë rata janë kopshtet që përposhtin drurëve rrjedhin lumejt. Kurdoherë që i ndenë hijet te druve prej atyne kopshteve i u jepet pemë për yshqim thonë: ky është ai ushqim që na jepej hanin më parë edhe në dynja. Edhe vërtet u jepej pemë përngjasëse si ato, po jo në shijtë vetëm nëngjyjët. Për ata janë dhe gra të dlirta nga gjithë fëlliqjet. Ata atje janë dhe të ngaherçim.[22] Me të vërtetë Zoti s'turpërohet

19. Shi edhe re asht imani e Kur'ani; errësirë, gjymim e vetëtim janë punët e zorçme si nemaz, oruç, lufta drejtë armiqëve, dotëheqja prej fes s'vjetër edhe e largumja nga Kryetazija; mirë po atyre kto u vinin fort zor. Kur nigjonin punët e Ahiretit të cilët përngjajnë ghynimanave, vetimave edhe rrufesë trembeshin edhe zinte vesht që të mos ndigjonin.

20. Asi kohej n'Arebi ndodheshin mjaft çifut, pak t'Krishterë, disa statyfalës.

21

22. Na besojmë se ka xhennet e xhehenem, por nuk jemi të detyruar të flasim qysh e si jan. dimë që zjarri do t'i djekjë të këqinjtë, bluashkat edhe lënda djekësore e xhehenemit janë vetë njerëzia dhe putet e gurët q'u folëshin; po si janë i di Zoti vetë. Besojmë që besimtarët punëmirët në xhennet kanë shtëpi më kopshte qe kanë gjith lloj peme, do të kenë edhe gra të pastra për shërbime dhe këto mirësi do t'i kenë te preherçme, posi janë nuk mundin të flasim. Jemi t'shterngum vetëm t'i besojm. Se punët e ahiretit as m' një mënyrë nuk i shëmbëllenjë punëve të kësaj bote.

s'hiqet e nuk le pa kujtuar po e bijë shembëll sido edhe një mushicë mbase edhe atë që do të jetë sipër saj m'e madhe se ajo. Por sa pë rata që besojnë e dinë që ajo shëmbëlla ësht' e vërtetë prej Zotit të tyre: halli se qafirët thanë: Zoti ç'dëshiron me këtë kujtim shëmbëllash? Me atë shembellshumë njerës i bënë udhëhumbësit edhe shumë të tjerë i bënë udhëgjetës, poi me të nuk rrugëhumon tjetër vetëm udhëlënësit. Ata udhëhumbësit që si pati qenë forcueme, e çthurën besën e Zotit q ii patëm dhanë, ata pren dhe atë send që Zoti pat urdhëruar të puqet e të bashkohet dyk e i vizituar faren efisin, ata edhe në dhet sjellin turbëllim e ngatërim. Këta janë dëmëgjetësite përherçim. Çudi i bëni qufur Zotit me qenë se ishin të vdekur një pikë ujë në trupat e atëve pra ju ngjalli në barqet e mamave pastaj si t'ju mushet koha do të vdesë pastaj rishtazi do tju ngjajë, pastaj ma s'fundmi do t'i kthëhi Zoti qi të ju çpërblejë ç'do send.[23] Ajt është një Zot që për ju krijoj gjith ç'ka në dhetë, pastaj i u drejtua e i qelloj qejve dhe i shtroj e i ngrehu shtatë pallë njëj. Edhe ç'do gjë si e perse e krijoj ajy e di më tepër e ma mirë.

23. N'Sure të Pejgamberëve Zoti urdhëron: (qiejt e dheu kanë qenë të ngjitçim pastaj Zoti i ka çngjitur dhe i ka ndar) Në surei Fussilet thot: (Zoti kur i u drejtua të krijoj qjellin, q'athere qjelli ishte një tym e mjegull…) meret vesht se Zoti çdo send e krijoj prej ujit, prej mjeglles e avullit (arabisht) prej këtij ajeti merret vesht qi Zoti i dhenë

**Salih Vuçiterni**

# Ç'âsht Kur-ani?[1]

Ketë themë të shkurtë na e paravû Drejtori i Rivistës <<Zâni i Nalt>> me nji letër të posaçme qi na dërgonte, ku, na kërkonte qi të cfaqim drejt për drejt ate qi mendojmë ne vetë mbi këte subjekt të naltë dhe na lutesh në ketë letër qi t'a paralajmrojmë në qoftë se kishim për t'i hy kësaj pune.
Shum e lehtë m'u duk këjo punë; prandaj shpejtova me dhanë pergjegjen pozitive. Por, kur morra me shkrue, e pásh se kisha ra mbrenda, e pashë se kisha premtue nji gjâ të madhe!...
Kisha premtue nji gjâ të madhe, pse, kur hyna në praktikë, e pashë se s'kishte qenë punë e lehtë me i diftue tjetrit: <<ç'asht Kur-ani?>>
Ku t'a filloj e ku t'a sosi? A ka fillim e të sosun Kur-ani? Mirpo, edhe me heshtë fare, kishte me thanë se, un nuk jam në gjindje me krye nji premtim.
U shtrëngova pra me gjetë diçka me thanë në ketë artikull e për njiherë me rá ndër mend roli qi ka luejt Kurani qysh prej 1350 vjet në jetën e popujve. Tue pru ndër mend me nji shpejtësi refeja gjith jetën e kalueme të Islamizmës, qytetnimin e shkëlqyeshëm të saj konstatova se:

## Ç'âsht Kur-ani?

Kur-ani âsht Statuti Hyjnuer, në bazë të cilit duhet të rregullohet, t'administrohet e të civilizohet trupi njerzuer qi jeton në fëtyrë të tokës pa perjashtim gjuhet,

1. Marrë nga "Zani i Naltë", 1933, 4-5.

gjakut e ngjyret. Ky Statut i shenjtë me dispozita të kjarta fton njerzin mbarë në rrugë të drejtë, në bashkim, ne vëllaznim, në paqe e n'urti, qi kështu njeriu të mundi me sigurue lumnin e tij si në ket jetë âshtu edhe në jetën tjetër të pasosun. Ky Statut lejon marrjen e masave të rrepta e në rasë të nevojës edhe deklarimin e luftës, vetem kundra atynë qi trazojnë e qetsin e botës edhe s'ju binden këtyne dispozitave të nalta të cilat sigurojnë lumnin e njerzis mbarë.

Kur-ani âsht nji liber i shénjt qi me dispozita të veçanta të tij deklaron barazim të plotë ndër njerz pa ndryshim klaset, gjuhet e njyret; ky libër i enkurajon njerzin qi të shvillohen fuej i njoftue këtyne se: i dishmi nuk mund të barazohet me të pa dishmin, gjith-ashtu ky libër i shenjtë me dispozita të posaçme i shtyen njerzin më u hijeshue me morale e me virtyte të nalta tuej iu deklarue atyne se, vetem aj mâ i dëlirti nga zémra e mâ i nalti në virtyt mund të konsiderohet si mâ i lavderueshmi e mâ i ndershmi ndër Jue.

Kur-ani âsht Aj Liber Hyjnuer qi me dispozita të veçanta urdhnon njerzin qi të formojë familje e të jetojnë në gjindje të perbashkët tuej i trembë e tue i largue këta nga jetesa mvehte e në formë primitive; dhe për t'a mërrie shkallen mâ të naltë të kulturës i urdhnon këta qi mos të kufizohen vetëm në studimin e gjindjes e të kohës së tyne por të zgjanohen në studimin e yjvet, të qiellit, të gjindjes së popujve të kaluem në kohna mâ të lashta, tue perfitue nga rrenimet e mbetuna si shéjet e jetesës së tynë.

Kur-ani âsht gurrë e pa shterun qi sikuer njerzija mbasë t'i shtrohen dispozitave të Tij, sikuer dijetarë e këtij rruzullimi t'a lodhëshin méndjen në studjimin e thellsis të pasosun të dispozitave të shéjta të tij, atëherë njerzija do të perparonte me nji shpëjti të jashzakonshme e të mrekullueshme, atëherë njerzija do të gjente bazat e shndoshta e të verteta të qytetnimit e vetem atëherë ç'do klasë e njer-

zisë do të mund t'ishin të lumtun, do të gëzojshin liri të vertetë dhe do të jetojshin në paqë e në dashtuni e do të kishin harmoni të plotë ndermjet tyne ashtu si ju ka hije njerzve të vertetë, pa pasë frigë njeni tjetrin.
Kur-ani âsht permbledhja e çudinave qi kanë ngjajtë e qi do të ngjajnë, qi janë krijue e qi do të krijohen, lexuesit e ktij libri të shéjtë kur ata vazhdojnë me leximin e tij me kujdesi të plotë, në ç'do këndim e lexim do të hasin në gjâna të çditshme e do të kuptojnë e do të zblojnë gjâna te reja.
Shkurtazi Kur-ani âsht nji Statut i shéjtë, dispozitat e tij janë të pa anulueshme dhe sigurojnë ç'do nevojë të ç'do klasës së njeriut deri në mbarim të kësajë Bote.
Lexuesit e marrin me mend se sa ngushtë kemi ra, kur zgjodhëm për me spiegue: Ç'âsht Kur-ani? Vetë fjalët qi kam rrjeshtue e diftojnë se robi s'ka fuqi e kompetencë me lavdërue „ Kur-anin e Zotit" i cili lavdëron vetvehten me ndjenjat qi inspiron në shpirtin e çdo kënduesi.
Ndonji qi s'e ka studjue Kur-anin mund të pretendojë se ky libër i shenjtë më ka terheq e më ka bâ për vehte pse jam musliman: Atëherë pra un po tërhiqem nga këjo pozitë dhe po ju lutem lexuesve të ndigjojnë me kujdes nji jo mysliman, nji orientalist Freng, të përmendunin Z. Sidijo, i cili në veprën e tij; Shkurtimi i Historis së Arabis, faqe 59, 63, 64 thotë: "Kur-ani âsht nji vepër e denjë për çdo respekt. Kur-ani i ka njoftue njerzis tagrin e Zotit, ja shkoqitë qartaz njeriut marrë-dhaniet qi ka me Perendine edhe ç'duhet të presë prej Tij. Kur-ani mbështjedh krejt bazat morale e filosofike. Virtyti e vesi, e mira dhe e keqja, e verteta dhe ngjyra e vertetë e ç'do sendi âsht spiegue në Kur-an. Dispozitat e versetet e Kur-anit iu kanë frymzue Hazreti Muhammedit si mbas nevojës e mbas kohes. Kur-ani âsht aj qi disa thërmija grindavecësh të bastardhuem e të degjeneruem i lidhi ngushtë dhe i bashkoi në nji tansi kombëtare qi kishte të bâajë me tatin e botës.

Themelet e urtis e të filosofis, drejtësija e barazija, janë spiegue në Kur-an.

Kur-ani Këshillon e porosit kursim dhe shpenzime me masë; Aj e nxjerë në dritë njerin qi ka humbë rrugën. Aj e shpëton moralin. Kur-ani të metal dhe gabimet e njeriut i ndryshon dhe i kemben me virtyte të larta e të persosuna. Kanë qenë të marrë ata qi Islamizmës i kanë thanë fe barbare. Këta nejrëzës i kanë mbyllë syt para Kuranit dhe s'kanë deshtë t'a kuptojnë se si ky libër i naltë qysh prej shum shekujsh po shkul e po resit nga zemrat e njerëzve veset e ligsit...

Këto thotë orientalisti i nalt-permendun.

Pra, ata qi dishrojnë t'a marrin vesht Kur-anin, i cili âsht <<Statuti Hyjnuer i Botës>>, e kanë per detyrë t'a zânë nji herë me dorë dhe t'a studjojnë nji herë me kujdes e vetëm atëherë do ta marrin vesht se ka gjâ të madhe kam premtue e sa pak fola ktu.

**Haxhi Tahsin Hallulli**

# Naltësija e Kur-anit[1]

## Nota të mbajtuna nga vazi i Z. Haxhi Tahir Hallullit, Vaiz në Tiranë.

Kur-ani i naltë, libri hyjnuër i fesë Islame, âsht i krye në cdo pikpamje. Ky libër i shejtë me dispozitat e versetet e tija kuptim-plotë âsht nji statut i amshuëm, ku mentarët e dijetarët e naltë mund të gjejnë thesare të pasosuna e baza të patronditura për të mirën e lumtërin e njerzis.
Në këtë libër të shenjtë i Madhi Zot e ka spiegue me hollsi të madhe misterin e krijimit dhe misjonin e njeriut. Ky libër e shkoqit filosofin e jetës dhe lumtërin e pasosun. Pse të hidhemi largë, mjafton të studjojmë Suren e Asrit, qi âsht nji nga kaptinat mâ të vogla të Kuranit. Këjo kaptinë ka vetëm dymëdhjetë fjalë të përmbledhuna në tri vërsete. Por se këto tri vërsete. Por se këto tri vërsete shkoqisin shkurtaz e përmbledhtaz mënyrën se si mund të lumtërohet njeriu për gjithmonë.
Ne s'kemi fuqi me u bâ mbrojtësit e Kur-anit, por po e lamë të flasë vetë Kur-ani me këtë sure:
<<Vel-âssri in-nel-insáne le fi khusrin, il-lal-le-dhine ámenu ve amilu's-ssáliháti ve tevásav bi'l hakki ve tevásav bis-ssabri.>>
<<I dashtun Resúl! Betohem në shekullin e lumnueshëm se cdo njeri âsht në dam e s'ka fitue gja; përvec atyne qi besuën Perëndinë, punuën punë të mbara, porositën drejtësi e porositën durim.>>

1. Marrë nga "Zani i Naltë", 1935, nr. 1.

Dija e perëndis âsht e amshuëme dhe e pasosun; pra Aj Zot fuqi-madh e dinë fare sigurtë se kush do të fitojë e kush do të humbasë; me gjithë këtë edhe neve na ka kallzue shenjat e atyne qi e fituën lumtënin e përjetëshme e, sadoqi ne muslimanët e besojmë fjalën e Perëndis, por, qi të na qetsohet mirë zemra e të largohet nga cdo dyshim, i Madhi Zot bân edhe be. Ky betim ka nji hallësi tjetër: <<Ata qi s'besojnë në fenë Islame, natyrisht i mohojnë gjith urdhënat e Zotit qi i spiegon Kur-ani e, ndofta shumë kësish edhe flasin mbar' e prapë. Këjo gjâ domosdo i idhnon muslimanët e vërtetë. Pra i Mëshirshmi Zot, qi t'i ngushullojë ndërgjegjet e idhnueme të muslimanëve, bânë be edhe i u thotë se të gjith njerzit nuk e kanë krye misjonin qi i u përket; prandaj të gjithë këta e kanë humbë fijën, e kanë bjerrë rrugën, s'kanë fitue gjâ fare, ata janë krejt në dam.>>

Vllazën të dashtun, për këtë gjâ të jeni të sigurtë; sepse këtë lajmë nuk e japim nga mendja e jonë, por e nep vetë i Madhi Zot; edhe, qi të na mbushet mendja se ky lajmë âsht i vërtetë, i Madhi Zot bân edhe be e thotë <<për shekullin e lumnuëshem.>>

Cili âsht ky shekull i lumnueshëm?

Ky âsht shekulli, në të cilin shpërtheu në botë mâ e madhja Dritë e Zotit; erdhi në botë mâ i dashuni i Zotit, Hazreti Muhammeti Alejhisselam. E pse ky njeri i naltë âsht mâ i dashuni i Zotit, u bâ mâ e shkëlqyeshmeja pasqyrë e moralit të Zotit, moral qi ka për themel besimin më Zotin, punën e mirë të mbështetun në instruksion të Zotit, në porosi të drejtësis e të durimit.

E shifni vllazën, se selameti i njeriut së parit varet në të besuëmit e Zotit, të cilit do t'ja kushtojmë gjith veprat t'ona, e pastaj në veprat e mira e në fund duhet të porosisim edhe botën qi mos t'i dahet <<drejtësis>> e <<durimit.>>

Ne pra, mbas këtij urdhëni, jemi të detyrue me ngritë

zânin sa herë qi shofim se harohet ase përbuzet Zoti; ne do të bërtasim sa herë qi shofim se njerzija i u shtëmanget vepravet të mira edhe lishohet mbas të ligavet; nuk do të lâmë pa porositë respektimin e drejtësis sa herë qi të shofim se kjo shkelet; nuk mund të heshtim përpara skenës së vajtuëshme të vllaznis s'onë qi i mbulon mjerimi e fatkeqsija, por do të shpejtojmë me i ngushullue e me i u dhanë durim qi kështu mjerimi e fatkeqsija t'ju kthehen në lumtën.
Me besue <<Zotin>>, âsht qëllimi i jetës. Zoti i muslimanëvet âsht Zoti i vërtetë, i amshuëm, i gjallë e i pavdekshëm; nuk ka nevoj për kurrnji send; âsht i vetvetishëm dhe i pa tjetërsuem; muslimani nuk njef Zot të konkretizuëm në natyrë; Zoti i vërtetë nuk ka lë; nuk pjell, por krijon; prandaj ka krijesa e jo bij e bija.
Muslimani i beson pa përjashtim të gjithë Profitët si të dërguëm e lajmtarë të Zotit e jo si Zot. Muslimani beson Engjej si krijesa të Zotit; beson edhe librat si fjalë të Zotit; por librat qi kanë pru profitët e jo ata qi kanë hartue njerzija mbas qejfit të tyne.
Mâ në fund muslimani beson edhe gjygjin e amshuëm; prandaj këshillon vëllaznit e tij qi të mos t'u venë menden sharllatanëve, por të ndjekin rrugën e vërtetë e ashtu të caktojnë fatin e tyne, mbassi gjithsecili e ka vorrin veçan.

* *
*

Perëndja me madhni të vet betohet në shekullin e lumnueshëm të H. Muhammedit; ky shekull konsiderohet koha mâ e shenjtë qi ka pâ jeta e njeriut. Me gjith këtë i Madhi Zot me këtë betim na mëson edhe nji gjâ tjetër: Vleftën e kohës.
Vllazën, koha âsht materjali, prej të cilit trajtohet jeta. Në qoftë se duem me rregullue jetën t'onë duhet t'i vemë menden kohës; kush e humb kohën kot ka humbë jetën

kot. Koha âsht mâ i madhi dhe mâ i vlefshmi kapital. Profitët e Zotit dërgatën e tyne e plotsuën nëpër mjet të kohës. Të gjith sundimtarët sundimin e tyne e fituën prej kohës. Edhe ne të gjithë çdo gjâ e fitojmë prej kohës; po të na mungonte koha nuk do të kishim jetë; pra nuk do të ishim as vetë.

Të vijmë në pikën e dytë: Të gjithë njerzit janë në dam e vetëm fituën ato qi kanë besim më Zotin. Cilët janë këta? – Janë atâ qi kanë dijeni për Zot. Vllazën! Cdo musliman duhet të ketë dijeni të plotë; me injorancë nuk mbahet feja. Hazreti Muhammedi Alejhisselam ka qenë mâ i dituni njeri në botë; atij i dhuroi Perëndija gjith diturit e të parëve edhe të mbrapëmve. Kur-ani i përmbledh të tâna këto dituri edhe i thrret njerzit qi t'i mësojnë.

Qe, Hafiz Idrizi në teravit e këndoi krejt Kur-anin. Kur-ani âsht nji gosti e Zotit; shijoni pra këtë gosti të Perëndis, se do të fitoni shumë të mira. Me Kur-an do të mësoni Zotin edhe punët e mira.

Punët e mira na i ka caktue Perëndija si detyra. Nji ndër punët e mira âsht me ndihmue shëshoqin, me i bâ mirë shshoqit.

Shifni vllazën si punon i Madhi Zot:

Për veç hafizvet t'onë të mirë qi na ka falë Zoti, qi të na e bâjë edhe mâa të bukur e mâ e stolisun Ramazanin e bekuëm, na ka sjellë nga shumë vende të botës islame edhe nji shumicë hafizësh tjerë, të cilët kanë lanë familjet e tyne dhe kanë ardhë këtu ta bâjnë Ramazanin bashkë me ne. Kushdi sa kanë qa fëmit e tyne, kur janë nda! Por këta i kanë ngushulle tue i u thanë se do t'a kalojnë Ramazanin në Tiranë, qi âsht Kryeqyteti i Mbretnis Shqiptare, ku muslimanët kanë liri të plotë; i u kanë thanë se në Tiranë ka muslimanë të mirë e të ndershëm e kështu na e kanë çue zanin deri në qiell. Familjet e tyne të mjera kushdi sa duâ e sa lutje bâjnë Zotit për Mbretin t'onë e për Kombin Shqiptar...

Po ne, vllazën, ç'jemi tue bâ e si po dahemi me këta shokë? Qysh po i përcjellim ndër familjet e tyne? A i kemi pyetë ndonji herë se a janë të kënaqun prej nesh; A e kemi krye detyrën qi kemi pasë kundrejt tyne?
Perëndija na urdhënon të ndihmojmë shëshoqin e po e ndihmuëm shokun na e shton pasurin t'onë. Ata qi janë për t'u ndihmue na i kallzon Vetë i Madhi Zot në Kur-an e janë këta:
Far' e fisi, jetimët, të vobegtit, udhtarët jabanxhi, lypsit, edhe skllavët.
Përpara këtyne gjasht klasëve të varfra kemi detyra me rândësi. Sa të keni takatin mos u kurseni, o vllazën; bani mirë qi t'ju gjendet e të gjeni selamet. Mbas kësaj pikë vllazën vijnë dy urdhnat e fundit:
Me porositë drejtësi e durim.
Vllazën në çdo punë të silleni me drejtësi të madhe e në rasa të ngushta e kohë të vështira të keni durim. Kush i ndjek këta rrugë qi kallzuëm ka shpëtue, të tjerët kanë humbë.
Këtë të vërtetë spiegon kaptina e Kur-anit qi spieguëm mâ sipër.

# Ç'urdhënon Kurani?[1]

## (nga Vazi i Z. Qazim Hoxhës)

Vëllazën muslimanë!

Do t'a keni mbajtë mend se edhe vjet këtë ajet e patëm fillue. Edhe këtë vit do t'a vazhdojmë këtë ajet të naltë, me qenë se pat përmbledhë tri pika shum me rândësi qi janë: a) Me dashtë Zotin e Madhnueshëm; b) Me dashtë Pejgamberin e naltë të Zotit, Hazreti Muhhamedin Alejhisselaml c) Me luftue në rrugë të Zotit të vërtetë.

Ajeti I naltë qi kënduëm e ka këtë puptim: <<O mâ i plotsuemi Pejgamberi i Em i dashtun, thueji popullit t'and robvet të Mi, se, etënit t'uej, bijt t'uej vëllaznit t'uej, bashkëshortet t'ueja, fisi i juejë, pasunija qi fitoni, tregtija, qesatllikun e së cilës e keni frikë, shtëpit t'ueja ku kënaqeni tue banue, në qoftë qi janë mâ të dashtuna ke ju se All llahu i Madhnueshëm e se Resuli i Tij, qi âsht Hazreti Muhammedi Alejhisselam edhe se të luftuemit në rrugë të Zotit, pritni deri sa t'ju a mbrrijë urdhni i Zotit. All-llahu i Madhnueshëm nuk ja drejton rrugën për së mbari popullit bâkeq. (Kur-ani: 2-24)

Kadi Ljazi në Shifai Sherif thotë: Mjafton ky ajet për muslimanët për t'i zgjue nga gjumi dhe për me j'u diftue se dashunija më Zotin e Madhnueshëm e më Resulin e Tij të naltë asht farz; me dashtë Zotin Azze ve xhel-le edhe Hazreti Muhammedin Alejhisselam âsht detyrë e domosdoshme për çdo musliman e për çdo muslimane. Gafilëve, don me thanë atyne qi s'çajnë kryet për All-llahun e Medhnueshëm e për Resulin e Tij të naltë,

1. Marrë nga "Zani i Naltë", 1938, 12.

Perendija j'u ka ra kreës me rreptësi tue përdorë fjalën (feterabbesu) qi don me thanë << pritni deri sa t'ju a mbrrijë gazebi i Em.>>
Njerëzit qi s'e duen Zotin e Pejgamberin Perëndia me kuptimin e ajetit i quen (fasikë), don me thanë njerëz tepër të këqij, njerëz qi s'i shtrohen asnji ligji e rregulli.
Fjala (la jehdi) na difton se i Madhi Zot nuk i drejton në udhë të mbarë e të urtë fasikët.
Si shifet, vëllazën, ata njerëz qi s'kanë dashtuni për Alllahun e për Pejgamberin, dashtuni qi mund të tregohet me fli e me sakrificë, janë fasikë, janë njerëz të këqij qi s'ka me i drejtue Perëndija në udhën e të mirëve.
Rruga e naltësimit moral e shpirtnuër âsht dashtunija e Zotit dhe e Pejgamberit dhe flija qi do të bâhet për këto dy ideale të nalta.
Dashtunija e Zotit âsht nji mjet qi njerin e ramun shum poshtë e ngren në shkallët mâ të nalta; ose, t'a themi me termat e Kuranit, nga esfeli safilini e ngren në Aélái il-lijjin.
Dashtunija e Zotit e ndreq dhe e përmirson edhe njerin mâ të ulët edhe e pajos me cilësit e Zotit; zemrën ja mbush me mëshirë, gjuhën j'a bân të âmbel edhe kështu j'a shduk egoizmin dhe e bân altruist; ky njeri gjithmon me vetmohim përpiqet për të mirën e qetsin e tjerëve. Domosdo kështu do të bâhet, sepse ky tash âsht stolisë me cilësi të hyjnuëshme e të shenjta e prandaj s'âsht e mundur të dale punë e ligë prej tij. Asht e vërtetë se nuk âsht i pafajshëm e i pagabueshëm, sepse âsht njeri; me gjithë këtë dashunija qi ka më Zotin e mpron nga punët e liga.
Dashunija e Zotit i shëron të gjitha sëmundjet e zemrës e të shpirtit, si kreninë, vetpëlqimin, tradhtinë, smirën, mëninë, hipokrizinë, dinakrinë e tjerë vese të liga. Dashunija e Zotit âsht nji zjarr qi i djeg të gjith veset dhe e pastron zemrën si duhet. Dashunija e Zotit âsht rruga mâ a shkurtë qi na çon ke Zoti.

Rrugët qi e çojnë njerzin ke Perëndija janë baraz me sasin e frymëve të njerzisë; porse rruga mâ e shkurtë âsht dashunija e Zotit të Amshuëm.
Si fitohet dashunija e Zotit?
Këjo gjâ bâhet vetëm me hirin e dhantin' e Perëndis; por se ka disa mjete qi duhet t'i përdorim. Bota ku jetojmë âsht bota e mjeteve. I madhi Perëndië mirsit e Tija morale e materjale i shpërndan nëpër nji rregull te caktuëm qi quhet (rruga e mjeteve). Perëndija i Madhnueshëm nuk e ka bâ Zakon me i shpërnda mirsit e Veta pa përpjekjen t'onë, sadoqi ka fuqi me e bâ ketë punë.
Pra ka pushtet Perëndija me i dhurue mirsit e Veta pa mjete e pa përpjekjen t'onë, veçse nuk e ka bâ rregull.
Dhantija mâ e madhe e Zotit për muslimanin âsht me dashtë Zotin, edhe mjeti me të cilin fitohet këjo dashtuni âsht ndjekja e gjurmëve të Sheriatit e të Hakikatit së bashku. Për t'a fitue dashunin e Zotit lypset me ecë me dy krahë, me Sheriat e me Hakikak. Këjo rrugë âsht mjeti i dukun, nëpër të cilin mund të fitohet dashunija e Zotit. E në të vërtetë puna qëndron në dorë të Zotit, i Cili urdhënon (Juhib-buhum ve juhib-bunehu) – Zoti i don ata, edhe ata e duen Zotin.
Pra, vëllazën më një anë lypset me i u shtrue Sheriatit të Hazreti Muhammedit qi përmbledh urdhënat e Zotit e të Pejgamberit e më anë tjetër duhet me u përpjekë për me marrë dritë të mbréndëshme e me u mundue me gjetë rrugën e kësaj drite.
Shpërblimi i dashunis e i Ziqrit të Zotit âsht vetë dashunija e Ziqri i Zotit; <<Vedhquruni edhqurqum –d.m.th. Bânmëni ziqër Mue t'ju bâj edhe Unë Ziqër juve>> urdhënon i Madhi Zot në Kuran. Ky verset don të thotë: <<Dueje Zotin, të të dojë edhe Aj ty; kujtoje Zotin të të kujtojë edhe Aj ty.>>
Gjithsecili i merr vesh ç'kuptim kanë këto fjalë.
Don me thanë, <<Robi i Em me anë të nafileve vazhdon

tue u afrue tek Unë deri sa t'a due, e kur t'a due, Unë Vetë bâhem ndigjimi i tij me të cilin ndigjon, shikimi i tij me të cilin shef, dora e tij me të cilën rrok, folja e tij me të cilën flet...>>
<<Nafile>> quhen ata ibadete qi s'i kemi borç por qi i bâjmë me vullnet t'onë. Mâ të vlefshmet e mâ të pranueshmet nafile janë të falunit, agjënimi edhe Ziqri.
Njerzit e shenjtë thonë se muradi i perëndis me fjalën nafile qi përmend në Hadithi –Kudsi, âsht <<shpirti i punës>>. Atehere kuptimi del kështu <<Robi i Jem me anë të shpirtit të punës vazhdon tue u afrue gjithnji tek Unë>>.
Në librin <<Hiqemi Ataijje>> asht ky hiqmet:
<<El amalu suverun kaimetun ve ervahuha vuxhudu sir-ril ihlasi fiha.>>
Don me thanë: <<Punët t'ona janë figura qi qëndrojnë në kâmbë e shpirtat e tyne janë qellimi i kullue për të cilin bâhen këto punë>>. Në qoftë se këto punë i bâjmë vetëm për riza të Zotit, figura e tyne ec e lëviz, për ndryshe mbetet si nji statut i thatë.
<<Me u afrue te Zoti>> nuk don të thotë se Perëndija âsht atje për tej e ne i afrohemi; Perëndija âsht bashkë me ne kudo qi të jemi. <<Me u afrue>> e ka kuptimin me mohue e me harrue vehten, don me thanë me shtypë e me shdukë egon. Perëndiu s'ka vend, sepse s'ka nevojë për vend; përkundrazi vendin ka nevojë për perëndinë.
Për me qenë të mira e të pranueme punët t'ona duhet të kenë shpirt e shpirti i tynë âsht qëllimi i kullue, ose si i thonë ndryshe (ihlasi).
Ihlas don me thanë me shdukë Rijanë e shirqin e msheftë apo me fjalë tjera, hipokrizinë e politeizmin e msheftë.
Për njerzit e shenjtë hipokrizija âsht në kundërshtim me saktësin e punëve.
Ataull-llahu pat thanë se << Shpirti i punëve âsht me u gjetë në to sir-ri ihlasi; E sir-ri ihlasi e ka kuptimin: <<Nefjul-uxhbi ve mulahadhatin-nefsi>> don me thanë:

Me shdukë pandehmën se i bâjmë punët ne; bile me hekë pandehmën edhe për vehten t'onë. Me mos u mbështetë kryekëputë në vehtën t'onë Uxhëb don të thotë me ja mbështetë punët fuqis s'onë e me e harrue fuqin e Zotit.
Hazreti Pejgamberi Alejhisselam urdhënon e thotë
Tri punë prishin njerin:
1)Me qenë shum i shtrenjtë e me iu bindë këtij vesi.
2)Me u dhanë mbas dëfrimesh epshore.
3)Egoizmi, me pa vehten e me pelqye vehten; me thanë un dij, un jam i mençëm ....etj.
I pari qi ka thanë(Unë) âsht shejtani.
Pra, vëllazën, punët duhet t'i bâjmë me qëllim të kulluëm, me ihlas, se ihlasi âsht shpirti i punës. Për t'a prû në vend ihlasin duhet t'a shdukim(egon) ...arabisht...
<<La havle ve la kuvvete il-la bil-lah>>
Me këtë Hadithi Kudsi urdhënon i Madhi Zot:
Ihlasi apo sinqeriteti âsht nji sekret nga sekretet e Mija. Këtë sekret j'a frymëzoi në zemër rrobit qi e due; ky sekret âsht aqë i msheftë, saqi s'e kuptojnë as engjejt qi janë ngarkue me mbajtë shenime mbi punët t'ona, as shejtani qi përpiqet t'i prishë punët t'ona.
Ne, vëllazën, kemi pranë disa engjej qi kanë për detyrë me marrë shënim e me rregjistrue çdo punë qi bâjmë. Këta engjej quhen <<Qiramen Qatibin>>.
Sekreti i sinqeritetit âsht nji shkallë e naltë shpirtnore të cilën s'mund t'a kuptojnë engjëjt; prandaj veprimet e kesaj shkalle i din vetëm Perëndija. Punët e Zemrës i kuptojnë meleqt nga aroma e kandëshme qi shpërndan zemra kur i kryen këto punë.
<<Sirri-ihlasi>> âsht mekami i sirrit, i cili mbetet pa u rregjistrue prej meleqve, me qenë se s'munden me e kuptue. Gjith ashtu edhe shejtani s'mundet me e kuptue e me e përlye.

*
* *

Iu larguem tepër subjektit, le të këthehemi ku e patëm fjalën:
Hazreti Pejgamberi Alejhisselam në nji hadithi sherif urdhnon:
<<Shpërblimi i dashunis së Zotit âsht vetë dashunija e Zotit. Për me shkue ke Zoti duhet me lanë vehten e me dashtë Zotin qi t'i afrohemi sa ma tepër <<hatta-uhib-buhu, ej hatta ufidhu alejhi mehabbetedh-dhati>> deri sa t'a due, don me thanë deri sa t'ja mbushë zemrën me dashunin e Vehtes s'Eme; (fe idha ahbebtuhu) e kur t'a due Unë atë bâhem ndigjimi i tij, pamja e tij, rrokja e tij edhe folja e tij...
Ç' don me thanë këjo?
Këjo don të thotë se, kur t'a dojë Zoti robin e vet, i hedh nji dritë në zemër qi t'i shtohet dashunija më Zotin. Kur t'a dojë robi Perëndinë edhe Perëndija i fal fuqit e sifateve të Veta e tash shpiriti i këtij robi ka fuqi me ndi gjithçka, bije fjala, ka fuqi me ndi bimët kur lavdërojnë Zotin. Ky njeri tash shef çdo gja, sepse i janë ngritë të gjitha perdet qi pengojnë të pamit t'onë.
Kanë ardhë disa zotni të naltë qi kanë thanë:
<<Lavdëroj vetvehten, sa i naltë âsht shani i em...>>
<<Unë jam Haku...> etj.
Këto njerëz s'kanë qenë çmendun qi të flasin fjalë të tilla; porse janë zhytë në dashunin e Zotit dhe kanë mbri në atë gradë të naltë, ku u shduken cilësit' e veta dhe vishen me cilsit e Zotit të Amshuem dhe dejen prej dashunis së Zotit e u dalin këso fjalësh.
Sejjid Abdul-Kadri Kaddesell-llahu sirrehu ka thanë: ...arabisht...
<<Urdhni i em âsht me urdhnin e Zotit, po t'i them nji sendit banu, m'at çast bâhet>>. Kuptoni mirë fjalët; njer-zit e shenjtë veprojnë me fuqi të Zotit dhe kanë në dorë kompetencë me suprimue ligjët e natyrës e me i zavendë-sue me ligjë tjera qi ne s'i dijmë.

Ndigjoni <<vllazën>> ç'punë të mrekullueshme ka bâ nji herë Sejjid Abdul-Kadri Kaddesell-llahu sirr-rrehu:
Kishte dalë nji herë në breg të Furatit, ku gjeti nji nanë plakë qi po qante të birin, i cili kishte qenë disa vjet në gurbet e kur po këthehesh te shtëpija e zé nji shtrëngatë në Furat dhe e rrokullis aninë ku kishte hypë dhe bashkë me udhtarët tjerë mbytet edhe djali i saj. Prandaj nana plakë e kishte bâ zakon qi të vente çdo javë në breg të lumit dhe t'a qante të birin.
Sejjid Abdul-Kadri i thotë naës së shkretë: <<Në qaftë se t'a nxjerr djalin qi t'a shohish a ke me qa mâ?>> Mbassi i ep fjalën plaka se s'kishte me qâ mâ për të birin në qoftë se e shifte, Sejjidi, qi e kishte çue dashunin e Zotit deri në kulm, i bân me shenj lumit dhe me të shpejtë fillon përsëri shtrëngata deri sa mâ në fund e nxjerr në shesh anin e mbytun ku u duk edhe djali i plakës.
Këtë mrekulli, vëllazën, nuk e bân Sejjid Abdul-Kadri, me fuqi të vet por e bân me fuqin e Zotit qi e ka fitue nëpër mjet të dashunis qi ka pas për All-llahun e Madhnueshëm.
Pra dashunija e Zotit âsht rranja e fesë.
All-llahu me mëshirë të Vet na e mbushtë zemrën me këtë dashuni dhe na afroftë pranë Vehtes së Tij.
Amin.

# Ç'urdhënon Kurani?[1]

O njerëz, adhuroni-je Edukuesin t'uajë, i Cili ju krijoi juve edhe ata para jush; - adhuroni-je – abolla qi të bâheni të devoçëm.- Adhuronije atë – i Cili për të mirën t'uajë e bâni tokën shtresë e qiellin strehë edhe uli prej qiellit ujë, me të cilin nxori për ju ushqim pemësh. Mos i bâni pra shok Zotit, mbasi e din – se këto punë vetëm Zotin i bân.>> Kurani: II:21-22.

Kurani i Shenjtë âsht vetë prova e vetvehtes qi dishmon se âsht fjala e Zotit. Ata qi e dijnë Arabishten letrare e shofin mâ kjartaz kete provë të Kuranit. Ata qi nuk e njofin ketë gjuhë të naltë duhet të kenë pak kujdes e vemendje në disa kondita të domosdoshme qi na ndihmojnë për të kuptue versetet e nalta të Kuranit, kur ky âsht përkthye në një gjuhë tjetër.

Disa nga këto kondita janë:

a)Me dijtun historin e ngjarjes qi shkaktoi uljen e versetit qi studjohet.

b)Me dijtun çka përmbajnë versetet e mâparshme e të pastajme të versetit qi studjohet,

c)Me dijtun me hollsi historin e gjeografin edhe shkencat tjera me të cilat ka të përpjekun verseti qi spiegohet.

ç)Me pasë njohuni mbi ligjët e logjikës e theorit e filosofis...etj.

Tani tue pasë parasysh këto kondita le t'a studjojmë versetin e mâ sipërme:

Arapët me përjashtim të nji pakice me gjithse e çmojshim vlerën e naltë letrare të Kuranit, por të vertbuëm nga fanatizma e errët dhe nga bestytnit e trashigueme s'e besojshin ketë se âsht fjala e Perendis, e prandaj e kundërshtojshin dhe e refuzojshin.

1. Marrë nga "Zani i Naltë", 1937, 1.

Kaptina II e Kuranit âsht kumtue në Medine; dy versetet e para të saj flasin kështu: <<Elif, Lam, Mim ky âsht libri në të cilin s'ka dyshim; âsht udhëheqës për të devoçmit.>>
Tetëmëdhetë versetet tjerë qi kanë hy midis të dytit e të njizet njitit janë si antiparanteza, me të cilat shkoqitet se njerzit janë tri duersh: Besues, mohuës e hipokritë(munafikë).
Besuësit kanë për udhëheqës Kuranin, e partit tjera, qi s'i janë shtrue thirrjes profetike, kanë pasë dyshim në Kuranin, tue pandehun se Ketë Libër të Shenjtë e ka goditë vetë H. Muhamedi. Këta njerëz i thrret në kontest vetë Kurani me versetin XXIII të kaptinës së dytë:
<<Edhe në qoft se keni dyshim në até (në Kuranin) qi kemi ulë mbi robin t'Onë (H. Muhamedin), hartoni edhe ju nji kaptinë si të tijat (si të Kuranit) tue thirrë në ndihmë gjith dishmitarët t'uajë veç Perëndisë.
-(Ketë punë duhet t'a bâni)- po të jeni të sinqertë (në pretendimin t'uajë.)->>
Me versetin XXIV Kurani i lajmëron se nuk do të munden me e bâ ketë punë. Edhe me të vërtetë nuk mundën me trajtue ndonji pjesë letrare qi t'i shembullojë Kuranit, sadoqi u përpoqën mjaft.
Atëherë u vërtetue se Kurani âsht fjala e Zotit e ato qi s'e pranojnë Kuranin dhe qi nuk i regullojnë veprimet e tyne mbas dispozitave të Kuranit kanë marrë nji rrugë të gabueshme, për të cilën do të jenë vetë përgjegjës. Ata njerëz me kulturë, qi s'u mbushet mendja për ketë gja duhet t'i vazhdojnë studimet e tyne, tue qenë të sigurtë se shpejt a vonë do t'a gjejnë të vërtetën e do t'a marrin vesht se Kurani âsht fjala e Zotit.
Mbas këtyne spiegimeve u kuptue se Kuranin s'mund t'a hartojë tjetër kush veç Perëndis, pra nuk duhet me bâ dyshim në ketë libër të Shenjtë; por duhet me pranue dritën e tij e me shpëtue vetvehten gjith se kush qi ka mend në kokë.

Kurani i Naltë mbassi i klasifikoi njërzit në tre grupe tue spiegue cilsit e çdo grupi, me versetin qi kemi marrë për themë, i përmbledh të tre keta grupe në nji vend dhe j'u drejtohet e ju thotë:
<< O njerëz, adhuroni-je Edukuesin t'uajë, i cili ju krijoi edhe ata para jush;- adhuroni-je – abolla qi të bâheni të devoçëm.>>
Apostrofa këtu âsht universale; të gjith njerzit urdhënohen t'a adhurojnë Perëndin. Pra urdhni <<adhuroni>> si mbas tri kategorive qi u përmendën ma sipërmerr kuptime të ndryshme. Për <<besuesit>> ka kuptimin <<qendroni në besim>>; për <<mohuesit>> ka kuptimin <<besoni Zotin>> e për <<ipokritët>> ka kuptimin <<besoni e adhuroni me sinqeritet>>.
Perëndija e nep ketë urdhën, pse âsht i denjë e meritueshëm për t'u adhurue, sepse âsht nji Zot qi krijon, sikurse na ka krijue neve edhe ata para nesh.
Mirpo mohuesit e Zotit i kundërshtojnë theoris së krijimit dhe thonë se janë pjellë prej prindënvet të tyne e këta prej të vetvet... deri ke majmuni si mbas theoris së Darvinit. Kësaj theorije i kundërshton Kurani tue thanë <<Perëndija i krijoi edhe ata para jush.>>
E din kushdo se roli i prindënvet në krijimin e femis âsht i verbët; zhvillimi i foshnjës në bark të nanës kryhet vetiut, pa ditun gjâ mâma. Fuqija qi e kryen ketë zhvillim në gjuhë të shkencës materjale qi s'don me njoftë Zot, quhet natyrë. Prej kësaj merret vesht se edhe shkencëtarët atheistë e njofin ketë <<fuqi Krijuese>>, veç se j'a ndrojnë emnin.
Si mbas këtij spiegimi verseti i mâ sipërmë e ka ketë domethanëje: <<O njerëz, adhuroni ate Fuqi qi ju krijoi e ju zhvilloi juve edhe ata qi kaluën para jush.>>
Shkurt, në të gjitha fazat e jetës, në të gjitha zhvillimet bimore e shtazore, në të gjitha fenomenet fizike e, së fundit, në të gjitha ngjarjet morale e intelektuale

ushtron kopetencën e saj plot dije e vullnet nji e vetme fuqi, Fuqija e Hyjnueshme qi i themi <<Zot>>.
Tash të vijmë e të studjojmë nji pikë tjetër të Kuranit:
Në këtë verset Perëndija i ep Vehtes së Vet emnin <<Edukuës>>. Ky emën i naltë vjen me na provue se Perëndija meriton të adhurohet, pse ka në dorë edukatën universale. Me dhanë <<edukatë>> âsht cilësi e Zotit, âsht nji mjeshtëri e shenjtë. Ata qi merren me edukatë të njerzis janë pajue me cilësi hyjnore. Prandaj vlefta e arsimtarit âsht shum e naltë. Mirpo nji arsimtar qi kërkon me dukue tue mbjellë idena atheiste nuk mund të jetë kurrë nji arsimtar i vërtetë. Faktet e idhta i kemi dishmitarë. Njeriu i çveshun nga frika e Zotit âsht në gjendje me gjetë shum rrugë për t'i shpëtue synit të policis e të gjindarmerisë. Arsimtarët duhet t'a duën ma tepër Zotin pse e kanë bashkëpuntor e ndihmëtar në misionin e edukatës. Arsimtarët qi përpiqen me shartue ndër nxanës të tyne iden e atheizmit janë kundra misjonit të vet; pra nuk janë arsimtarë. Propaganda, me të cilën kërkojnë t'u mbushin menden fëmive se <<prindënit e tyne qi ndjekin e pratikojnë dispozitat e fes janë fanatikë dhe injorantë>> âsht nji propagandë shumë e gabueshme. Pse ka shum prind qi janë në nji gjendje kulturale shumë mâ të naltë se ajo e mësuësit dhe kur shofin se mësuesi po u nep nji drejtim të gabueshëm, i u korigjojnë ketë drejtim tue qitë në shesh gabimet e mësuesit. Atëherë ç'fuqi mund të ketë edukata e këtij mësuesi? Këjo âsht arsyeja, për të cilën Pedagogjija porosit mësuesin qi mos t'a cënojë e mos t'a luftojë feén e nxanësit qi ka prû prej familjes; përkundrazi të përpiqet me përfitne prej saj.
Po t'i ndryshojmë librat e shkrueme në konformitet me ketë porosi pedagogjike, âsht nji mëkat i pafalshëm. Ndofta nuk besohet se bâhet nji shpërdorim i tillë; por ne e vërtetojmë.
Në këndimin e rendit të pestë të fillorevet botue prej

Ministris s'Arsimit me 1927 në faqe 48, mësimi <<45. Zemra e trimit>> këndohen këta rrjeshta,, Sikurse gjithë njerzit, kështu edhe ky priste shpëtim prej Zotit në ketë minutë të frikëshme; prandaj sa përmblodhi vehten e pa qi ishte vetëm, ra në gjujë e u lut: „O Zot fuqimadh e shpëtimtar, ep-më fuqi ndashti, qi të mbush detyrën besnikisht dhe bâhu ngushëlluësi e babai i tetë femive, qi po i lâ të vorfën!"

Këto rrjeshta po të ktij mësimi, në këndimin e botuem më 1935 në faqen 58 kanë bâ ketë ndryshim;

„Sikurse gjithë njerzit, kështu edhe ky mundohesh me shpëtue në ketë minutë të frikeshme: prandaj, sa përmblodhi vehten, dhe me nji herë i shkoi mendja ke tetë fëmijt, që ishte në rrezik me i lânë të vorfun e jetimë".

Tani vetëm Ministrija e Arsimit – e sidomos Ministri, i cili pret prej Perëndisë qi të dalë me faqe të bardhë – mund t'a marrin me mend përshtypjen qi bâjnë këta ndryshime ndër nxanës e nxanëse të shkollave. Kush i ndryshoi këto fraza? Auktorët e librit, a Shtypshkronja, a po Ministrija e Arsimit? Cilin libër t'a besojnë nxanësit për të vërtetë, të parin apo të dytin? Si do t'a mbyllë mësuesi ketë problem të koklavitun? Më 1927 paska pasë Zot, më 1935 nuk paska pasë!

Tue marrë para sysh këta anoralira, kemi të drejtë me pretendue se edukata antifetare âsht e rrezikëshme për nji popull; sepse këjo edukatë i bân njerzit ipokrit e të paqendrushëm në idet e tyne.

Hazreti Pejgamberi Alejhiselam urdhënon <<Un jam dërgue vetëm për të plotsue moralet e nalta.>>

E me nji Hadithi Sherif tjetër urdhënon: <<Pajosuni me moralet e Zotit.>> Simbas versetit <<O njerëz, adhuroni Edukuesin t'uajë...>> kuptohet se mjeshtrija e edukimit âsht nji cilësi e Zotit. Prandaj edukuesi mâ i mirë âsht aji qi i stërvit nxanësit e tij me respektue e me adhurue Perendinë.

Nji tjetër cilësi e Zotit qi përmendet në verset âsht cilësija e Krijimit. Në feén Islame edhe puna numrohet adhurim. Pra qi të pajosemi me moralin e Zotit duhet të punojmë sa mâ tepër; sepse me këtë mënyrë edhe adhurim kemi bâ edhe kemi shti në dorë mjete të mjafta për të vû në praktikë dispozitat morale të feés; se vetëm me këte mënyrë mund të pajosemi me moralin e Zotit, i Cili si Krijuës âsht në veprim gjithnji. Pra edhë ne duhet të jemi gjithnji në punë.

Po të vazhdohet teposhtë teksti i versetit gjejmë hollsina tjera. Bije fjala fraza: <<Adhuroni zotin i Cili e bâni Tokën shtresë e qiellin strehe edhe uli prej qiellit ujë me të cilin nxori për ju ushqim pemësh...>

<<...e bâni tokën shtresë>> don të thotë <<e bâni të përshtatun për banim të njerzis. <<E bani, si me thanë, as të fortë fare as të butë fare. Po t'a kishte bâ të fortë si shkamb nuk do të ishte e përshtatun për t'u punue e për të rritë bimët e ushqimet tjera. E po të ishte e butë fare, si ujët, s'do të mundesh me u banue. Atëherë pra Aj Zot qi i ka vû ketë masë tokës âsht nji Zot me plot dije e jo nji natyrë e verbët si pandehin atheistët.

<<E qiellin e bâni strehe>> don me thanë qiellin e ngrefi n'atë mënyrë na ruën nga shum katastrofa.

Të ndërtuemit e qiellit në formën qi shofim na dishmon shum gjâna të mrekulluëshme.

Verseti pastaj flet për fenomenin e shiut e për pemët qi nxjer toka. Me të vërtetë sa mrekullina ka për njerzit e ditur të ramit e shiut!

Edhe me të vërtetë sa ligje të mrëkullueshme janë ata qi rregullojnë të ramit e shiut, ligjë të caktueme me dije e vullnet të plotë, ligjë qi dishmojnë se universin nuk mundet me e sundue nji fuqi e verbët e qujtun natyrë. Ketë univers mundet me e sundue nji Zot i Amshuem, i Dijtun dhe Sovran, i Gjallë e Përmbajtës qi s'ka nevojë për kurrëgjâ. Ky Zot âsht gjithnji n'aktivitet.

Tue e dijtun njerzija ketë gjâ me sa mend guxojnë me mohue Zotin dhe Edukuesin e gjithësis?
Këta hollsina qi spieguëm duhet të tërhekin verejtjen e njerzvet të ditun mbi faktin se Kurani nuk urdhënon nji besim të verbët por i parashtron mendes njerzore gjithësinë don me thanë, veprën e Zotit edhe e këshillon të gjykojë e të arsyetojë. Nji mende e pagabuëshme qi studjon gjithësin do të vijë në përfundim se <<gjithësija s’mund të krijohet vetvetiu.>> Atëhere?- Atëherë:<<Mos i bâni pra shok Zotit, mbassi e dini se këto punë vetëm Zoti, i bani! Urdhënon Kurani në mbarim të versetit 22. Kap II.

# Morali në sy të Kur-anit[1]

Mëslimanizma nuk asht dërgue e posacme për nji popull ase e caktueme për nji kohë e stinë dhe prandej rrethin e stërvitjes për moral e ka te gjanë sa rethi i njerzis mbarë. Kur-ani asht gurra e të ngritunit për të vobektët e për pasanikët si për ata njerës qi rrojnë mbrenda kushtevet të gjallnis ashtu edhe për ata injorantë të cilët kalojnë jetë primitive dhe aq për të ditunit e filosofët sa për ata qi mirren me tregti dhe kështu edhe për ata qi kalojnë n'udhën e mirë me të rujtme e të drojtme të cilët u janë shmangë andjevet e kandjevet të kësaj botë. Prandaj si qi ka mësue rregullat për gjallni ashtu ka lejue pranimin e prensipevet të përgjithshme si kushte të jetës qi kalon. Kur-ani me nji anë ju mëson rregullat të cilat e ngrejnë njerin prej shkallës ma të poshtme në kulmnin e meritueshëm të qytetnimit u tregon vijat e regullat e shoqnimit më anë tjetër përmbledh gjithë parimet për me ndricue e udhëhekë ata qi janë në kulmet e naltësis së moralit të mirë e përparimit të kandëshëm shpirtnuer. Për me provue kët të thanë, do ti analizojmë shkurtazi se si e tërhekë dhe e ngre në naltësi morali nje njeri primitiv. Kur-ani i madhnueshëm nji njeri primitiv për me e shpëtue nga gjindja e egër e për me e qytetnue, përmbledh shum urdhëna punimi e ndalimi. Kur-ani atyne njerzve qi ndodhen në kët shkallë u thotë: "Asht e ndalushme për ju me u martue me nanat, me motrat, me bijat, me emtat, me bijat e vllaznevet, me mbesat,

1. Marrë nga "Zani i Naltë", 1938, 2.

me nanat nga sisa e me metet e fëmivet dhe me marrë nji heresh dy motra. Asht e ndalueme kategorikisht me ju ba trashgimtar bashkëshortevet tjua kundra dëshirës tyne. Gjanat e mira e të pastërta janë të lejueshme, gra të ndershme në mes të besimtarevet dhe gra të ndershme t'atyne popujve, për të cilët ma përpara ka pas libër qiellor, tue iu pague të drejtat mundeni ti mirrni me kunorë. Mos vritni vehten, Mos vritni fëmijt t'uej. Pa marrë leje nga të zotnit, pa i përshëndetë e i salutue mos hyni në për shtëpijat tjera, për vec se t'uejës, po nuk pat njeri mbrenda, pa leje leje mos hyni në shtëpit kujt, në qoftë se ju thotë këthehuni me nji herë këthehuni, kjo asht ma e mirë për ju. Në shtëpijat hyni nga dyerët. Kur tu salutojnë përshëndetjen përballonja me nji formë ma të mirë, ase mjaftoni vetëm me përballim. Bixhozi e pijet janë nji farë të këqijash, punë djalli nga këta ruhi. Mish të vdekmi mos hani. Kur të jeni në mbledhje po tu thonë bani vend tjetrit hapni vendin. Hani pini por mos prishni tepër. Flitni gjithnji fjalën e drejtë e të vërtetë. Pastroni kokën e të përsipërmen tuej, largohi nga cdo ndytsi. Kur të hecni as mos nguti shumë as mos hecni ngadalë, kur të fjalosi as mos e ngrini as mos e ulni aq poshtë. Ndajuni nji pjesë nga pasunija e juej të vobegtëvet e atyne qi skanë gja". Parimet e para të Kur-anit për me përmirsue njerin janë në kët formë. Të tillë urdhna e ndalime kan fuqi reale për me e ngritë njerin e egër në nji gradë njerzore të meritueshme me vërcën e njerzis. Këta urdhna nuk janë nga udhëheqsa qi e ngrejnë njerin në shkallën ma të naltë të moralit, por janë vetëm parime e principe për me e shpëtue nga barbarizma. Kur-ani i madhnueshëm pik së pari këto i ka numurue si spjeguem shkurtazi prakmin e parë të përmirsimit, të fillojmë nga shkalla e dytë. Kur-ani, mbassi shpjegon mënyrën e udhtimit për me shpëtue nga barbarizma, mëson dhe morale të nalta, qi këtu do tu rreshtojmë disa pjesë:

Të gjithë cilsit morale mund të ndahen në dyshe:

1. Ata qi të ndalojnë me i ba keq tjetrit
2. Ata qi të nxisin me i ba mirë tjetrit

Në pjesën e parë përmblidhen urdhnat qi e detyrojnë njeriu me gjuhë, me dorë, me sy e me cdo gjymtër tjetër me mos i ba keq e me mos i cënue nderin, me mos i grabitë pasunin, me mos i prekë në shpirt tjetrit. Pjesa e dytë përmbledh gjithë mendimet e punimevet të njeriut për me i bamë mirë tjetrit.

Huqet qi të ndalojnë nga e bamja keq njeriut janë katër:

1. Me e rujtë nga të ligat e të ndalumet.

Ai njeri qi ka kët cilsi ruhet prej cdo të përpjekuni qi asht jashta gardhit të sheriatit. Kur-ani tue të nxitë për me i ftue njerzit me u ruejtë nga këto të përpjekme thotë: "Ruhuni nga kurvënija, ata qi bajnë kët, kanë bamë nji faj të lig deri në pikën ma të fundit dhe kanë hye e kanë ranë në nji rrugë e greminë të ligë.

2. Me qenë i ndershëm, kuptim i së cilës të largon nga mashtrimet, të ruen me rrejtë të tjerë e me i futë në dam dhe me mënyra jashta sheriatit nga të grabitunit kujt pasunin e nga tjera si lëvizje e veprime te liga si këta. Kjo cilsi e ngulët ne instiktin njerzuer, nji cilimi tue përjashtue kohët e jashtzakonshme qi të jetë në gjindje mos kuptimi, nuk do tjetër vecse qumësht nga sisa e s'amës. Për me cfaqë cilsin e nderit, Kur-ani i madhnueshëm thotë: "Në qoftë se në mës tuej ka asi qi janë mendje lehtë ase asi qi nuk kanë mbrri në moshën madhore dhe zotnojnë pasuni, por janë në gjindje me e rregullue, ato pasuni i rregulloni me cilsi kujdestari, siguroni ushqimin e tyne, vishni e mbathni fund e krye dhe tue i fole fjalë të mira, mundohi për cvillimin e mendjes së kuptimit të tyne. Bani ata të punojnë mbas kapasitetit tyne dhe bani provë për me kuptue në se e kanë marrë vesht apo jo atë qi ju i keni mësue. Kur tarrijnë në moshën e madhe, në qoftë se e kuptoni se janë në gjindje me i shikue punët e

tyne e me administrue pasunin e tyne, epjani. Kujdesohi me të madhet mos prishni ndonjë gja të tyne tue mendue se do të rriten e do ju marrin pasunin. Në qoftë se kujdestari asht i pasun e ne gjindje të mirë le të mos marri gja si shpërblim nga pasunija e tyne e në rast se asht i vogegët të marri nji shpërblim të arsyeshëm. Kur tu epni pasunin këtyne, krynja kët punë faqe dëshmitarësh. Të gjithë këto versete janë shemëblla me shpirt të vepravet me ndërgjegje e me nder. Kur-ani i madhnueshëm prap thotë: "Mos i paguni mit gjykatësvet me qëllim qi të futni në dorë pasunin e tjetrit dhe të prishni pasunin tuej në të kotë e imoralisht." Zoti për madhnin e tij urdhëron me ia dhanë at gja qi i runi (peng) atij qi të meritojë. Po të peshoni nji gja, peshonja të plotë, mos u bani nga ata qi peshojnë metë. Kundrejt gjanavet të mira mos ipni gjana të këqija. Të gjitha këto pika udhëheqse të ndershme tregojnë lëvizjet madhështore të moralit të naltë.

3. Dashtunija për paqe, cilsi kjo qi asht nji dhuratë e pa cmueshme për njerzimin. Kur-ani për mbi kët cilsi thotë: "Paqa asht mirni, siguroni në mest tuej paqen, në kërkofshin paqën edhe ti kërko paqe."

4. Edukata morale, për të cilën Kur-ani thotë: "Foluni njerzvet sendet e mira. Meshkujt mos tallen me meshkujt, ndoshta këta janë ma të mirë e ma të mbarë se ata. Dhe gratë mos tallen me gratë, ndoshta këto janë ma të mira se ato, mos u gjindni kundra njani tjetrit, mos i hidhni e mos i vini ofiqe njani tjëtrit, mos bini në dyshime të liga për njani tjetrin, të tilla dyshime janë mëkate, mos bani qi të daheni njani tjetrin, kini frikë nga Zoti. Po nuk patët në dorë dokumenta të shëndoshta e të preme mos i hudhni ndonji faj tjetrit". Kështu mbasi spjeguem huqet e mira, të cilat ndalojnë me bamë të liga, mund të fillojmë me radhitë nxitjet Kur-anore për të bamë mirë të tjervet.

1. E falmja ----Nji njeri, qi i bahet nji dam e ndëshkon at qi guxon me e damtue, po të heki dorë nga ky

tagër e po ta fali kët njeri, i ban me të vërtetë nji të mirë. Kur-ani thotë: "Ata qi shtypin e bahen ngadhnues mbi të thyemet shpirtnore dhe falin tjerët, kanë ba mirëm ata qi bajnë të këqija vuejnë ndëshkimin e dënimin, por ata qi i falin dhe ata të cilët e bajnë faljen me vend e me kët falje i shërbejnë të përmirsohet guximtari i së ligës, ia mbërrijnë shpërblimit të të madhit Zot". Kur-ani, si shifet pra, nuk na e mëson faljen pa kusht e pa cak nuk thotë mos i bani as ndonji qëndrim kundra të ligës, mos i epni dënim keqëbamësvet, por tue gjykue gjindjen e nji njeriu, në qoftë se asht nevoja, porosot me përdorë fuqin e faljes qi ke në dorë. I ligu, në përfiton nga falja e në qoftë se e përmirson gjindjen e tij, mund të falet. Por tue mendue se ndoshta ndodhë qi kjo falje e tërbon guximtarin e bahet si i nxitë për përsëritje të ligash, prandej pra Kur-ani ashtu sy mylltazi nuk të porosit me falje.

2. Drejtësia.
3. Të bame mirë e dhurim.
4. Mëshirë e dhimsuni.

Kur-ani thotë: "Zoti urdhënon drejtësin, të mirën kundrejt të mirës, dhurimin, të bame mirë pa përballim e shpërblim, dhimbë për farë e fisin dhe ndalon kurvënimet, dhelpënimet e poshtuna, të shkumen kundra drejtësis, mohimin edhe të mirën me e cue në përfundim të keq, tiranin dhe të cfaqmen e ndijes së dhimsunis në nji gradë të pa meritueshme". Ky verset tregon tri shkallë të mirësis. Hapi i parë, përballimi i së mirës me të mirë. Cdo njeri qi e kupton të mirën e përballon me të mirë. N'at kohë qi të ngrihemi në hapin e dytë, ifllojmë me e ba të mirën pa pritë ndonji përballim, por kjo e mirë duhet të jetë e xhveshme nga të përshpëritunit ase nga shqetsimet, mbassi Kur-ani thotë: "Mos i prishni të mirat tuaja me përshpëritje e shqetsime". Shkalla ma e naltë e bamirsis asht qi me e ba të mirën me ndije e nxitje të kthjellët e të sinqertë dhe me tregue dhimbën si nana për fëmij.

Kjo asht ma e nalta e ma të tepërt se kjo nuk ka. Verseti, mbasi parashtron këto spjegime, tregon se e mira duhet të bahet me vend se po të mos bahet me vend, merr formën e mëkatës, mbasi natë kohë e natë mënyrë drejtësija coroditet në kurvëni, dhurimi me mohim e dhimba në tirani.

5. Trimnija, kjo krenari në sy të Kur-anit të madhnueshëm nuk asht të dudhunit e të sulmuemit, por asht aji forcim e qindrim qi tregohet në kohë të volitëshme e në përfundim të nji mendimi të fellë të nji gjykimit të shëndoshë. Si mbas Kur-anit, trima të vërtetë janë ata qi në kohë të kritikueshme e të rrezikshme nuk e humbin, po qindrojnë mbi udhën mezatare e tregojnë forcim. Dhe prap ato janë trimat e vërtetë qi njerzit kur u thonë atyne se janë pregatitë e grumbullue shumicë kundra atyne dhe duhet me u frikë nga ata këtyne u forcohet besimi shum e ma shum. Mbassi trimnija e këtyne nuk asht si trimnija e egërsinavet e mbështetun në lakmi qi asht drejtue në nji vije, lëvizje mekanike. Ndoshta këta me trimni u qindrojnë lakmimevet e u përballojnë në të këqijat e të ligat; këtë e tregojnë vetëm për të drejten e udhën e së vërtetës.

6. Me qenë i drejtë. Njeriu po të mos jetë pas nji të lige, flet fjalë të drejta, ban punë të drejta. Kur-ani gjithnji të shtyen për në të drejtë (Ruhuni nga poshtënimi i të falunit t'idhujvet e nga të rrejtunit). Kur-ani me këtë verset si rrenën ashtu edhe robnin e të tjerëvet vec Zotin e gjen të nji kategorije të keqe e njikohësisht me nji fryme nji lloj të fajshme. Prap Kur-ani thot kur të thirii dëshmitarë, mos me u shmangë nga e bamja dëshmi e me dhanë fjalë të drejta, me tregue të vërtetën, ata qi mbëshefin të vërtetën bajnë mëkatë. Kur të flitni, folni drejtë me nder e me sedër, si kur të dali fjala edhe kundra farë e fisit tuej. Përgjithnji bahuni ndihmës i së drejtë e i së vërtetës, si kur përfundimi të dali dhe kundra vehtes tuej apo prindvet a farë e fisit tuej". Nji nga cilsit ma të nalta të kësaj pjesë asht

durimi e pranimi i të bajtunit të barrës të cdo katastrofe e të cdo mundimi me i hapë prazmin.Mbassi shpjeguem kët shkallë të dytë të zhvillimit njerzuer, mund të hypim në të tretën e të shkojmë në kushtet shpirtnore të njerzimit. Furra e këtyne kushteve asht qetsija ashpirtnore e të ngopunit e tij. Ai shpirt qi ia mbërrin qetsis e kënaqësis të së ngopmes e ngren njerin nga fusha e huqevet ne hapsinën spirituale. Qetsija dhe e ngopuna e shpirtit e ban njerin me ia mbërrijë parajsës qy në faqen e dheut të kësaj bote. Në nji të tillë shpirti nuk ngel shejë nga lakmit shtazore dhe të gjitha dobsit e të metat e tij mbështihen e ke ata sundon vetëm dashunija e natësimit të kthjellët. Kë nji i tillë shpirt nuk ngel as nji grimë nga e pa pasmja në vehte drejtësi e qëndrim. Zoti për madhnin e tij këtyna shpirtnave i ka shkrue e skalitë besimin edhe me forcën e shpirtit tij i ka forcue. E gjithë andja e kandja e të tana stolit e besimit janë në zemrat e këtyne. Mohimi, mëkati e të pa njoftmes e mos ndigjimi i urdhnavet të Zotit, janë të largët nga zemrat e tyne. Ata qi me të vërtetë shofin larg e mendojnë përfundime të qarta ia bërrijnë kësaj shkalle. Kur njeriu asht në shkallën e dytë, në zemrën e tij luftojnë naltësimi me poshtënimin me përfundimin të kësaj bote me sukses e me ngadhnim të naltësimit, shpirti piqet me botë të re, me dritë të re. zoti për madhnin e tij këtyne njerzvet qi hyejnë nudhën e tij u premton dy parajse: nji në kët botë dhe nji në botën e amshimit. Jeta qi kalojnë në kët botë këta njerës të pjekun e të plotsuem, asht nji parajs qiellor, ku shushurisin rrjedhje ujnash, sepse besimin e tyne e stolisin lëvizjet ma të bukra, naltësimet morale madhështore e punimet e tyne të kandëshme e të pranueshme. Ky besim asht por si nji pemë qi i ka rranjat në tokë e degat në qiell dhe cdo minutë ep fruta. Kurani asht mbushë me ajete qi tregojnë të tilla faqe të ndritshme të naltësimit e plotsimit të gjallnis. Shifet kjartazi se Kur-ani i madhnueshëm ka përmbledhë e ka vue gjith

parimet e prencipet udhheqës për rrugën e përparimit, në të cilën do të kalojnë për me shpëtue nga egërsina e primitivitetit e të bahet i dejë njeriu për me u futë në gjini shpirtnore i naltësuem. Këto udhëheqje hyjnore si e përfshirë cdo faqe e fazë e punimit të njerzis janë shkak edhe për zhvillimin e të gjitha fuqivet të sundimit spiritual të njeriut. Myslimanizma kërkon të zhvillojë cdo brumë essense e fuqi të nejriut dhe kët e lidh me kushtin e vetëm me ba punën në kohë të volitshme të sajë. Myslimanizma kërkon qi njeriu të tregojë trimni dhe mëshirë e butsi, por qe të dyja duhet të jenë me vend e me mend. Myslimanizma të mëson e të stërvitë me të falme faji, por manë tjetër, në qoftë se origjina e sulmimit meriton ndëshkim, urdhnon dënimin si mbas fajit. Myslimanizma thotë: Mos u ndaj nga e falmja në rast se i shërben të mires e përmirsimit. Myslimanizma na mëson me tregue qendrimin ma të fortë kundra cdo të cfaqme të kundert të fatit si kur të cojë edhe në gushtica të pa kalueshme e në barrë të pa mundëshme me mos u nda nga nderi e me mos prishë karakterin. Me folë të vërtetën dhe në rast qi del kundra teje a të shokut ma të dashtun ase të fisit ma të afërme, me shkelë fitimet e dobit vetijake e me ndejë para tjervet korekt e i ndgjueshëm, me përballë katastrofat ma të ashpërta e me u ba mirë edhe atyne qi të kanë ba të keqe. Myslimanizma tregon udhën mezatare, kërkon qi njerzit rrotullimin e ounvet të tyne ta shëndrisin me ata atributa qi u ka falë i madhi Zot. Myslimanizma nuk kërkon qi njëriu të hjekë dorë kryekëput nga gjatë qi i takojnë kësaj bote e qi e lidhin me njerzimin. Myslimanizma urdhënon njerzit jo të lanë botën por të mos dahen nga pastërtija e nga cipa e nderit, ti përugjen e ti bajnë robni të madhnit Zot, por të mos shkojnë në rrugën e mbylljes së klerikalizmes, të ndajnë lëmoshë nga pasunija e tyne, por të mos bien vetë në skamje e vobegsi. Myslimanizma sa do qi urdhënon me qenë vet mohues e të lëshue e të dorzue,

por kërkon me mos humbë ndijen e respektimit të vedit e me mos rrezue e poshtënue vehten dhe sadoqi të nxit për me ba falje e përdëllim, të ve gardhin me mos i lanë fushë të hapët të liqëvet e me mos shkatarrue jetën shoqnore. Myslimanizma stërvit qi se cdo njeri të përfitojë nga e drejta e tij, por të mos i cenoj tjetrit ndonji të drejtë.

## Shpëtim ngadhnim

Si prapashtim do të shtojmë se ndaj Kur-anin madhnueshëm shpetimin prej të këqijavet, ngardhnim mbi të mirat janë nji plotsim e kënaqsis e formojnë të ngopunit e shpirtit. Qetsija shpirtnore jo vetëm me shpëtim nga mekata e skllavënija e të shërumit gjith dobsinavet e pastërimin nga të metat e të mangëtat. Por duhet të jetë i pregatitë i mobilizuem me nji forcë e me nji fuqi morale, sa qi të fitojë përgjithsisht nji plotsim e për sosmeni ma të naltë. Për kta qi i kanë mbërrimë shpirit të shpetimit Kuranit thotë: "Ata nuk do të përpiqen as me ndonji idhni e zi" shpetimi nuk asht vetëm për botën e amshueme, fitohet në kët botë. Njeriu për me gjetë shpëtimin e qetsis në botën e amshimit duhet qi atë ta fitoj që këtu.

**Salih Ferhadi**

## Hazreti MUHAMEDI Alejhiselam[1]

**Zotni të ndershëm**

Sot asht aniversari i asaj dite të Madhe e të bekume në të cillen, si mbas dokumentave historike ma të sakta, Zotnia i Gjithësisë ra në botën landore dhe ndriçoi këtë jetë.
Sod ka lé mâ i madhi Profit qi lavdërojnë edhe shenjtërojnë muslimanët; sod ka lé ma i madhi njeri, i cili me madhështin qi ka habitë çdo mende, ka tërheqë admirimin edhe të jo mushmanëve të urtë e të arsyeshëm.
Sod ka lé aj njeri i naltë, të cilit i zbriti ma i persosuni libër qielluer qi ka caktue e garantue të drejtat jo vetëm të njerëzve, por edhe të shtazëve, sikurse e dishmon verseti i naltë <<Ve fi emválihim hakkun lis-sáili vel-mahrum.>>
Po, zotni të ndershëm, sod ka le aj Profit i madh, të cilit i erdhi prej perendis Kurani qi po çmohet aqë ma tepër sa më tepër asht tue u zhvillue shkenca.
Sod ka le ma i madhi Resul, qi, sikur na dishmon verseti i naltë: <<Ve ma erselnaqe il-la qaffeten lin-nasi>> asht dergue prej të Madhit Zot me i mësue jo vetem nji fisit, ase nji kombit, por mbarë njerzis parimet e dobishme të bashkimit, të drejtsis, të barasis, të respektit, të moralit e të virtytit.
Sot ka le burimi i begatshëm i të tanë virtyteve qi çmohen e shenjtërohen në pikpamje të ditunis.
Shpallja e deklaratës të (së Drejtave të njeriut) nuk asht vepra e çpikun prej këtij ose atij, por asht reflekti i asaj Drite të Hyjnushme.

1. Marrë nga "Zani i Naltë", 1938, nr. 5.

Sot ka le ajo Dritë e Botës qi na ka tregue se errsina mohon të verteten, kurse drita tërheq ndaj e vërteta.
Shkenca e njeriut asht përpjekë e po përpiqet pa j'a da me zbulue rregulla të reja për jetën shoqnore qi asht mjeti i gjallnis; mirpo sistemet e diktume dëri me sot a nuk kanë mundë m'e persjellë njerzinë në breg të shpëtimit, ose edhe në ka nuhatë njërzija ndonji aromë të shpëtimit, edhe kjo gja asht vërtetue se ka kundërmue prej shkendis qi ka shkrepë dekreti i naltë: <<Innell-llahe jeëmuru bil-adli vel ihsani>>, të cilin i Madhi Zot ja kumtoj asaj drite të së Vertetës. Qeh kjo dritë e madhe ka le sod: Sod ka le ma i madhi Haqim i Botës. Fjalën (Haqim) asht ba zakon m'e shprehun shqip me fjalën (filosof); porse kjo fjalë nuk i pergjegjet plotsisht qëllimit. (Filozof) don me thanë me e dashte e me kërkue të Verteten, kurse (Haqim) don me thanë me e dijtë të Vertetën.
Pra, kur themi <<sod ka le ma i madhi Haqim i Botës>> e kuptoni vetë, Zotni të ndershem, se çfarë njeriu ka qenë Aj qi ka le sod!
Sod ka le aj Haqim i Madh qi j'a mësoi njerzis barazinë me urdhnin hyjnuer: << Ja ejjuhennasu inna khaleknaqum min dheqerin ve untha... li tarefu... Në vijim të këtij verseti vjen fraza: <<Inne eqremequm indell-llahi etkaqum.>> Këjo pjesë na vërteton se nuk ka barazi midis virtytit e vesit.
Pra sod ka le ma i Madhi Haqim qi na ka mësue se <<barazija absolute>> i sjellë shkatrrimin njerzisë.
Sod ka le ma i Madhi Socjolog i botës, i Cili i mësoi njerzisë se Hyjnija i perket krijusit, adhurimi dhe të lutunat duhet t'i bahen vetëm Perendis e me këtë i diftoi botës se të tanë njerzit janë baraz e të lirë midis tyne, me qenë se janë robët e krijuem prej nji Zotit të vetëm e të vërtetë. Për këtë gja urdhnon Kurani: <<El-hamdu lil-lahi rabbil-alemine>>
Sod ka le aj socjolog i madh i cili na mësoi se lirija ka

nji kufi të caktuem qi s'duhet të kalohet; ky kufi asht respektimi i të drejtave të tjetrit dhe Aj Resul i Madh me dispozitën e naltë Kuranore: <<E jahsebul insanu en jutreqe suda>> i dha shqelmin anarshizmit.
Sod ka le njeriu ma tejveshtrues i botos qi me versetin: <<Vaétesimu bi hablil-lahi xhemian ve la tefer-reku>> e këshilloi njerzinë me u bashkue ner ligjët shoqnore t'arsyshme e me këtë mënyrë e siguroi lumtërin e përgjithëshme.
Sod ka le Aj Njeri i Madh qi i mësoi njerzis se organizatat politike qi ndjekin udhën e immoralitetit nuk kanë jetë e vazhdim edhe s'mund të qendrojnë.
Sod ka le ma i madhi Udh rrëfyës i njerzis, i cili e çmoi dhe e deshi virtytin, j'a mësoi ndergjegjes iden e virtytit e kështu me shum versete kuranore e me shum urdhna profetike j'a ndriçoi njerzis udhën qi mos t'u shtëmanget ndërgjegja nga rruga e drejtë në atë të shtremten.
Sod ka le gurra e virtytit qi me urdhnat profetike: In ne ma buithtu li utem-mime meqarimel akhalaki>> <<El-islamu husnul-khuluki.>> j'a përhapi njerzis virtytin e moralin.
Pse me e zgjatë fjalën, Zotni? T'a themi shkurt: Hazreti Muhamedi Alejhisselam asht aqë i madh e i naltë, sa qi mos t'a kishte vendosë unitetin arsyeja, ndjenjat njerzore, të habituna përpara madhështisë së Hazreti Muhamedit, këtë personalitetit të naltë do t'a naltsojshin deri në divinitet. Mirëpo, qoftë bekue Islami, qi e ka pranue arsyen si dominues mbi ndjenjat dhe nuk i la me rrëshqitë.
Pranej, Zotni, ne sod këtu nuk do të flasim as për mrekullit e venerueme qi u çfaqën në çastin qi leu kjo fytyrë e shkëlqyshme, e as për historin e jetës së shkelqyeshme të këtij Profiti të Madh.
Vetëm nji gja do të themi: Gjithsecili individual ose kolektivitet qoftë qi dëshiron me u lumtënue në dynja e në ahiret duhet të ndjek për model të jetës së vet, jetën e

shkelqyeshme të Hazreti Muhamedit; n'atë tabelë të pastër e të qartë, n'atë libër të shenjtë do të gjejë nga nji pasqyrë për të gjitha fazat e jetës.
Aty do të shofë se si durimi i ban ball ngushticave ma të vështira të vobegsisë; aty do të shofë se pasunija e lumtënija nuk mund të kenë marrëdhanje me egoizmin e me krenin; aty do të shofë se si pajtohen e akordohen midis tyne jeta e pamartume me pastertinë morale, virgjinija me frenimin e ndjenjave epshore. Në këre pasqyrë të shkëlqyeshme shef njeriu se sa çerdhe e lumnueshme asht martesa.
Ke Hazreti Muhamedit Alejhiselam shef begatin e lumtënin qi mund të sjellin tregtija, industrija edhe bujqsija qi pratikohen me drejtësi e me seriozitet.
Ke Hazreti Muhamedi shofim tipin e Komaodantit të madh qi me mënyrë të ndershme mbron nderin e fees e të atdheut. Ke jeta e Hazreti Muhamedit shofim rolin qi luen gjenija e nji diplomati në sigurimin e Paqit e të Qetsis.
Ata qi duen të mësojnë udhëheqësin e drejtsis së gjygjeve edhe sekretin e administrimit e të sundimit të mirë qi kënaq të tanë popullin, kushdo qoftë, le t'i studjoj si mbas aftësis e profesionit të vet të gjithë fazat e ndryshme të jetës së ndriçme të Atij Burri të Madh, ditlindja e të cilit po festohet me ceremonin e soçme.
Kurani i Naltë me nji tok versete, e sidomos me versetin 33 të Kaptinës Ahzabit <<Le kad qânë lequm fi resulillahi usvetun hasenetun>>, na këshillon e na porositë qi t'a studjojnë jetën e shenjtë të Hazreti Muhamedit Alejhiselam dhe t'rregullojmë veprimet t'ona mbas asajë pasqyre të bekume.
I perulun perpara Dritës së Hazreti Muhammedit Alejhiselam. I lutem qi t'a shtrijë Shefaatin e Naltë mbi Islamët, mbi Kombin t'onë e mbi Shpëtimtarin t'onë N.M.T.ZOGUN I.

**Sadik Bega**

## Kaptina e XXXVI e Kuranit
# Jasini Sherif-i
### E revelueme në Meqqe
### (Përfshin 5 pjesë dhe 83 versete)

Pjesa I-rë: Vërtetësija e Kur'anit
II-të: Konfirmimi i tij
III-të: Shenjat e vërtetësis së tij.
IV-të: Të ,mirët dhe të liqtë
V-të: Mbretnimi i Islamit

**Titulli, teksti dhe data e revelimit**
Titull'i i kësaj Kaptine janë vetë shkronjat fillestare Ja dhe Sin, me të cilat Perëndija i Plotfuqishëm i asht drejtue Profetit të shenjtë, H. Muhammedit (A.S). kjo Kaptinë e Kur'anit të shenjtë profetizon se Islamizmi ka me u stabilizue mbi faqe të Tokës dhe ka me triumfue kundrejt çdo kundërshtimi. Të njajtën gja deklarojnë edhe të dy kaptinat qi e parakalojnë bashkë me të tri kaptinat qi e pasojnë. Këto të gjashtë kaptina trajtojnë nji grup të vetëm. Kaptina e parë e këtij grupi cilet me fjalët *Çdo lavd i kushtohet Zotit*. Po me këto fjalë mbyllet edhe kaptina e fundit. Që të gjitha tregojnë se duhet të lavdojmë Zotin për triumfin e së Vërtetës. Kaptina Jasin asht revelue në Meqqe dhe i përket, në mos periudhës së parë të Meqqes periudhës së Mesme. Kështu, opinion i disave që e konsiderojnë të jetë revelue rreth të dhetit ase të njimbëdhetit vit të Dërgatës së Profetit të Shenjtë mbetet i pabazuem.

**Përmbajtja e subjektit**

Kjo Kaptinë naltëson Vërtetësin e Kur'anit të Shenjtë. Për këtë vërtetësi flitet në të parën pjesë të saj. Pjesa e dytë flet se shembulla që e konfirmojnë atë gjinden edhe në revelata të herëshme. Pjesa e tretë na tërheq vërejtjen mbi disa shenja qi tregojnë vërtetësin e Tij. e katërta na tregon se ata qi e pranojnë dhe ata qi e braktisin kanë me u dallue prej njani tjetrit, në mënyrë që shpërblimi dhe dënimi i tynë asht nji evidencë e vërtetësis së Kur'anit të shenjtë. Pjesa e pestë na tërheq vërejtjen mbi pleqnin qi pason rinin. Me këtë synon ti referohet dekadencës së kundërshtarëvet të Islamit. Së dyti tregon fuqin e madhe të të Plotfuqishmit, të Cilit i përket mbretnim i Qieliit dhe i Tokës dhe i Cili mundet me krijue në çdo rast shembullin e atyne qi krijoi qysh kur. Me këtë synon të tregojë se Islami ka me u stabilizue.

### Pjesa e I-rë

## Vërtetësija e Kur'anit

### Në emën të Zotit, Bamirës, i Plotmëshirshëm

1. O njeri![1]
2. Konsidero Kur'anin plot me urtësi;[2]
3. Asht ma se e sigurtë se ju jinni nji prej apostujvet.
4. Mbi nji udhë të drejtë.

1. Jasin, simbas Ibni Abbasit, në djalekt të Tajj-it, tërheq kuptimin ja-insann dhe don me thanë: O njeri ase o njeri i përsosun!. Qeshshafi, Komentuesi i Kur'anit të Shenjtë prej Zamakhsheriut, dhe Bahru-Muhiti, komentues i Ebu Hajjan, Imam Asiruddinit, citojnë shembulla të këtij shkurtimi, në të cilin njana prej të dy fjalëvet asht ruejtun, ndërsa tjetra përfaqësohet prej njanës shkronjë të randësishme. Ja tregon O dhe asht ruejtun krejt. Insan asht përfaqësue prej Sin. Komentatorët mandej bashkëzanohen se referenca në kët shkurtim asht për Profetin e Shenjtë. Ajo kaptinë në këtë mënyrë quhet Kaptina e Jasin-it, paqe dhe bekime mbi të.

2. E përktheva Ëav-in me fjalë Konsidero. Ëav-i tregon betim. Betimi në këtë rasë revelon nji profetësi, plotësimi i së cilës skjaron vërtetësin e predikimit të Profetit.

5. Nji revelatë e të madhnueshmit të Plotmëshirshmit.
6. Që jut ë mundeni me këshillue nji popull etënit e të cilëvet nuk qenë këshillue, kështu që ata janë të hutueshëm.[3]
7. Ska dyshim që fjala u provue për e vërtetë mbi ma të shumtit e tyne, kështu qi ata nuk besojnë.[4]
8. Na kemi vu sigurisht zinxhirë në zverqet e tyne, dhe këta zgjaten deri në mjekrat e tyne, kështu qi ata kanë ngritun krenët e tyne përpjetë.[5]
9. Dhe Na kemi vu para tyne nji pengesë dhe nji pengesë mbrapa tyne, mandej Na i terrësuemë (i u vumë perde) në mënyrë qi ata nuk shohin.[6]
10. Dhe asht e njinjishme për ta, i këshilluekini ase nuk i këshilluekini ju, ata nuk besojnë.[7]
11. Ju kini fuqi vetëm me këshillue atë qi ndjek përmendjen dhe ka frykë Zotin Bamirës në sekret; përgëzoje pra atë me falje dhe me nji shpërblim të ndershëm.
12. Na sigurisht ngjallim të vdekunit. Na shkryejmë ato që ata kanë bamë përpara si edhe gjurmët e tyne sikundër çdo send Na e kemi rregjistrue në nji shkrim të qartë.[8]

3. Këshilla e Profetit të Shenjtë në kët vend ishte për Mekkasit, ndërmjet të cilëvet nuk pat ardhun Profet. Që Profeti i Shenjtë ishte edhe nji këshillues i të gjith kombevet, ky asht nji fakt qi përmendet ndër vende tjerë të Kur'anit të shenjtë.
4. "Fjala u provue për e vërtetë" asht përdorun për Mekkasit. Kjo sasht tjetër veçse ajo fjalë qi flet për kundërshtimin qi ata i banë këshillës së Profetit, sikundër ndodh edhe ndër vende tjerë të Kur'anit të Shenjtë.
5. Asht nji përshkrim i qëndrimit kryeneç të të pabesëvet kundrejt predikimit të Profetit të Shenjtë.
6. Pengesa para tyne ishte pengesa qi i ndaloi të paraqiten për me pranue të vërtetën, ndërsa pengesa mbrapa tyne ishte pengesa qi nuk i lejoi për me u këthye qi të evitojnë dënimin.
7. Kalesa asht e njinjishme për ta, i këshilluekini ase nuk i këshilluekini ju, … asht nji parantezë dhe duhet të përkëthehet si e tillë. Tue përdorë këtë parantezë, kuptimi asht krejt i qartë, dmth Mosbesuesit e nji typi të veçantë, dmth ata qi nuk kanë asnji kujdes për këshillën e Profetit, nuk mund të përfitojnë prej predikimit të Tij. Ky interpretim e ban kalesën të pajtohet me shpirtin e Kur'anit të shenjtë.
8. Çka ata kanë bamë përpara don me thanë veprat e tyne, ndërsa gjyr-

## Pjesa e II-të
## Konfirmimi i Vërtetësis së Tij

13. Dhe sjellu atyne nji shembull të popullit të qytetit, kur erdhën aty të dërguemit.
14. Kur Na dërguemë pranë tyne dy, ata i përgënjeshtruenë që të dy, mandej Na i forcuemë(ata të dy) me nji të tretë, në mënyrë që ata (të tre) thanë: Na jemi sigurisht të dërguem pranë jush.[9]
15. Ata u përgjigjën: [10] jo vetëm qi ju nuk jinni tjetër veçse të vdekshëm si nëve, por edhe Zoti Bamirës nuk ka revelue ndonji send: ju s'bani tjetër veçse gënjeni.[11]
16. Ata thanë: Zot i ynë e din se na jemi me plot siguri të dërguem te ju.
17. Dhe kurrgja nuk na asht ngarkue me përjashtim të nji kumtimi të qartë (të mesazhit).
18. Ata thanë: na sigurisht ndjejmë nji ogur të keq në ju: [12] në qoftë se ju nuk tërhiqeni, na kemi me ju shtypë pa dyshim me gurë dhe ska dyshim që ka me ju prekë prej

mët e tyne janë shenjat qi lenë mbrapa për me i pasue të tjerët.

9. Duhet të merret shënim se kjo asht thirrun në versetin e parë nji shembull (parabole). Atëherë asht gabim me pasë qëllim nji qytet të veçantë dhe tre të dërguem, të cilët kishin me shkrue së bashku aty. Shembulli asht vu për me tregue Vërtetësin e Profetit të Shenjtë. Të dy të dërguemët e ma parshëm janë H. Musaj dhe H.Isaj që profetizuenë ardhjen e Profetit të Shenjtë, H. Muhammedit. I treti me të cilin ata u forcuenë, sasht tjetër veçse H. Muhammedi, plotësimi i profetësis në personin e tij forcoi në të vërtetë Vëretësin e revelatës së parë. Si ndjekësit e Musajt ashtu edhe ata të Isajt qenë përpjekun për me konvertue Arabin dhe me e reklamue, por që të dy palët dështuenë. Atëherë, nji i Dërguem i tretë u çue nga ana Perëndimore.

10. Mesazhi që profetët u komunikojnë popujvet të tyne asht i përgjithshëm, po kështu edhe përgjigjia e popujvet, gja qi asht në konsonancë me shembullin.

11. Duhet marrun shënim se populli në kët rast mohoi çdo revelatë. Ata përgënjeshtruenë revelatën e parë aqë mirë sa edhe revelatën e Profetit të shenjtë.

12. Nji llojë pezmatimi e kap popullin kur shfaqet midis tyne ndonji profet.

nesh nji mundim i dhimbshëm.
19. Ata u përgjigjën: Fati i keq i juej asht me ju: çka! Pse ju u përmendët![13]. Përkundrazi, ju jeni nji popull teprues.
20. Dhe erdhi nga pjesa e largët e qytetit nji burrë tue fugue; [14] ai tha: O popull i em! Pasioni të dërguemët:
21. Pasoni atë qi nuk ju kërkon shpërblim, dhe ata janë të drejtuemët në udhë të drejtë:
22. Dhe ç'arësye kam unë që të mos i besoj Atij që më solli në eksistencë dhe te Ay ju kini me u këthye(përsëri):
23. Ç'ka! A të përvetësoj veç Atij hyjnina (tjera), shefaati (intercession) i të cilëvet, po të dëshironte Zoti Bamirës me më damtue, jo vetëm që nuk kishte me pasë ma vleftë për kurrgja, por edhe as që do t'ishin të aftë për me më shpëtue?
24. Në atë rast unë kam me qenë me plot siguri në nji gabim të qartë:
25. Unë sigurisht besoj në Zotin t'uej, atëherë ndigjoméni.
26. I qe thanun Hyj në parajsë.[15]. ai tha: ah sikur të kishin pasë dijtë populli i em.
27. Atë për shkak të së cilës Zoti i em më fali dhe më bani prej të nderueshmëvet!.
28. Dhe Na nuk zbritëm mbi popullin e tij mbas tij ushtarë prej qiellit, as që zbritëm ndonji herë.[16]
29. Nuk ishte tjetër veçse nji britmë e vetme, dhe që! Ata ishin fikun.[17]

---

13. Popullit i tregohet se pezmatimi nuk i kushtohet ardhjes së profetëvet, por rezulton përkundrazi prej vepravet të tyne të këqija.
14. Ky njeri, në shembull, përfaqëson besimtarin. Çdo profet ka nji njeri qi dëshmon vërtetësin e tij. ky njeri asht nji prej popullit të vet. P.Sh Josef i Armathaea besoi dhe ndihmoi H. Isanë ashtu sikundër Ebi Beqiri besoi dhe ndihmoi që në fillim H. Muhammedin.
15. Asht nji premtim qi i bahet besimtarit që ky ka me gëzue bekim dhe ka me dalë me sukses.
16. Këtu zhduket nji keqkuptim përsa i përket ardhjes së dënimit. Nuk janë zbritun ushtarë prej së nalti për me mundue të liqtë, por shkaqe janë provokue mbi tokë për kët qëllim.
17. Nji britmë e vetme tregon vetëm nji dënim befasije. Këtu asht dëni-

30. Mjerim për robët! Sa herë që vjen te ata ndonji apostull, ata e tallin.
31. A nuk e shofin se sa gjenerata para tyne kemi renue Na, për shkak se nuk këthehen te ata?.[18]
32. Dhe të gjith ata (pa përjashtim) kanë me u sjellë sigurisht para Nesh.

## Pjesa e III-të
## Shenjat e Vërtetësis së Tij

33. Dhe nji shenjë për ta asht toka e vdekun: Na e njgallim atë dhe nxjerrim prej saj drithë kështu qi ata hajnë prej tij. [19]
34. Dhe Na bamë mbrenda saj kopshtinj hurmash dhe ardhish si edhe Na çelëm burime që të rrjedhin mbrendë tyne.
35. Që ata të munden me ngranë aty fryte, që duert e tyne nuk i kanë punue; a nuk kanë me qenë falenderues?.
36. Glorje qoftë për Atë i cili krijoi gjithë sendet çift (par), gjithçka pjell Toka dhe gjithçka asht në vetvehtjet e tyne si edhe gjithçka të cilën ata nuk e dinë.[20]
37. Nji shenjë për ta asht edhe nata; Na nxjerrim prej saj ditën, kurse ata mbeten në errësirë.[21]

mi me të cilin kundërshtarët e profitit qenë kërcënue.
18. Dmth shumë gjenerata qenë rënue para tyne, sepse ata nuk u këthyenë te apostujt për me shpëtue.
19. Të vuemit e tokës së vdekme në lëvizje krahasohet gjithënji me transformimin qi po sjellte Kur'ani i Shenjtë. Se sa e vdekun qe toka, veçanërisht Arabia, në kohën e ardhjes së Profetit, asht e pamundun me e përshkrue mbrendë kufijëvet të këtij komentimi të shkurtën. Në se në botën Fyzike shfaqet veprimi i ligjit Hyjnor që, mbas vdekjes restorohet jeta, pse të mos punojë po i njajti ligjë edhe në botën shpirtnore.
20. Ky verset i shenjtë vendos pa dyshim nji prencip shkencor të randësishëm që e tanë krijesa përbahet prej çiftesh. Arabët, në fakt nuk e njihnin kët ligj.
21. Nata e injorancës po kalonte tash ma. Sepse sin ë botën fyzike që nata ndjek ditën dhe anasjelltas ashtu edhe në botën shpirtnore drita ndiqet prej errësirës së injorancës dhe kjo e fundit i liron vendin dritës.

38. Gjithashtu edhe dielli vërtitet mbi nji bosht të caktuem për të; ay asht urdhëni i të Plotfuqishmit, të Plotdijshmit.[22]
39. Por edhe për Hanën, Na kemi urdhërue në favor të saj stazha deri sat ë këthehet përsëri si nji degë e vjetër dhe e thatë.[23]
40. Jo vetëm qi diellit si lejohet për me kapë Hanën, por edhe nata ska fuqi ta kalojë ditën; kështu të gjithë sendet lundrojnë mbi nga nji sferë.[24]
41. Dhe nji shenjë për ta asht edhe ajo që Na mbajmë pasardhësit e tyne në anijen e ngarkueme.
42. Dhe Na kemi krijue për ta diçka që i shembëllen asaj dhe që ata kanë me i hypë.
43. Dhe po të Na pëlqejë, Na i mbysim ata, atëherë as që ka me pasë për ta ndihmëtar e as që kanë me u shpëtue.[25]
44. Por Na i mëshirojmë dhe e bajmë këtë që të gëzojnë për nji kohë.
45. Dhe kur i u thohet atyne: Rujuni kundër çka ndodhet para jush (para duervet tueja) si edhe kundër çka eksis-

22. Kjo gjendje mund ti referohet orbitës së dukëshme të diellit ndër qiellna, të reprezentueme mbi Tokë prej ekliptikës që kufizohet me tropikat e kancerit dhe të kaprikornës. Ase mund ti referohet revolusionit të diellit në espasë. Ase kohës kur ky mund të pushojë me dhanë dritë.
23. Këto fjalë pikturojnë vetëm shembëllimin e dukjes së hanës, kur asht me dritë të errët e në trajtë harku, me nji degë hurme të vjetër dhe të thatë. Nji gja e tillë mund të aplikohet edhe në rastin e së Vërtetës e cila me gjithse në fillim duket si e pakuptimshme, shpejt ndriçon si nji hanë e plotë.
24. Si e vërteta ashtu edhe e shtrembëta kanë ecjen e tyne. Sikundër që nata zhduket me agimin e ditës po kështu edhe e shtrembëta zhduket para dritës të së vërtetës. Lundrimi i trupavet qiellorë që gjithashtu nji gja që sja merrte mendja nji arabi këtu e 1300 e disa vjet përpara.
25. Kjo asht nji këshillë qi pengon dënimin. Të mbytunit në det sinjifikon nji rrenim qi mund të ndohij. Fjala e zgjedhun dhe e përdorun për me përshkrue dënimin asht e tillë që tregon mungesën e ndihmës për vuejtësit në atë rast. Sepse në asnji vend tjetër njeriu nuk asht aqë i pandihmë san ë det ku me gjith ndihmën qi shkenca i ka prokurue, ay asht aqë i pandihmë në titanic të sodit sa që edhe në barkat me vela të qëmotit.

ton mbrapa jush, për që jut ë mëshiroheni.[26]
46. Dhe sa herë që atyne tiu vijë ndonji komunikatë prej komunikatavet të Zotit të tyne, ata nuk e pranojnë.
47. Dhe kur atyne iu thohet shpenzoni nga çka ju ka dhanë Zoti: ata qi sbesojnë i thonë atyne qi besojnë: A kemi me e ushqye atë të cilin, pot ë donte Zoti, Ay mundeshte me e ushqye?. Ju sjini veçse në nji errësim(gabim) të qartë.[27]
48. Dhe ata thonë: Kur ka me u krye ky premtim, në se ju jinni të vërtetë?
49. Ata nuk presin veçse nji britmë të vetme e cila ka me i befasue(përfshi), ndërsa ata anmiqësohen ende me njani tjetrin.
50. Kështu që ata skanë me mundë me bamë ndonji vasijjet ashtu sikundër skanë me u kthye te familjarët e tyne.[28]

## Pjesa e IV-të
## Shpërblim dhe dënim

51. Dhe do ti fryhet fyellit, kur qe! Ata, të ngritun prej vorrevet të tyne, kanë me shpejtue për te Zoti i vet.[29]
52. Ata kanë me thanë: mjerim për ne! kush na ngriti prej vendit të fjetjes sonë? Kjo asht ajo çka premtoi Zoti Bamirës dhe për të cilën apostujt floën të drejtën.[30]

26. Çka ndodhet para jush sinjfikon dënimin qi mund të kapë njerëzit e këqinj në këtë jetë dhe çka eksiston mbrapa jush tregon pasojat e së keqes që ata e kanë me konstatue paskëndej, dmth në Jetën Tejtokësore.
27. Në këtë mënyrë, ata jo vetë, që nuk iu nënshtruenë Zotit, por nuk sympathizuenë as krijesat njerëzore të Tij.
28. Ky asht nji përshkrim profetizues i gëzimevet të Luftës së Bedrit.
29. Fryerja e fyellit qëndron për ditën e ringjalljes. Metafora që eksiston këtu merret prej fryerjes së fyellit për nji qëllim të madh mbledhjeje në ditën e ringjalljes ku të gjithë realitetet manifestohen.
30. Varri asht quejtun nji vend fjetjeje qoftë edhe për mohimtarët, sepse i krahasuem me dënimin e ashpër të Xhehenemit, varri asht për ta nji vend fjetjeje. Varri tregon rrethanën mbassi të ketë mbarue jeta në këtë botë.

53. Nuk kishte me qenë veçse nji britmë e vetme, kur qe! Ata që të gjithë kanë me u sjellë para Nesh.
54. Kështu që në këtë ditë asnji shpirt nuk ka me u përdorë aspak me padrejtësi; dhe ju nuk kini me u shpërblye veçse me atë qi kini bamë.
55. Sigurisht banorët e parajsit kanë me qenë në nji okupim krejt të gëzueshëm.
56. Ata dhe gratë e tyne kanë me qëndrue nën hije, të mbështetun mbi kanapera të nalta.
57. Ata kanë me pasë në atë vend fryte sikundër kanë me pasë edhe çka të dëshirojnë.
58. Paqe: nji fjalë prej nji Zoti të Plotmëshirshëm.[31]
59. Dhe dallohuni sod, o kriminelë!.
60. Unë a nuk u ngarkova ju, O të bijt e Ademit! Që të mos adhuronit djallin? Ai asht sigurisht anmik I juej I hapët.[32]
61. Dhe që ju të adhuronit Mue; kjo asht rruga e drejtë.
62. Dhe me të vërtetë ai terrësoi popuj të Shumët prej jush. Qe! A nuk mundeshit pra me e kuptue?
63. Kjo asht Skëterra për të cilën ju qe premtue.
64. Hyni mbrendë saj në këtë ditë për shkak se ju mohuetë.
65. Në atë ditë Na kemi me vulosë gojët e tyne, dhe duert e tyne kanë me Na folë, dhe kambët e tyne kanë me dëshmue për atë që kanë fitue.
66. Dhe pot ë jetë se Na dëshirojmë, Na kishim me ua nxjerrë sigurisht syt e tyne, atëherë kishin me u përpjekë tue konkurue kush të kalojë i pari udhën, por si do të shifnin?.[33]

31. Këtu kemi nji pikturë të Parajsit Mysliman. Mbas përshkrimit të bekimevet të ndryshëm, i përmblodh ata në nji fjalë: paqe.
32. Ky dhe të dy versetet qi vijojnë vëndosin(se Zoti ka grishun njerëzit gjithmonë në të Vërtetën, ndërsa djalli i ka udhëhequn ata në të keqen.
33. Asht nji dënim për mos pranimin e tyne. Ata i mbyllin syt e tyne kundrejt së Vërtetës në mënyrë që ata tiu verbohen. Ata nuk shohin ma edhe po të duen të shofin.

67. Dhe Na pot ë dëshironim, Na kishim me i shlye sigurisht ata mu në vend të tyne, atëherë ata nuk kishin me qenë të aftë me ecë as që do të këtheheshin.[34]

## Pjesa e V-të
## Mbretnimi i Islamit

68. Dhe këdo që ne e shkaktojmë me jetue gjatë, Na e reduktojmë(atë) në nji gjendje të ulët në konstitusion; a nuk kuptojnë pra?.[35]
69. Dhe Na nuk i kemi mësue atij poezi, as që asht ajo e përshtatëshme për të[36]; ajo (që i kemi mësue) nuk asht tjetër gja veçse nji përmendje dhe nji Kuran i qartë.
70. Që ay të mundet me këshillue atë që ka me pasë jetë, dhe që fjala të provohet e vërtetë kundër mohimtarëvet.
71. A nuk e shohin se Na kemi krijue bagëti për ta (ato janë) nga ato që kanë punuem duert tona, kështu që ata janë zotënonjësit e tyne.
72. Dhe Na ua kemi nënshtrue, kështu që disa prej sish i kanë për me iu hypë, ndërsa disa prej sish i hajnë.
73. Dhe, në favor të tyne, ndër to eksistojnë dobina dhe pimje; ata a nuk kanë me qenë pra falenderues?
74. Dhe kanë përvetësue zotna përveç Zotit për me mundë me u ndihmue.
75. (Por) ata nuk kanë me qenë të aftë për me i asistue, dhe ata kanë me qenë nji ushtëri që do të sillen para tyne. [37]
76. Atëherë, le të most ë të pezmatojë ty fjala e tyne; sigurisht Na e dimë se çmëshefin dhe se çka shpallin.
77. A nuk e shef njeriu që Na e kemi krijue prej zhermës-

34. Meskh(shlymje) këtu tregon nji transformim.
35. Në natyrë eksiston nji ligjë që çdo send jetues deteriohet. Këtu mund të aplikohet si për individut ashtu edhe për popujt.
36. Negasioni këtu asht ba për me tregue seriozitetin e profecivet të Kur'anit të Shenjtë.
37. Dmth njani ka me u prezantue për dënim kundrejt tetrit. Ata që të dy palët nuk kanë me mujtë me i ndihmue njani tjetrit.

jetike të vogël?[38], atëherë që! Ai bahet nji anmik i hapet;
78. Dhe ai Na sjell Neve shembull [39] tue harrue krijimin e tij. Ai thotë: Kush ka me iu dhanë jetë eshtavet në nji kohë që ato janë thërmue?
79. Thuej: Ka me i u dhanë jetë atyne Ai i Cili i solli në eksistencë së parit, dhe Ai asht i Plotdijshëm për çdo krijesë.
80. Ai i Cili bamun për ju zjarrin që djeg prej drunit të gjelbër, kështu që me këtë ju e ndizni.[40]
81. A nuk ash tai, i Cili krijoi qiellnat dhe tokën, i aftë për me krijue shembullin e tyne? Po (pa dyshim)! Ai asht Krijuesi(i çdo gjaje, i Plotdishëmi.
82. Urdhëni i Tij, kur ai dëshiron ndonji send, asht vetëm me i thanë atij, Bahu dhe bahet.[41]
83. Pra, Lavdi qoftë për Atë në duert e të Cilit asht mbretnimi mbi të gjith sendet dhe të Ai ju kini me u këthye.

38. Nutfeh tregon origjinalisht ujë të kthejellët. Nutfe-a prej së cilës asht krijue njeriu asht zherma e vogël e jetës ase spermatozoidi.
39. Të sjellunit shembull tregon me i vu shoq Zotit.
40. Druja që prodhon zjarrin e përvijon vetvehten te drutë e gjelbërta. Ase mund ti referohet fenomenit të drunjevet rezinozë që kapin zjarrm me fërkimin e degëvet të veta që i tund era.
41. Disa besojnë në eksistencën e maparëshme të landës dhe të shpirtit dhe në atributet e tyne. Krijimi i Zotit, pretendojnë ata, mbështetet mbi këto. Por kjo refuzohet, sepse në qoftë se Zoti nuk mund ti bajë sendet pamvarësisht prej landës, Ai nuk do të mundeshte gjithashtu me ndigjue dhe me pa manvarësisht prej saj. Nji tjetër argument asht edhe se njeriu që ka nevojë për landë për me ba sendet, ai ka nevojë edhe për nji model. Por Zoti ska asnji nevojë të tillë. Nji kuptim i tretë asht edhe se verseti i ban shenjë revolusionit të Profetit të Shenjtë. Ky revolucion i dukej njerëzvet nji pamundësi, por Zoti e kish dekretue. Në fakt, revolucioni i prumë në Arabinë ishte aqë i habitshëm sa edhe ndryshimi i qiellnavet dhe i Tokës.

**Sherif Ahmeti**

# Sure "El Kehf"

Kaptina XVIII, e zbritur në Mekë pas sures "El Gashije", ka 110 ajete.

Kjo është një prej atyre pesë kaptinave të Kur'anit që fillojnë me "**El hamdu Lilahi…**", e që janë "Fatiha", "En'am", "Sebe", "Fatir" dhe kjo. Në këtë kaptinë përshkruhen tri tregime të bukura të Kur'anit, përmes të cilave fitohet përshtypje e madhe në fuqinë e pakufishme të Zotit Krijues. Në tregimin e parë flitet për "***As-habi Kehf***", për banuesit e shpellës të cilët flijuan jetën për hir të besimit të drejtë. Ata ishin disa djelmosha të rinj besimtarë, të cilët u larguan prej vendlindjes së vet me qëllim që ta ruanin besimin dhe u strehuan në një shpellë, ku ndejtën treqind e nëntë vjet, e pastaj Allahu i zgjoi prej atij gjumi aq të gjatë. Tregimi i dytë përshkruan takimin e Musait me atë njeriun e ditur, si duket, me Hidrin (Hizrin) dhe ngjarjet, të cilat e habitin Musain, ngase nuk ishte në gjendje t'i kuptonte fshehtësitë e tyre, prandaj edhe kundërshtoi. Përmendet rasti i prishjes së një anijeje, i mbytjes së një djali të ri dhe i ndreqjes së një muri të shtrembëruar. Ai njeri i ditur i tregon Musait për fshehtësinë e atyre ngjarjeve, por ia tërheq vërejtjen se si nxënës duhet të tregojë respekt dhe bindje ndaj profesorit. Në tregimin e tretë përshkruhet tregimi i Dhulkarnejnit, i një sundimtari të drejtë e të devotshëm, të cilit Zoti i kishte dhënë pushtet të gjerë në lindje e perëndim dhe i cili e ndërtoi një pendë të madhe. Sikurse parashtrimi i këtyre tri tregimeve që ka qëllim të caktuar, ashtu edhe tre shembuj që përmen-

den në këtë kaptinë, vërtetojnë se nuk është e lidhur çdo e mirë për pasurinë, as për pushtetin, por për rrugën e drejtë e të vërtetë. Në shembullin e parë figuron ai pasaniku që kishte dy kopshte të mëdha e të begatshme e që ishte mashtruar pas tyre dhe kishte harruar Zotin dhe ai i varfri që ishte krenar për besimin e vet të drejtë. I bëhet një krahasim jetës së kësaj bote me të gjitha stolitë dhe bukuritë e saj, por jetë e shkurtër dhe e zhdukur dhe jetës së Botës Tjetër, me begati e të mira të papërshkruara, e edhe të përjetshme. Në shembullin e tretë i bëhet një vështrim dëmit dhe dëshpërimit të përjetshëm, i cili ishte rrjedhojë e mendjemadhësisë. Këtë pasojë Kur'ani e parashtron përmes ngjarjes kur shejtani refuzon urdhrin e Zotit dhe nuk deshi t'i përulej Ademit, e si masë kundër mendjemadhësisë së tij, ai e goditi me mallkim dhe përbuzje prej Zotit Mëshirues. Quhet: "**Suretul kehfi**" – (kaptina e shpellës) ngase është një rrëfim i çuditshëm në të cilin manifestohet një mrekulli e madhe e Zotit.

## *Komentimi*

Zoti lavdëron Veten e Madhëruar, që ia shpalli Kur'anin Muhamedit, Libër të saktë, të drejtë, e pa kurrfarë të metash e kundërthëniesh, që atyre që nuk besojnë, t'u tregojë për dënimin e rëndë të Zotit, që t'u tregojë edhe atyre që shpifin gënjeshtra Zotit, sikurse Ai ka fëmijë, se ajo është rrenë e trilluar pa kurrfarë argumenti. Për besimtarët që bëjnë vepra të mira, u është garantuar Xheneti, në të cilin do të jenë përgjithmonë. I tërhiqet vërejtja Muhamedit, jo për ndonjë gabim, por pse e hidhëron veten aq shumë pas kurejshitëve, pse nuk po e besojnë Kur'anin. Bukuritë e kësaj bote janë vetëm sprovë për njerëzit, secili prej tyre do të shfrytëzojë në mënyrë të njerëzishme, e cili do t'i kalojë kufijtë pas tyre, e dihet se

të gjitha këto stoli të tokës një ditë do të asgjësohen, e toka do të mbetet viran. Çështja e atyre të strehuarve në shpellë, ishte një nga mrekullitë e Zotit, po jo edhe më e rëndësishmja, sepse në faqet e kësaj bote ka mrekulli që ia kalojnë kësaj. "Kehf" i thuhet shpellës, e "Rekimë", ndoshta, ishte pllaka e gurit në të cilën ishin gdhendur emrat e atyre që u fshehën në shpellë. Ka mendime se kodra, ose lugina ku gjendej shpella, quhej Rekimë, ose fshati nga ishin djelmoshat quhej ashtu. Komentuesit e Kur'anit e përshkruajnë ngjarjen kështu: Njëfarë sunduesi, i quajtur Dekijanus, pas kohës së Isait, që sundonte në qytetin Tarsus (tash në territorin e Turqisë), detyronte njerëzit të adhuronin idhuj, statuja, e çdo njeri që e besonte Zotin një, ai e mbyste. Një grup djelmoshash të moshës shumë të re, vendosin t'i mbesin besnikë fesë së drejtë, prandaj bashkohen dhe ikin drejt maleve ku kishte shpella, e rrugës u bashkohet edhe një bari me qenin e vet, e shkojnë e hyjnë në atë shpellë. Në mëngjes, kur dëgjon sunduesi për ikjen e tyre, u vihet prapa me ushtri deri te hyrja e shpellës, por asnjë prej tyre nuk pati guxim të hynte në të. Prandaj vendosën t'ia mbyllin hyrjen me gurë të mëdhenj e t'i lënë të vdesin nga uria. Pas lutjes që i shprehin Zotit, ata i kap gjumi dhe qëndruan fjetur shumë vjet. Si duket, hyrja në shpellë ishte nga veriu, andaj nuk i kapte dielli, as në mëngjes e as në mbrëmje. Qeni kishte vënë kokën mbi dy këmbët e para të shtrira sikur rrinte gati për mbrojtje të menjëhershme. Për të mos u lënduar njëra anë e trupit të tyre, Zoti me fuqinë e Tij i rrotullonte sa në të djathtë e sa në të majtë. Kur u zgjuan nga gjumi, ishin të uritur dhe menduan se kishin fjetur tërë ditën ose pjesën më të madhe të saj. E dërguan njërin në qytet t'ju blinte ushqim, duke e porositur që të mos binte në sy e të zbulohej. Kur hyri në qytet, u habit, pse nuk ishte ai që kishte qenë dhe nuk njihte asnjë njeri. E bleu ushqimin e kur ia dha shitësit monedhat e argjendit, ai u habit dhe

i tha: Prej nga këto? Aty u grumbulluan njerëzit e po i shikonin të hollat dhe të habitur i thanë se mos kishte gjetur ndonjë thesar. Ai u betua në Zotin se nuk kishte gjetur, por ishin të hollat e tyre. Ata i thanë se ato të holla janë të kohës së sundimtarit Dekijanus. Atëherë, djaloshi pyeti: Ç'është puna e Dekijanusit? Iu përgjigjën se ai kishte vdekur shekuj më parë. Atëherë, u tregoi për rastin e tyre, e banorët e qytetit e lajmëruan sunduesin e qytetit, i cili ishte besimtar i mirë. Sunduesi, së bashku me ushtri e popull shkoi te shpella. Ata, në shpellë dëgjuan zhurmën dhe hingëllimën e kuajve e menduan se i kishte rrethuar Dekijanusi, prandaj u ngritën e po i luteshin Zotit. Sunduesi hyri brenda, i gjeti duke u lutur, e kur e kryen lutjen, ai i përqafoi që të gjithë dhe i njoftoi se ai besonte një Zot sikurse edhe ata, e se Dekijanusi ishte zhdukur. Dëgjoi fjalët dhe ngjarjen e tyre dhe e kuptoi se Allahu i zgjoi ata për të qenë çështja e tyre argument për njerëz. Pastaj i zuri gjumi dhe vdiqën, e njerëzit thanë: Do t'u ndërtojmë atyre një faltore aty. Ngjarja e *as-habi kehfit* është një argument i qartë dhe i prerë për mundësinë e ringjalljes dhe të tubimit para Zotit, ngase Ai që mund t'i zgjonte ata pas gjumit shumë të gjatë, ishte i plotfuqishëm t'i ringjallte njerëzit pas vdekjes së tyre, e pas Kiametit. Tash aty është e ndërtuar një xhami, mu në hyrje të shpellës. Në kohën e Pejgamberit tonë bëhej bisedë rreth numrit të tyre, por të gjitha ato biseda ishin të pabaza, prandaj i thuhet Pejgamberit që të mos polemizojë me ithtarët e Librit rreth numrit të tyre, është e mjaftueshme kjo që po të rrëfehet në Kur'an. Ibni Abazi thotë se ata ishin shtatë, ashtu kuptohet edhe nga Kur'ani. Për asnjë çështje që ke ndërmend ta kryesh në të ardhmen, mos thuaj: Do ta bëj, pa thënë: **In shaell-llah**, e nëse harron në atë moment, thuaje më vonë. Shkak i zbritjes së këtij ajeti ishte: Pejgamberi qenka pyetur për *as-habi kehfin*, e ai paska thënë: Nesër ju jap përgjigjen. Mirëpo, i qenka

ndërprerë shpallja pesëmbedhjetë ditë dhe qenka ngushtuar shumë Pejgamberi. Atëherë, i shpallet ky ajet dhe e mëson se si duhet thënë ai dhe besimtarët në raste të tilla. Paria kurejshite ishin tubuar te Pejgamberi dhe i kishin thënë: Largoji këta farë varfanjakësh prej teje, sepse neve po na vjen nënçmim të ulemi së bashku me ta (aludonin në Hababin, Bilalin, Suhajbin, Selmanin) e atëherë, do të vijmë ne paria e do të tubohemi pranë teje, e nëse ne e pranojmë fenë islame, do ta pranojnë të gjithë të tjerët, prandaj ose largoji ose caktona neve një vend, e atyre një vend tjetër. Pejgamberit i shkoi mendja të bënte diçka ashtu me shpresë se paria do ta pranonte fenë islame, por Zoti ia tërhoqi vërejtjen dhe i tha: "Lexo çka po të shpallet dhe përkufizohu me besimtarët e sinqertë, por tregoji për vendin e zullumqarëve në Xhehenem dhe për të besimtarëve bamirës në Xhenet." Edhe në kaptinën "*En'am*" është përmendur qëndrimi i parisë kurejshite, por këtu është thënë në mënyrë më të theksuar.

Shembulli i dy njerëzve: njëri pasanik, por jobesimtar, e tjetri besimtar më i varfër, ka të bëjë me parinë kurejshite, e cila krenohej me pasuri e pozitë dhe nënçmonte besimtarët e varfër. Ai që i kishte ato kopshte aq të mira, sipas përshkrimit që u bën Kur'ani, ishin fantastike, por pronari i tyre as nuk e besonte Zotin Fuqiplotë, as nuk falënderonte për ato begati dhe mburrej e krenohej ndaj atij fqinjit të vet që ishte më i dobët, si në pasuri, ashtu edhe në familje e farefis. Madje, ai mendonte se edhe nëse do të ekzistonte bota tjetër, ai do të jetë më i privilegjuar. Fqinji besimtar i tërhoqi vërejtjen, duke ia përkujtuar krijimin e tij në etapa të njëpasnjëshme, mandej e këshilloi që të falënderonte Zotin për ato të mira që i kishte më shumë se të tjerët. Më në fund, i tërhoqi vërejtjen se mund të ndodhte ndonjë fatkeqësi e të mbetej pa ato të mira. Dhe, vërtet, ngjau ashtu, një breshër i madh shkatërroi çdo gjë në kopshtet e tij, e kur e pa ai, prej së keqi, rrahi

shuplakë dhe e mjeroi veten pse u mashtrua, pse iu rrit mendja dhe nuk iu mbështet Zotit, e as nuk e falënderoi. Kështu, pra, çka dëshiron Zoti, ajo bëhet, pa ndihmën e Tij, nuk mund të arrihet sukses, prandaj, për çdo çështje duhet kërkuar ndihma e Tij. Jeta e dynjasë u përngjet bimëve, që pas shiut të mirë rriten shumë dhe marrin hov sa që ngatërrohen mes vete, por pas një kohe, thahen dhe bëhen byk që e shpërndajnë erërat. Me këtë kuptohet se jeta në këtë botë është e shkurtër, përsa i përket secilit njeri, edhe pse jeta e kësaj dynjaje është e gjatë, në krahasim me jetën e individëve. Është e vërtetë se malli dhe fëmijët janë stoli e kësaj bote, por kur krahasojmë me të mirat e botës tjetër që është e amshueshme, këto stoli janë pak send. Shpërblimi te Zoti është shumë i madh, ruana Zot, edhe ndëshkimi është shumë i rëndë. Kur të vijë koha e Kiametit, do të shkulen kodrat, do të lëvizin në ajër si retë e shiut, do të zhduket çdo bimë e dru dhe toka do të mbetet fushë e rrafshët. Bëhet ringjallja dhe njerëzit ekspozohen para Zotit, ashtu si kanë lindur në këtë botë dhe u paraqiten shënimet e veprave të bëra, pa munguar as vepra më e vogël, e mëkatarët, duke ditur punën e vet dëshpërohen pa masë dhe secilt do t'i ofrohet ajo që e ka merituar, pse aty mbizotëron drejtësia e Zotit. Përmendet rasti i kundërshtimit, i shejtanit ndaj urdhrit të Zotit, me qëllim që t'ju rikujtohet njerëzve se ai është armik i tyre, kështu që nuk duhet shkuar pas mësimeve të tij. Këtu, në këtë ajet, thuhet qartazi se shejtani, Iblisi, ishte nga radhët e xhindeve, e nuk kishte qenë ëngjëll. Rreth kësaj çështjeje janë dhënë mendime të shumta, sa që është e pamundur t'i parashtrojmë një nga një, prandaj po përfundojmë se Iblisi ishte xhind. Qëllimi i rrëfimit të shembujve dhe të ndodhive të tjera, të cilat po i parashtron Kur'ani, është për të mirën e njerëzve. Mirëpo, njeriu që nuk do të mendojë, që bëhet sikur nuk kupton dhe nuk dëgjon asgjë, përpiqet që këshillat e drejta e të vërteta, të

shpallura prej Zotit, t'i zhvlerësojë, e në vend të tyre, me anën e dialogut, t'i vlerësojë ato të vetat emocionale. Sikur të shkohej sipas asaj që njerëzit e këqinj e meritojnë, do të duhej të dënoheshin menjëherë, por Zoti Fuqiplotë, i cili është shumë Mëshirues, e në anën tjetër edhe nga ajo se Atij nuk mund t'i shpëtojë asgjë, Ai i lë të jetojnë deri në afatin e caktuar. Në këto ajete fillon parashtrimi i tregimit rreth Musait, nxënësit dhe bashkudhëtarit të tij, Jusha bin Nun dhe Hidrit – Hizrit. Musai ishte njoftuar për një njeri të mirë që ishte shumë i ditur dhe i dashur i Zotit, të cilin do të mund ta takonte aty ku bashkoheshin dy dete. Vendbashkimi i atyre dy deteve nuk është i theksuar qartë në Kur'an, andaj edhe janë dhënë komentime të ndryshme. Derisa Musai jetoi një kohë të gjatë në Egjipt, Deti i Kuq dhe Deti Mesdhe, vendbashkimi i tyre do të ishte ai vend për të cilin flet Kur'ani. Musai, bashkë me shokun e tij, morën rrugën për në atë vend. Kishin me vete si ushqim edhe një peshk të pjekur. Në një vend, pranë një shkëmbi pushuan, e derisa ishin pranë detit, peshku rrëshqiti prej zembilit dhe u fut në det. Uji i detit mbeti si i ngrirë dhe rruga e peshkut dukej si fole. Këtë ngjarje të çuditshme e pa bashkudhëtari, por harroi t'i tregonte Musait. Pasi udhëtuan gati një ditë prej atij vendi, Musai kërkoi të hante sillën dhe të pushonte. Atëherë, iu kujtua Jushait rasti i peshkut dhe i tregoi Musait. Musai tha të ktheheshin, se ai ishte vendi ku do të duhej ta takonin atë njeriun e mirë, të cilin e kërkonin dhe u kthyen rrugës nga kishin shkuar. U kthyen rrugës që kishin shkuar deri te vendi ku kishin humbur peshkun. E gjetën një njeri që ishte mbuluar me një petk e Musai dha selam. E ai i tha: Ka në këtë tokë ***selam***, kush je ti? -Unë,- tha, jam Musai i beni israilëve, erdha të më mësosh nga çka të ka mësuar Zoti, nëse më lejon të vij shok me ty. Ai i tha Musait: Ty të ka dhënë Zoti dituri ndaj punëve që i bëj unë, e mua më ka dhënë çka ti nuk di, andaj nuk do të

mund të jesh i durueshëm ndaj punëve që i bëj unë, ndonëse qëndrimi yt është i drejtë, derisa nuk je i njohur për fshehtësitë e çështjeve. Pasi që Musai shprehu gatishmërinë e tij për të qenë i durueshëm, ai e pranoi ta shoqëronte, por me kusht që të mos pyeste për asgjë, deri kur ai vetë t'i tregonte. U nisën të ecnin bregut të detit. Aty kaloi një anije dhe këta kërkuan të hipnin në të. Ata e njohën Hidrin dhe i hipën pa pagesë. Duke lundruar anija në det, Hidri me një sëpatë ia hoqi një dërrasë anijes, prej nga filloi të depërtojë uji, por pronarët e anijes, disi e mbyllën atë vend. Musai i harroi kushtet dhe i bëri vërejtje për këtë. Derisa u arsyetua me harresë, ai e lejoi që edhe më tej ta shoqëronte. Rrugës takuan disa fëmijë duke luajtur, e njërin prej tyre, Hidri e mbyti. Këtu Musai u revoltua, ngase ishte kundër parimeve të fesë, andaj i bëri vërejtje edhe më të ashpër, por e luti që edhe kësaj radhe të mos e largonte. Vajtën në një fshat, kërkuan ushqim, por ata nuk u dhanë. Duke kaluar, hasën në një mur të shtrembëruar dhe shihej se do të rrëzohej e do ta mbyste ndonjë. Hidri e drejtoi, e Musai i tha: Përse nuk u kërkove shpërblim për këtë të mire, derisa ata nuk na dhanë ushqim? Hidri i tregoi prapavijën e atyre punëve. Derisa një sundues rrëmbente anijet e afta për interesin e vet, anija e atyre të varfërve do të shpëtonte si me të meta, e ata do ta rregullonin shpejt dhe do të fitonin shumë në mungesë të anijeve të tjera. Djaloshi nuk do të bëhej i dobishëm, por i dëmshëm për prindërit që ishin shumë besimtarë të mirë. Vdekja e tij ishte në dobi të vetë djaloshit, ngase nuk kishte bërë ende mëkate dhe si i tillë është i shpëtuar, e prindërit do të kenë një djalë më të mirë e të dobishëm. Sikur të rrëzohej muri, thesari i jetimëve do të mbetej në duar të huaja dhe do të humbej, e për hir të babit të tyre që kishte qenë i mirë, duhej ta drejtoja atë, ashtu që kur të arrinin pjekurinë jetimët, ta nxirrnin vetë thesarin e tyre. Këto ishin fshehtësi për

Musain. Hidri nuk tha se i bëri këto punë nga mendja e tij, por me urdhrin e Zotit. Nga kjo duhet marrë përvojë dhe duhet kuptuar se çdo send ose punë që neve na duket e keqe, nuk është ashtu, pra edhe çdo e mirë, nuk është krejt e mirë. Çdo gjë i duhet mbështetur dijes së Zotit, Ai gjithnjë ia do të mirën besimtarit, andaj as nuk duhet dëshpëruar, as tepër gëzuar nga ngjarjet e ndodhitë, derisa nuk e dimë fundin e tyre. Këtë ngjarje e regjistron Buhariu dhe Muslimi, e Pejgamberi paska thënë: "*Allahu e mëshiroftë Musain, kisha pasur dëshirë të kishte qenë i durueshëm e Allahu të na tregonte edhe më shumë rreth udhëtimit të tyre.*" Me këtë, gjithashtu, duhet kuptuar se përveç pejgamberëve, ka pasur edhe ka njerëz që Zoti u dhuron njohuri të veçanta. Ndonëse nuk janë cekur se kush ishin pyetësit për Dhulkarnejnin, sipas të gjitha gjasave, ata ishin jehuditë. Rreth personalitetit të Dhulkarnejnit janë dhënë mendime e interpretime të llojllojshme. Kur'ani nuk cek sqarim të thukët se kush ishte Dhulkarnejni, kur ishte dhe në ç'vende udhëtoi e veproi. Përmend sundimin e tij, drejtësinë në sundim, ndihmën që u ofroi njerëzve dhe devotshmërinë e besimin e tij të sinqertë. "Dhulkarnejn" nga arabishtja do të thotë *dybrirësh*. Përse quhet kështu, ka shumë mendime, e ndoshta më i pranueshmi prej tyre është, pse sundimi i tij arriti deri te briri i perëndimit dhe i lindjes, çka jep të kuptohet për një territor shumë të gjerë. Nuk është fjala për Lekën e Madh, siç mendoi dikush, pse ky ishte me besim politeist. Kur'ani përmend tri udhëtime të Dhulkarnejnit, një në perëndim, një në lindje, deri te një popull që pothuajse ishte i egër, nuk kishin shtëpi, nuk kishin petka në trup, pra jetonin në shpella dhe lakuriq. Ai bëri edhe një udhëtim në veri, diku në Azerbajxhan e Liqenin Kaspik. Populli i atij vendi i ankohet për krimet që bënin fisi Jexhuxh dhe ai Mexhuxh, e që ishin të përçudët edhe në fizionominë e tyre si tepër të gjatë ose tepër të shkurtër.

Dhulkarnejni u ndihmoi kundër tyre duke ndërtuar një pendë të fortë, të cilën nuk do të mund ta kalonin deri kur të vinte koha e Kiametit, e Zoti ta shkatërrojë atë pendë. Jexhuxh dhe Mexhuxh përmenden edhe në kaptinën "Enbija", e ka disa hadithe që flasin rreth tyre, si nga shenjat paralajmëruese për afrimin e kijametit. Allahu e di më së miri!

Surit i fryhet njëherë kur është koha e shkatërrimit të kësaj bote, e herën tjetër për ringjallje dhe për tubimin e të gjithë njerëzve para Zotit. Xhehenemi u vërsulet para se të hyjnë në të, atyre që mbyllën sytë e zemrës dhe të mendjes e nuk deshën ta pranonin rrugën e Zotit, atyre që pos Zotit, adhuruan engjëj a ndonjë tjetër. Derisa nuk besuan Zotin e vërtetë, çdo veprim i tyre është i dështuar. Besimtarët bamirës do të gëzojnë kënaqësi në Xhenetet e Firdeusit. Pejgamberi ka thënë: "*Kur të kërkoni prej Zotit, kërkoni Firdeusin, pse ai është mes i Xheneteve, më i larti i Xheneteve dhe mbi të është Arshi i Allahut dhe prej Tij burojnë lumenjtë e Xheneteve.*" (Sahihajnë). Fjalët e Zotit, hollësitë e domethënieve të Kur'anit janë të pasosura. Kur'ani ka cekur qeniet, sendet, ngjarjet ashtu në tërësi, e po t'u hyhet këtyre në hollësi, atëherë as uji i këtyre deteve, edhe kaq ujë tjetër të ishte ngjyrë për shkrim, nuk do të mjaftonte të shkruheshin fjalët e Allahut. Në fund të kësaj kaptine është ajo porosi e madhe e të madhit Zot, kur thuhet: ***"Kush beson se do të ringjallet, do të takohet me Zotin e vet, e këta janë besimtarët, le të bëjnë vepra të mira sa të munden, e edhe le të ruhen, veprat t'i bëjnë për hir të Zotit, e jo për hir të ndokujt tjetër, pse atëherë ato shkojnë huq."***

**Hafiz Sabri Koçi**

# Hytbe me rastin e festes së Bajramit të Madh

Vllezën e motra, lavdi të madhit Zot që na bëri të mudur t'ia mbërrinim kësaj dite, kësaj sofre të madhe bujare të Allahut, ditës së Bajramit të Madh. Kjo është një ditë shumë e dashun tek Allahut, shumë e mëshirshme dhe e dhimbshme tek Allahut. Allahu me Madhëninë e vet i ka ndriçuar zemrat, mendjet dhe gjendjen morale dhe shpirtërore. Me anën e kësaj dite të madhe, në të cilën jemi grumbulluar në këtë faltore është një lumturi e madhe për ne që arritëm edhe një herë të prezantoheshim në këtë faltore, që quhemi mysafir të Allahut. "Allahu ka thënë që në sipërfaqen e dheut, shtëpiat e mia janë faltoret, aty ku vehet gjëja më e ndritun në sexhde, fytyra e njeriut, pra kjo është një lavdi, një mirësi e madhe prej Allahut, që duhet të jemi krenar, të gëzum e të lumtur. Sot na mbuloftë Rahmeti i Allahut, na mbuloftë mëshira e dhembshunia e dashuria e Tij. Pra, për ne është një gëzim tepër i madh, sot jemi të falun e mëshirum Allahut me Madhninë e vet, të gjithë besimtarët e besimtaret i ka falur të gjithë, i thërret sot në festën bujare të rahmetit, mëshirës e dhembshurisë së Tij. Kjo ditë sot është ditë e çmueshme për të gjithë neve dhe duhet që të kujdesemi për veten tonë të pastër, të lumtur, të ruajmë e të kemi kujdes që të dalim të pastër dhe të rrimë besnikë kësaj pastërtie dhe monizmi që është Allahu. Sot ne i përgjigjemi thirrjes së Zotit "O Zot i madh, Ti je Krijuesi jonë, Ti na ndriçove me të hongër e të pime në të urumin Rama-

zan, e bone dritë për të gjithë besimtarë e besimtare, më ndihmove në këtë mes për të mposhtur armikun më të madh e krijuar, që është epshi. Epshet në përgjithësi te njeriu, është vetë djalli që mundohet të na prishë ne me Allahun, por nuk ka gjë që na prish me Allahu, sepse Allahu është Krijuesi jonë. Ai është i Dashuni jonë dhe e ka derdh krejt mirësinë në fytyrat njerëzore. Dhembshunia dhe dashunia ka agu në fytyrat e krejt besimtarëve, pavarsisht se djalli ka pas fuqinë e vet me i tradhëtu se i hudh në greminë, por prapë Allahu nuk i le mas pastërtisë e rahmetit të vet, por i thërret tek rahmeti i Tij, mëshira e Tij, tek mburoja e Tij. Njeriu është botë e madhe se e ka nderu nga të gjitha krijesat e tjera. Kur është krijuar njeriu i parë, Ademi, janë habit të gjithë melekët kur e kanë pa formën e bukur të tij dhe thanë se nuk ka gjë më të bukur që i ngjet fytyrës së Hazreti Israfilit, një prej melekëve që është më i bukuri dhe më i preferumi prej të githë melekëve të tjerë, prandaj njeriut i dha këtë formë të bukur që s'e ka kërrkush, njeriun e ndriçoi e bani që s'ka si bahet. Por, iu thotë atyne njerëzve, të cilët janë gënjy e mashtru nga djalli: “O njeri, kush është ai që juve ju prish me Mu, kush është ai që ju largon prej Meje, kush është ai që ju mashtron juve. A po përfitut nga bujaria e Allahut e duhet jashtë dore. Allahu është Ai që ju krijoj juve, në mënyrë të drejtë, të hijshme, të bukur. Me të gjithë gjymturët në vend, të gjitha organet në vend, por ju bani që të keni pjesë nga cilësitë e veset e hajvanit dhe ato të njeriut të vërtetë.” Njeriut të plotësuar, plotësohet atëherë kur gjithmonë nuk i humb lidhjet me Zotin po i mban gjithnjë, prandaj atëherë melekët thonë: “O Allah, masi Ti i krijove njerëzit me lesh, me hongër e me pi, me të mathme e të veshme, me fejesë e martesë, atëherë na le për Ahiret, na le për Ahiret dhe ata leri për dynja.” I tha: “S'kam si me i lanë për dynja vetëm ata, se ata janë punë e mjeshtres Teme. Unë e kam ndërtuar trupin Vetë, kam

zgjedh atë formë Vetë. Unë i kam dhënë shpirt nga gjallënia Jeme. I kam dhënë nga gjallënia Jeme, prandaj s'ka si të jetë." Ai është për dynja e për ahiret, është ai që do të arrij të jetë në Xhenet e të gjithë uniformat e tyne nuk i ndahen Resulullahut. Por, të gjithë me besim të plotë i gëzohen të mirave që na ka përgatit Allahu. Prandaj më e mramja krijesë është kjo krijesë, njeriu, prandaj për njeriun janë bajramet, ramazanet, është kultura e dituria. I thotë Profetit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!): "Të kam eduku Vetë, të kam mësu Vetë, të kam dhënë atë që s'e ke dit." "Kurrëkush s'mund ta marrë dijen ne atë çka i ka dhënë Zoti. Prandaj, çdo ditë Allahu na mëson, na edukon, na madhëron e na mron ma afër madhnisë së Tij. Pejgamberi ynë (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: "Gjithë njerëzia janë si familje e Zotit." "O njeri, juve ju kam kriju për Mu, Unë jam për gjithçka kam kriju vetëm për ju." Prandaj, dielli po ndrit për ne, hëna po ndrit për ne, planeti i gjithë është vetëm për ne, toka riprodhon për ne, ujrat janë për ne. Prandaj, kjo ditë i thërret njerëzit të jenë pranë Zotit, asnjë mos të largohet. Ato dije që kena fitu të mira, i dimë të gjithë, por duhet me i vënë në jetë, duhet të dimë që nuk është prej kujt, por prej Allahut. "A nuk e din që një ditë do të dalësh prej kësaj bote dhe do t'i nënshtrohesh ligjit të drejtësisë së Allahut. Allahut na ka urdhnu në punë të drejtë, pasi është Vetë i Drejtë, që nesër në gjygjin e përgjithshëm, Ai ka me dhënë secilit atë çka meriton." "Në qoftë se ju do të keni mirësinë të silleni mirë, të jetoni mirë, të rrini mirë e sidomos me njëri-tjetrin e të keni turp prej Allahut, Allahu është ai që do t'iu shpërblejë juve." Sahabët dëgjuan Profetin (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) që porosiste: "Kini turp prej Zotit" – Ne turp kemi *ja resulullah*, ne e respektojmë, respektojmë marrën e turpin. "A nuk e din që Zoti ju sheh në të gjithë manovrimet tuaja. Prandaj, dijen dhe kulturën që

keni marrë, pse e lini jashtë   norms? - përgjigjet Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) – "Nuk quhet turp kshu si thoni, thuhet për atë kokë që keni mbi qafë, atë kokë që keni mbi qafë, që ka gjithë atë përbërje. Syri ka veprimin e vet, hunda ka veprimin e vet, goja ka veprimin e vet, veshët kanë veprimin e vet, truri ka veprimin e vet. Atë ruaje e mos e vë kundër shkeljes së Zotit. Prandaj, ruaje fort synin, gojën, gjuhën sidomos, gjuhën që merret me mbartje fjalësh nga njëra në tjetrën. Ajo që fut ngatarresa mes njerëzve. Ajo që shpif dhe i bie në qafë të tjerëve, ajo do të jetë armiku kryesor i njeriut." Pejgamberi (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) thotë: "Armiku i njeriut është gjuha, po ashtu, syni e veshi, po ashtu, menja dhe menja si me thonë është ajo që duhet të jetë mbi të gjitha." Lum ai që nuk merret me të tjerët, po merret me hallet e veta." Pra, vëllezun të dashun, duhet që të merremi me veten tonë. Ta marrim në dorëzim veten tonë, të marrim me ngarku vetet tona në ç'ka keq ky dhe mos të dalim asnjëherë jashtë orbitës, jashtë kufijve që na ka vu Allahu. Duhet që gjithmonë ne të luftojmë me veten tonë. "Luftar i vërtetë është ai që lufton epshet e tija dhe asnjëherë nuk ka guzim kur të vijë dita e funit e të japim at shpirt, at shpirt që na ka dhënë Allahu, vetë atë shpirt që Ai e manovron dhe kërkon pastërti prej nesh. Ai shpirt që kërkon pastërti prej nesh: "Ka shpëtu ai, robi që e man të pastër shpirtin e vet, zemrën e vet, man të pastër trupin e vet e asnjëherë nuk i shkon kundër. Prandaj, sot është kjo ditë e madhe për të gjithë ata njerëz që do sillen të mbledhin mendjen e pranohen me atë bukuri që iu ka dhënë Allahu, me ato mend që iu ka dhënë Allahu, me atë të hongër e të pimë, që iu ka dhënë Allahu, që rritet bagëtia, gjithçkaja rritet për ta largu njeriu, gjithçka për ta vesh e mbath njeriu, prandaj, duhet të menojmë se nuk është rrugë e drejtë të dalim lakuriq, femrat të kenë kujdes vet, se për atë trup që ka

marrë në ngarkim prej Allahu, do të japë llogari. Ai thotë se tre ka me i rasë robi vetes së vet. Ka me i rasë turpin, ka me i rasë punën dhe trupin. Pejgambeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: "Musliman quhet ai që ruhet të mos trazojë, që të mos bëjë keq me gjuhë e me dorë." Prandaj, ne jemi një familje në përgjithësi sidomos këtu në vendin tonë, kemi për detyrë t'i këshillojmë të rinjt e të rejat që të mos largohen nga rruga e Zotit. T'i këshillojmë ata njerëz që merren me vese të këqija që të bien nga rruga e vërtetë. Detyra e të gjithë neve sot dhe mesazhi i kësaj ditë është të porosisim të gjithë besimtarët të ruajnë veten e vet. Të mos dalin jashtë normave në folje, mendim, pamje, në të gjitha të mendohet të ruhet prej zullumit. Mos i bëj zullum kujt, mos i bëj dëm kujt. Më mirë të jesh i dëmtuar, se sa dëmtues. Prandaj Allahu i kërkon njerëzve të jetojnë në paqe njoni me tjetrin, si një familje. Kjo tokë qe e begatë, me pejgamberanë, me intelektualë, me dije që ata janë ajka e njerëzimit dhe që soj njerzie nuk pati rilindje. Prandaj, Allahu nuk i don ata që shpifin, ngatarrojnë, bëjnë fjalë poshtë e përpjetë dhe nxjerrin njerëz nga rruga. Prandaj ne duhet të dimë edhe një gjë si jeton islamizma. Se si jetojnë myslimanët me të gjithë njerëzit. Duhet të dimë se Allahu na ka marrë neve me gjithë krijesat e Tij, domethënë njeriun. Pra, ca është njeriu, është më i nerum në mënyrë të veçantë, pra Zoti na neron, pse duhet t'i kundërvihemi të bëhemi prej punojësve. Pra, meqënëse ne jemi prej një gjine me çdo njeri duhet që ta ndihmojmë, nerojmë, respektojmë sa kena mundësi, të sillemi mirë, të ruhemi të mos bëjmë dëm e tjera me rradhë. Perjgamberi (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) thotë: "Më e rendësishmja e kësaj familjeje që të gjithë njërëzit pa dallim feje, veç si origjinë jemi të detyrum me respektu çdo njeri, ka fe, s'ka fe, është njeri e duhet me e respektu dhe neru, e ke prej një babe e prej një nëne. "Se

ke ardh prej një nënë e babe, duhet me rujt kujdesin më të madh me pa me e marrë me të mira, nësë është komshi, është fe tjetër, apo s'ka fe fare, duhet ta nderosh, nëse vuan për të hongër, duhet ta nimosh, nëse nuk ka veshje, me e nimu, në qoftë se e ke takatin tënd. Gjithashtu, me i shku për festë që ka, për urimin që ka, i ka lind djali, a ka martu vajzën, a ka martu djalin. Të gjitha këto norma janë se është njeri mbi të gjitha, mund të hedhësh në luftë nëse ai do me nxjerrë nga vatani, në qoftë së ai nuk të len me kry ritet e tua besimtare, bëhet pengesë, atëherë përgatit forcën dhe kundërviju se ai ka dalë jashtë norme, jashtë binarëve. Çdo gjë dëmtuese e ka të ndalume me hy në shpi të njeriut, prandaj nuk duhet që neve të kemi dallim, prandaj neroje, respektoje çdo njeri, qoftë për kombësi. Arsyeja është se janë të një origjine, arsyeja e dytë është se kanë edhe kombësi, arsyeja e tretë është dhe ai dhe ti ke atë fe, pra, janë shumë arsye që nuk na ndajnë nga njoni prej tjetrit. Ne duhet t'i shkulim konfliktet mrena familjes, të dalim e të shkojmë e ta vejmë buzën në fyryrën e nanës e të babës e t'i thomi: Qofsh e nerume, Zoti të marrtë në mëshirë në të dy jetët, se ti je sebep që unë kam ardh në këtë botë. T'i hekim dhimbje e të mos e bajmë me dhimbje. Të respektojmë paqe mes njëri-tjetrit. Të respektojmë falje e amnisti të përgjithshme. T'i hekim inatet e huja për me rujt vatanin, për me rujt nerin, karakterin. "Pjesa e imanit bën edhe me rujtjen e vatanit, vendin tënd ku jeton. Prandaj, ne duhet që të falim të metat. U falim çdo gjë në kanë bo, t'i falim, hallall i qoftë, Zoti e faltë atë e neve. Kjo është ajo punë që me dalë faqebardhë para Allahut, vëllezën e motra, sot në këtë ditë jemi të pastër sikur kena lind prej nane, por duhet të rujmë veten tone, për më tepër, të ruajmë zemrën tonë, mos majmë huje, mos hakmerremi, por t'i falemi, si Pejgamberi (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!). "Gjithmonë, falja, O Muhamed, këshilloi në rrugën e drejtë me durim

e tërhiqi nga injorantët." Prandaj, i ka neru të gjithë besimtarët, intelektualët edhe njëherë më mirë se masa, ekzistenca hyjnore, veprimi dhe sjellja e kultura e Allahut dhe Ndershmëria e Tij. Prandaj, është detrë e të gjithë neve që të kemi pajtim. Kjo ditë e madhënishme u thërret në pajtim, mes njoni-tjetrit, t'i shujmë flakët, zhdukim këto mosmarrëveshje, këto krime. Allahu urdhëron të largohemi prej tij se nuk i donte të gjithë. E gëzofshim këtë ditë e rufshim këtë rahmet të Zotit, Allahut. Urime e bekime gjithë besimtarët islam ku do që janë! Allahu na bashkoftë si një trup i vetëm e të jemi menjëherë faqebardhë e të ruajmë këtë se nuk jemi të garantum a mbërrijmë vitin e ardhshëm, a nuk mbërrijmë. Allahu është Falës, patjetër që Allahu është Falës. Nuk fal vetëm atë që nuk heq dorë nga shirki, atë që i vejnë shok Allahu, ata që zëvendësojnë Allahun. S'ka të Dashun tjetër, përveç Allahut. Më i Mirë, më i Meritumi. Ai që meriton respektin është Allahu Vetë, prandaj ne nuk kemi dyshim. E dimë krejtësisht lëvizjen dhe qarkullimin e Tij, pranaj Allahu na mëshiroftë e mos na ndaftë prej Xhenetit.

**H. Hivzi Shehu**[1]

# Emrat e bukur të Allahut[2]

**Në Kur'an thuhet: "Allahut i përkasin emrat më të bukur, prandaj, thirreni Atë** (lutjuni Atij) **me ta..." (Sure "A'raf", ajeti 180)**
**Kurse Profeti Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:** ***"Allahu ka 99 emra. Kush i këndon e i kupton, hyn në Xhenet."***

Huue – Ai Xhel-le Xhelalihi (që qoftë i Madhëruar)
Err – Rrahman[3] i Gjithëmëshirshmi
Err- Rrahim Mëshirëploti
El Meliku Sunduesi
El Kud Dusu i Shenjti; i Pastri
Es Selamu Paqedhënësi
El Mueminu Siguruesi
El Muhejminu Mbizotëruesi
El Azizu Fuqiploti
El Xheb-baru i Gjithëfuqishmi
El Mute Kebiru i Madhërishmi
El Khaliku Krijuesi i gjithçkaje

1. Mësues dhe inspektor në seksionin e arsimit në rrethin e Dibrës për më shumë se 30 vjet. Lindi në fshatin Vleshë të rrethit të Dibrës. Ka mbaruar Medresenë e Lartë të Tiranës me rezultate shumë të mira. Ka qenë njohës shumë i mirë i gjuhës arabe, perse dhe angleze. Gjatë gjithë jetës së tij nuk i ka ndërprerë asnjëherë adhurimet (ibadetet), madje, edhe në kohën kur feja ishte e ndaluar me ligj. Ka shumë shkrime dhe përkthime dorëshkrim.
2. 1918-2005
3. Emrat e Allahut janë tejshkruar në gjuhën shqipe.

El Bariu Filluesi i çdo krijese
El Musau – uiru Formëdhënësi
El Gaffaru Falësi i Madh
El Kah – haru Mposhtësi i gjithçkaje
El Ueh – habi Dhuruesi Absolut
Err Rrez – zaku Furnizuesi i pamasë
El Fet – tahu Zgjidhjedhënësi
El Alimu i Gjithëdituri
El Kabidhu Shtrënguesi
El Basitu Dhënësi
El Khâfidu Përulësi
Err Rrafiu Lartësuesi i besimtarëve
El Muiz – zu Lurtësuesi i të udhëzuarve
El Mudhil – lu Nënshtruesi i të lojturve
Es Semiu Dëgjuesi
El Besiru Gjithëvështruesi
El Hakemu Gjykuesi
El Adlu i Drejti
El Latifu i Buti
El Habiru i Gjithinformuari
El Halimu Përdëllimtari
El Adhimu Madhështori
El Gafuru Gjithëfalësi
Esh Shekuru i Falënderuari
El Aliu i Larti
El Kebiru i Madhi
El Hafijdhu Mbrojtësi, Ruajtësi
El Mukitu Ushqyesi i krijesave
El Hasibu Llogarimarrësi
El Xhelilu Fisniku
El Kerimu Bujari
Err Rrakibu Gjithëkontrolluesi
El Muxhibu Lutjepranuesi
El Uasiu Gjithëpërfshirësi
El Hakimu i Mençuri, i Urti

El Uedudu i Dashuri
El Mexhidu i Lavdishmi
El Baithu Ringjallësi
Esh Shehidu Dëshmuesi
El Hak – ku i Vërteti
El Uekilu Përkujdesësi
El Kauij – ju i Forti
El Metinu i Pathyeshmi, i Palëkundshmi
El Ueliu Kujdestari i besimtarëve
El Hamidu i Lavdëruari
El Muhsinu Mirëbërësi
El Mubdiu Nismëtari, Zanafillësi
El Muidu Rikrijuesi
El Muhji Jetëdhënësi
El Mumitu Jetëmarrësi
El Haj – ju i Gjalli
El Kaj – jumu Sunduesi
El Uaxhidu Krijuesi
El Mexhidu i Nderuari
El Uahidu i Vetmi, Një
Es Samedu i Domosdoshmi, Mbështetësi
El Kadiru i Plotfuqishmi
El Muktediru Bërësi i gjithçkaje
El Mukad – dimu Qenësi para krijesave
El Mueh – hiru Mbetësi pas krijesave
El Eu – uelu i Pari pa fillim
El Ahiru i Fundit pa mbarim
Edh Dhahiru i Dukshmi
El Batinu i Padukshmi
El Uali Udhëheqësi
El Muteali i Gjithëlartësuari
El Berr – rru Mirëbërësi
Et Teu – uabu Pendimpranuesi
El Muntekimu Ndëshkuesi i padrejtësive
El Afau – uu Mëkatfalësi

Err Rreufu i Dhembshuri
Err Rrab – bu  Sunduesi; Krijuesi
El Muksitu Drejtësidhënësi
El Xhamiu Tubuesi i krijesave
El Ganiu i Vetëmjaftueshmi
El Mugni i Pasuridhënësi
El Maniu Ndaluesi
Ed Darr – rru Krijuesi i së keqes
En Nafiu Krijuesi i së mirës
En Nuru Drita
El Hadi Udhëzuesi
El Bediu Krijuesi nga asgjëja
El Baaki i Përhershmi
El Uarithu Trashëguesi
Err Rreshidu Frymëzuesi
Es Saburu Durimtari më i Madh
Malikul Mulk Pushtetmbajtësi Absolut
Dhul Xhelali uel Ikram  Atij i takon madhështia e nderi

**Haxhi Selim STAFA**

# Libri i Allahut
# Kur'àni Kerijmi

«**Bismil'làhirr'rrahmàni-rr'rrahijm**»; patjetër, të gjitha punët e nderuara kemi detyrë t'i fillojmë me emrin e Allahut, të Gjithmëshirshmit, Mëshirëplotit, ashtu siç fillon vetë Libri i Allahut, Kur'àni kerijmi, i cili qysh në suren e tij të parë, suren "El-Fàtiha" na mëson si të lutemi dhe na urdhëron që menjëherë pas «**Bismil'làhirr'rrahmàni-rr'rrahijm**» të falenderojmë vetëm Allahun, Zotin e botëve duke thënë: **«elhamdu lil'làh»** - lavdrimi e falenderimi i takojnë vetëm Allahut -. Në vijim të kësaj sureje të nderuar, Kur'àni kerijmi urdhëron çdo mysliman e myslimane të deklarojë nga thellësia e zemrës **«ij'jàke naëbudu ue ij'jàke nesteijnu»** - vetëm Ty o Allah të adhuroj dhe vetëm Ty o Allah të kërkoj ndihmë dhe pastaj t'i luetet Allahut me përgjërim **«ihdina-s'siràtal-mustekijme»** - na udhëzo në rrugën e drejtë, **«siràta-l'ledhijne en'amte alejhim»** në rrugën e atyre mbi të cilët Ti o Allah ke derdhur mirësitë Tuaja të mëdha dhe menjë herë pas kësaj kërkese i lutet të Gjithmëshirshmit **«gajril-magdùbi alejhim»** - mos na ço në rrugën e atyre njerëzve, të cilët me punët e padenja që bënë, merituan zemërimin e Allahut, as në rrugën e atyre **«ue led'dàl'lijne»,** të cilët me vetëdashje shkuan në rrugën e humbjes..

Libri i Allahut, mrekullia më e madhe me të cilën Allahu dërgoi Profetin e Tij të fundit – paqa e shpëtimi i Allahut qoftë për atë e për familjen e tij - është dhe do të jetë për myslimanët burimi ku ata gjithmonë do të

flladisin zemrat e tyre besimtare; në Kur'àni kerijmin myslimanët gjejnë gjithshka që kanë nevojë të dinë për të sistemuar punët e kësaj bote dhe po në Kur'àni kerijmin myslimanët mësojnë edhe punët që i duhen çdo myslimani e çdo myslimaneje për të fituar kënaqësinë e Allahut të lartësuar dhe pastaj vetëm me mëshirën e Tij për të siguruar lumturinë e përhershme në botën tjetër.

Kushdo që e lexon Kur'àni kerijmin ashtu siç porosit Kur'àni, do me thënë kushdo që e lexon Kur'anin duke menduar mbi atë që lexon me qëllim që përvetësojë çdo mësim të Kur'ànit, patjetër që ka parë se Kur'àni kerijmi në rradhë të parë është libër që bën thirrje për të besuar se Allahu është Zoti Një e i Vetëm (teuhijd). Me këtë thirje Kur'àni i drejtohet të gjithë bijve të Ademit, pa dallim rrace, kombësie, shtrese shoqërore, niveli kulturor e pasuror e pozite; në të njejtën kohë myslimani dhe të gjithë njerëzit që e lexojnë me kujdes Kur'àni kerijmin, do të gjejnë se Kur'àni është shpjegues për të gjitha sendet, ashtu siç njofton i Larti në librin e Tij: **«tibjànem likul'li shej'in» «sqarues peër çdo send»** *(sure En'nahl", ajeti nr. 89),* do me thënë se Kur'àni përveç çeshtjeve që kanë të bëjnë me besimin në Krijuesin e të gjithë botëve, nuk ka lënë pa trajtuar në formë historie, këshille e argumenti edhe dukuri të natyrës e probleme nga më të ndryshme nga të gjitha fushat e dijes, duke filluar me çeshtje që kanë të bëjnë me shëndetin, përfshirë edhe llojet e mira të ushqimeve që duhet të marrë njeriu, tregon edhe ushqimet e ndaluara e të dëmshme që i dëmtojnë njeriut shëndetin e moralin; ose çeshtje që kanë të bëjnë me rregullat e higjenës personale e kolektive, udhëzime për mënyrën e kryerjes së adhurimeve,si dhe urdhëra e këshilla që kanë të bëjnë me përsosjen morale të njeriut, Kur'àni kerijmi trajton edhe çeshtje shoqërore e juridike, madje edhe çeshtje që kanë lidhje me punët praktike të njeriut në këtë botë, deri edhe mënyrën e rregullimit të marrëdhënie

pasurore në mes njërëzve, siç janë hartimi i kontratave të ndryshme, çeshtjet e trashëgimisë ei të dokumentacionit të gjendjes civile; gjithshtu Kur'àni trajton edhe çeshtje që janë objekt studimi i shkencave të ndryshme teorike dhe praktike. Për të gjitha këto myslimanët gjithmonë e kanë ndjerë nevojë të domosdoshme që t'i referohen vetëm Kur'ài kerijmit për të gjitha çeshtjet e problemet që duhet të zgjidhin, të vetëdijshëm dhe me besim të plotë se vetëm në Kur'àni kerijmin do të gjejnë përgjigjen më të drejtë dhe zgjidhjen e duhur, për problemet e tyre materiale e shoqërore, për probleme të mbrojtjes së komunitetit e të vendit, si dhe për të gjitha problemet që atyre I dalin gjatë jetës, si individ dhe si shoqëri. Në Kur'ànin famë lartë trajktohen edhe dukuritë e ndryshme që kanë të bëjnë me anën morale, ose me shpikjet e reja dh bazuar vetëm në Kur'àni kerijmin njeriu I ka të gjitha mundësitë të mësojë nëse këto dukuri e shpikje janë japin ose jo zgjidhje të drejta në dobi të njeriut dhe nëse janë ose nuk janë në përputhje me ligjin e Librit të Allahut.

Për të konkretiziar qoftë edhe kalimthi këto që u thanë më sipër, le të shikojmë në ajetin nr. 90 të sures "En'nahl" dhe është pikërisht ajeti të cilin hatibi e lexon në shkallët e minberit pasi përfundon predikimin e ditës së xhuma dhe thotë: **(in'ne-ll'llàhe jeëmuri bil-adli uel-ihsàni ue ijtài dhil-kurbà ue jenha anil-fahshài uelmunkeri uelbag'ji jeidhukum leal'lekum tedhek'kerùne) - «Allahu urdhëron drejtësi, bëmirësi e ndihmë për të afërmit dhe ndalon imoralitetin, çdo gjë të neveritshme dhe dhunën. Ai u këshillon që ju të merrni mësim».**

Askush nuk e ka të vështirë të mendojë mirësinë e madhe që vjen prej zbatimit të drejtësisë, nëse drejtësia do të zbatohet ashtu siç urdhëron Allahu i lartësuar në këtë ajet e në ajete të tjera të Librit të Tij, gjithkush e ka të lehtë të medojë jetën e lumtur në një shoqëri ku drejtësia zbatohet në përputhje me mësimet e Kur'ànit kerijmit,

gjithkush e din, veçanërisht në vendet ku është veprues ligji laik, se drejtësia në fjalëne Kur'àni kerijmit do të thotë që gjerat të vihen në vendin e duhur. Vetëkuptohet që në atë shoqëri ku gjen zbatim të plotë ky urdhër i Allahut edhe nëse do të ndodhë ndonjë padrejtësi, ajo menjëhrë do të largohet në përputhje me ligjin e Librit të Allahut dhe, ligji i librit të Allahut nuk bën as privilegje e as lëshime ndaj atyre që me dashje ose padashje e shkelin atë dhe, natyrisht nga zgjidhja e ligjit të Librit të Allahut askush nuk mbetet i pakënaqur, sepse atij që i takon e drejta e merr atë në bazë të ligjit dhe ai që dënohet, është i vetëdishëm se dënohet në përputhje me ligjin. Le të shohim edhe urdhërin e dytë të ajetit të lartpërmendur: Allahu urdhëron bëmirësi dhe bëmirësi në konceptin e Librit të Allahut do të thotë kur njeriu e bën punën e mirë sikur është para Allahut të lartësuar, Dikush mund të shtrojë pyetjen: përse kërkohet bëmëirsia kur shteti e ka detyrim të shikojë me përparësi shtresat në nevojë? Po, shteti e ka këtë detyrim, por a mundet ndihma e shtetit të arrijë te të gjithë nevojtarët ku ata jetojnë? Patjetër që kjo është e pamundur, qoftë edhe në gjendjet e zakonëshme, pa folur për gjendjet emergjente të ardhura nga faktorë të natyrës, ose të shkakatuar nga puna e pamendur dhe e papërgjegjëshme e vetë njeriut, prandaj Libri i Allahut urdhëron bëmirësinë kudo që është nevoja për bëmirësi dhe bëmirësi nuk do të thotë vetëm dhënie e ndihmës materiale, por edhe ndihmë morale, qoftë në formë këshille, qoftë me ndalimin e veprimit të gabuar, qoftë me ndërmjetësim për të pajtuar dy palë ose edhe dy vetë, aq më tepër kur ndihma morale është e pranishme në rastet kur palët që nuk arrijnë të meren vesht janë edhe të afërm; por duhet theksuar se format e bëmirësisë nuk mund të kufizohen vetëm në tre apo katër drejtime, sepse karakteri i fjalëve të Librit të Allahut është gjithpërfshirës dhe, në këtë këndvështrim, të gjitha urdhërat e Allahut

padyshim që kanë shtrirje shumë të gjërë, madje aq të gjërë sa është pak të thuash që përfshijnë të gjitha fushat e jetës së njeriut. Nuk mund të lëmë pa përmendur edhe urdhërin e tretë të Allahut në këtë ajet të nderuar: ndihmë për të afërmit. S'ka njeri që të mos e kuptojë ndikimin e madh që ka ndihma për të afërmin në forcimin e lidhjeve jo vetëm në mes të afërmëve të fisit, por dihet që fjala i afrëm në Librin e Allahut shtrihet edhe mbi fqinjin, mbi të njohurin, mbi bashkëqytetarin e mbi bashkëatdhetarin, madje edhe më larg se kaq, mbi vëllain njeri, kudo që ai jeton dhe ka nevojë për ndihmë. Siç shihet në ajetin e lartpërmendur Allahu, i Gjithfuqsihmi, vetëm me tri fjalë dha tri baza mbi të cilat qëndron një shoqëri e shëndoshë dhe, për të ruajtuar shëndetin e kësaj shoqërie, menjëherë në ajetin e mësipërm vijnë edhe tri ndalime: imoraliteti, çdo gjë e neveritshme dhe dhuna. Në Librin e Allahut të gjitha ndalimet përbëjnë shkelje të ligjit dhe shkelësi patjetër që mban edhe masën e përcaktuar të dënimit për shkeljen e bërë.

Nëse do të shikojmë ajete të tjera të Kur'ànit, do të gjejmë të këtilla, mësime e zgjidhje për të gjitha çeshtjet, me të cilat përballet çdo individ, çdo familje e çdo shoqëri dhe natyrshëm çdo njeri ka përgjegjësinë personale dhe detyrimin personal për të zbatuar me korrektësi urdhërin për veprim ose urdhërim për ndalim të ardhur në librin e Allahut. Për të gjitha këto myslimanët gjatë brezave, e kanë ndjerë të nevojshme të thellohen në studimin e Librit të Allahut dhe gjatë këtyre 15 shekujve, myslimanët e të gjitha kombësive kanë shkruar libra të shumtë kushtuar studimeve mbi të gjithë Librin e Allahut, ose mbi çeshtja të veçanta që trajton Kur'àni kerijmi dhe, falë kësaj pune, Libri i Allahut në ditët e sotme është përkthyer pothujse në të gjitha gjuhët e botës, janë përkthyer edhe një pjesë e mirë e interpretimve (tefsireve) të bëra për Librin e Allahut, pa harruar faktin se të gjithë interpretuesët janë

shprehur që  baza ku duhete të mbështetet myslimani mbetet vetëm teksti I Kur'àni krijmit. Koha ka vëretuar se çdo brez e ka të nevojshme të ketë një interpretim bashkëkohës të Librit të Allahut dhe kjo nevojë falë ndihmës së Allahut është bërë e mundëshme të plotësohet në saje të dijetarëve Islamë, të cilët kurrë s'kanë mungur të thellohen në studimet e tyre mbi Librin e Allahut, megjithëse janë të vetëdishëm se sado thellë që mund të kenë depërtuar në kuptimet e Kur'àni kerijmit, ata vetëm sa kanë gërvishtuar mbi të vërtetat që gjenden në Librin e Allahut. Dijetarët islamë në shekuj, si trashëgimtarë të diturisë së Profetit – paqa e shpëtimi i Allahut qoftë për atë e për familjen e tij – gjithmonë ishin e janë të vetëdishëm për detyrimin që kanë ndaj fesë e ndaj të gjithë myslimanëve për të shpjeguar deri në imtësi çeshtjet që trajton Libri i Allahut.

Nëse ndonjë myslimani, ose jomyslimani t'i shkojë në mendje dhe të thotë: si është e mundur që Kur'àni kerijmi të prekë kaq shumë fusha të dijeve, si histori, tregime, madje jep edhe njoftime shkencore, të cilat në kohën e zbritjes së Kur'àni kerijmit ishin krejtësisht të panjohura, si për shembull: trupat qiellorë lëvizin sipas një orbite të përcaktuar, retë janë mbartëse të shiut, apo çeshtje që tregojnë fuqinë e madhe të Allahut edhe nëpërmjet një insekti fare të vogël, ose çeshtje që kanë të bëjnë me astronominë, si për shembull kur njofton se Allahu është i gjithefuqishmi për të zgjeruar kozmosin, thënë ndryshe: në Kur'àni kerijmin nuk mbetet pa u trajtuar as makrobota e as mikrobota, prandaj fjala e Kur'àit **«jetedeb'berùne»** - rreth tij mendojnë – ata që lexojnë Kur'ànim, është një thirrje e vazhdueshme drejtuar çdo njeriu se Libri i Allahut patjetër duhet të lexohet jo vetëm me rregullat e vaçanta për leximin e Librit të Allahut, por edhe duke u thelluar në kuptimin e çdo fjale të tij, në lidhjen që ka kjo fjalë në pozicionin përkatës kundjet fjalës pasardhëse

dhe fjalës paraardhëse, sepse Libri i Allahut është unitet që s'mund të preket, madje paprekshmëria e Kur'ànit është vërteuar edhe me metodat e shkencës me ekzakte, matematikës, e cila ka gjetur se të gjitha fjalët e ajetet e Kur'àni kerijmit janë në përpjestim me njëra-tjetrën, prandaj çdo lëvizje e një fjale, madje edhe e një shkronje të vetme nga pozicioni përkatës, menjëhrë e prish këtë përpjestim, ndërsa vetë Allahu i lartësuar na njofton në Kur'ànin kerijm se Ai e ka zbritur dhe Ai është ruajtësi i këtij libri, ashtu siç ka ardhur në ajetin nr. 9 të sures "El-Hixhr": **«In'nà nahu nez'zelne-dh'dhikre ue in'nà lehù lehàfidhùne» «Ne me madhërinë Tonë e zbritëm Kur'ànin dhe Ne jemi ruajtësit e tij»,** do me thënë se Kur'àni kerijmi është e do të mbetet i paprekshëm nga dora e njeriut.

Fjalët e këtij Libri të papërsëritshëm kanë veçorinë se ato shpjegojnë njëra tjetrën, çka e lëhtëson shumë punën e dijetarëve që janë marrë e merren me interpretimin e kuptimeve të Librit të Allahut.

Është nga mirësitë e mëdha të Allahut që edhe ne myslimanët shqiptarë kemi në dorë Librin e Allahut të përkthyer në gjuhën shqipe, dhe jo vetëm si tekst, por edhe me komentim. Allahu i mëshiroftë të gjitha ata që marrin përgjegjësinë e përkthimit të Librit të Allahut dhe shpërblimin për punën që ata kanë bërë e do të bëjnë, lusim Allahun që me mëshirën e Tij ta gjenë të shumëfishur, ashtu siç ka premtuar i Gjithfuqishëmi në Librine Tij.

Në kuadrin e shpjegimit të kuptimeve të Librit të Alahut, edhe revista jonë, si shoqata «FLLADI», japin një ndihmesë më shumë për të vënë në dorën e myslimanëve shqiptarë sa më shumë çeshtje kuranore, duke na kujtuar të gjithëve, shkrues e lexues përgjegjësinë që kemi jo vetëm për të përvetësuar mësimet e Librit të Ahhaut, por edhe për të punuar që fjala e Allahut të arrijë deri

në skajin më të largët të vendit tonë, kudo ku jetojnë e punojnë myslmanë, me qëllimi që të gjithë myslimanët të paisen me sa më shumë njohuri kuranore, çka do t'i ndihmojë ata të kryerjnë adhurimet ditore e kohore në përputhje me urdhërat e Kur'àni kerijmit.

Fjalët e Kur'àni kerijmit edhe pse janë të shkurtëra e të thjeshta, kuptimet e fjalëve të Librit të Allahut kanë dimensione të pallogaritëshme, në të njejtën kohë janë edhe të paimitueshme, për faktin se Kir'àni kerijmi është fjalë e Allahut të lartësuar. Në disa ajet Kur'àni kerijmi I sfidon mohuesët e çdo lloji që të bëjnë qoftë edhe një sure, ose edhe një ajet si të Kur'àni kerijmit dhe, koha ka vëretaur se të gjitha përpjekjet e jobesitarëve përë bërë një Kur'àn të ngjashëm me Librin e Allahut, ose për të vërtetuar shpfjet e tyre se Kur'àni kerijmi nuk është fjalae lartë e Lartë e Allahut, megjithëse e dinë mirë që shpifja e tyre nuk I qëndron të vërettës së Kur'àni kerijmit, i cili është gjithmonë i ri, gjithmonë bashkëkohës dhe gjithmonë shkencor, jo se duam ne të themi kështu, por faktet kanë treguar e tregojnë se edhe zbulimet shkencore më të reja, në të gjitha fushat e dijes, kanë vërtetuar e do të vërtetojnë të vërtetat e Librit të Allahut, Kur'àni kerijmit.

Dhe patjetër, është detyrë e çdo myslimani që në përfundimin e çdo pune të nderuar të falenderojë Allahun me fjalën: **«elhamdu lil'làh»** - falenderimi e lavdrimi i takojnë vetëm Allahut, lutjen drejtuar të Gjithmëshirshmit që në zemrat tonë të jenë të rrënjosura dhe të ndriçohen prej dirtës së dy frazave të kelimei teudijdit: **«là ilàhe il'le-ll'llàh; Muham'medun Resùlu-ll'llàh».**

**Faik Kasollja**

# Kur'ani është udhërrëfyes për njerëzimin

**Abstrakt**
*Nga Kur'ani kanë marrë e marrin mësim shkencëtarët, janë edukuar e edukohen breza të tërë njerëzish; janë frymëzuar e frymëzohen poetët. Ajetet kur'anore, i rrinë pranë myslimanit dhe i zbulohen në mendje e në zemër me përmbajtjen e formën e tyre më të bukur. Mësimet që dalin nga morali i Kur'anit, e përgatisin çdo anëtar të shoqërisë veç e veç dhe të gjithë komunitetin bashkërisht të bashkëjetojnë në harmoni, tolerancë e mirëkuptim me këdo. Këto janë disa nga arsyet që miliona myslimanë e lexojnë, e këndojnë dhe e studiojnë Kur'anin.*

Kur'ani, pa asnjë dyshim, është udhërrëfyes për njerëzit e devotshëm. Ai u mëson atyre besimin në Zotin e Vetëm të botëve, i Cili nuk ka nevojë për askënd e për asgjë, nga i Cili nuk ka lindur kush dhe Ai nuk është i lindur prej askujt" (shih suren 112 të Kur'anit)
I gjithë teksti i Kur'anit përmban fjalën e ëmbël, të qartë e kuptimplote të Krijuesit të Gjithësisë për krijesat e veta. Kjo fjalë nuk është si çdo fjalë tjetër. "Kelamull-llah", (fjala e Zotit) vepron thellë në zemrat e njerëzve, si ilaç shërues. Ajo i mbush ato me besim, u largon shqetësimet e streset, i gjallëron kur dobësohen, i zgjon kur bien në apati, u jep forcë të pakufishme kur ndodhen në vështirësi dhe u kthjellon logjikën kur u shfaqen shenja hutimi. Nga Kur'ani kanë marrë mësim shkencëtarët, janë edukuar breza njerëzorë gjatë shekujve dhe frymëzohen poetët. Besimtarët myslimanë, hap pas hapi mësojnë nga

Kur'ani ato njohuri të domosdoshme që e ngrenë lart karakterin e njeriut. Besimtari njihet me cilësitë e Krijuesit të pashoq dhe përpiqet t'i mbajë ato brenda vetes. Ajetet kur'anore, sikurse janë plot këshilla e mençuri, i rrinë pranë myslimanit dhe i zbulohen në mendje e në zemër me përmbajtjen e formën më të bukur. Ja një shembull: *"A ka dyshim në qenien e Zotit ?" (Kur'ani, 14:10).* Ja si përgjigjet filozofi: «*Kaq i bindur jam në ekzistencën e Zotit, sa jam i bindur që shuma e këndeve të një trekëndëshi është sa dy kënde të drejtë.*» (Rene Dekart). Kur'ani e mëson njeriun të bëhet NJERI.

Detyrat, duke përfshirë edhe ato individuale, si falja e namazit, zekati, agjërimi, haxhi etj, gjithashtu, janë porosi e urdhëresa kur'anore, sikurse janë edhe ndalesat, si vjedhja, kriminaliteti, gënjeshtra, përgojimi, prostitucioni, pijet dehëse etj. Myslimani kultivon dhe kalit vetëdijen dhe ndërton personalitetin e vet për t'u përballur me problemet e për t'u integruar në gjirin e shoqërisë, në gjirin e bashkësisë islame botërore.

Mirësjellja ndërnjerëzore, etika e të folurit, trokitja në derë (të marrësh leje kur kërkon të hysh në shtëpinë e tjetrit), janë këshilla të mirëfillta nga Kelamull'llahi, e shkallë e lartë qytetërimi. Pastrimi trupor, mbajtja pastër e mjedisit janë dispozita islame. Citojmë një porosi profetike: "*Islami fillon që nga fjala e Dëshmisë (dhe* vazhdon*) deri te pastrimi i rrugës nga ato lloj objektesh që e pengojnë udhëtarin."* Në aspektin social-qytetar, ky formulim nga Profeti pesëmbëdhjetë shekuj të shkuar, më së paku, është një sinjal i cili nënkupton perspektivën e zhillimit qytetar; ai shtron para qytetarëve përgjegjësitë e detyrat nga më të thjeshtat deri tek më të ndërlikuarat.

Raportet e marrëdhënieve mes pjesëtarëve në familjen myslimane, mes prindërve e fëmijëve, mes bashkëshortëve dhe me të gjithë të njohur e të panjohur janë shpjeguar gjërësisht nga dijetarët islamë mbi bazat e Kur'anit; man-

dej, është një ajet i veçantë që porosit: "*Bashkohuni me fenë e Zotit dhe kurrë mos u përçani" (Kur'ani, 3: 103).*
Ajeti i fton njerëzit të mos bien pre e armiqve dhe e provokatorëve. Mësime të tilla të dala nga morali i Kur'anit e përgatisin çdo anëtar të shoqërisë veç e veç dhe të gjithë komunitetin bashkërisht të bashkëjetojnë në harmoni, tolerancë e mirëkuptim me këdo në këtë jetë.
Këta janë disa nga arsyet që miliona myslimanë e lexojnë Kur'anin qindra e mijëra herë gjatë jetës. **A nuk është kjo një ndër mrekullitë e Librit të Mrekullueshëm?** Kur'ani lexohet me vemendje për vlerat e tij edukuese: "*Në qoftë që ky është Islami,* - e ngrinte zërin poeti gjerman, GËTE,- *a nuk jetojmë ne të gjithë në Islam?"*
Në vend të një apostrofe, le të përmendim përshtypjet e shkrimtarit e filozofit anglez të shek. XIX, Thomas CARLYLE (lexo KARLAIL), tek përshkruan figurën madhore të H. Muhammedit (paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!). Ai thoshte: "*Asndonjerit nga perandorët me kurorë nuk i janë bindur bota sikur Muhammedit, këtij burri me xhybe e këpucë të arnuara vetë."*[1]
Gjatë historisë shumëshekullore të kulturës islame janë studiuar tema që kanë tërhequr vemendjen e shkencëtarëve: Ajeti 4 i sures 75 përmend vijat e gishtave. Sot, kjo veçanti fiziologjike e trupit të njeriut përdoret si metodë për të vërtetësuar (verifikuar) identitetin e personit. Kur'ani porosit *LEXIMIN*, mësimin e diturisë.
Kreu 96 fillon me foljen e mënyrës urdhërore "LEXO…!" Ajetet 3 e 4 po në këtë sure sqarojnë e përforcojnë domethënien e fjalës «**Ikre'**» (*Lexo!*): "*Se Zoti yt është fisnik. Është Ai që e mësoi njeriun të shkruajë me penë*". Ajete të tjerë të nxisin, me fjali të ndërtuara në formë pyetjesh retorike, se Kur'ani shquhet për stilin e tij elokuent, për gjuhën e përpunuar, për figurat letrare artistike etj.
Institucionet filologjike, fakultetet e universiteteve,

1. Thomas Carlyle, "Heroi Profet…", botimi shqip 1935, fq. 27.

dijetarët e fushave të ndryshme kërkimore që merren me studimin e arabishtes i mbajnë Kur'anin dhe gjuhën e tij pikë referimi dhe kur lind nevoja, citojnë ajete dhe i përdorin ato si gjedhe (model) në ndërtimet gramatikore e sintaksore e në çështje të tjera gjuhësore. Fatmirësisht, në ditët tona janë botuar edhe te ne disa përkthime të Kur'anit. Kjo na jep mundësinë të gjithëve të njihemi deri diku me përmbajtjen e tij. Ja disa ajete që flasin për diturinë e shkencën e që stilistika i quan pyetje retorike: *"A është i barabartë i verbëri me atë që shikon" (Kur'ani, 6:50). A janë të njëjta errësira me dritën? (13:16*). Me fjali dëftore, ky arsyetim përsëritet në ajetet 19 e 20 të sures *"Fatir"*, ndërsa ajeti: *"Përmbi çdo të ditur ka edhe më të ditur" (12:76)* të nxit, të shtyn të mos e ndërpresësh kurrë studimin. Në mënyrë të figurshme, Kur'ani e quan diturinë dritë, kurse padituriné, prapambetjen i quan **errësirë**. Vetë H. Muhammedi porosiste të mësojmë derisa të jemi gjallë e në një hadith tjetër urdhëron ta kërkojmë atë qoftë edhe në Kinë (SIN); fjala Kinë këtu mbart konceptin e një vendi shumë të largët.

Muhammedi (paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!) nuk kishte mësuar nga mësuesi, për këtë shkak është quajtur me fjalën arabe « *ummi* » që afërsisht i përgjigjet sinonimi frëgjisht "i l l e t t r è ". Megjithatë, kjo rrethanë nuk e pengoi Muhammedin të merrte mbi vete barrën e rëndë të profetësisë. Me zërin e tij u artikulua fjala hyjnore, nga goja e tij u transmetuan mesazhet e Kur'anit ashtu siç i shpallej nga Krijuesi I plotfuqishëm. Mrekullitë e Kur'anit janë të panumërta. Ne dimë fare pak prej tyre. - Ajeti *"Nxjerrim të gjallin nga i vdekuri dhe nxjerrim të vdekurin nga I gjalli" (3:27),* në vështrimin e parë të turbullon, kur dëgjon se si nxënësi 10-12vjeçar i shkollës e shikon me mikroskop një kërpudhë në epruvetë dhe ka mësuar se nga kashta e thatë lind një spore e gjallë, pa u menduar të del përpara besimi se Zoti i plotpushtetshëm

është Krijuesi i gjithçkaje mjafton të urdhërojë: «BËHU!» dhe krijohet, ashtu sikurse zotëron mundësi për ta zhbërë Gjithësinë me një fjalë të vetme. Kjo e vërtetë nuk mund të vihet në dyshim.
Krijuesi i pashoq i gjithësisë është i Lavdishëm; vetëm atij i përkasin të gjitha meritat, Mëshiruesi, Mëshirëbërësi. - Një tjetër ajet: « *Ti i shikon malet dhe i pandeh të shtangur (të ngrirë). Ata notojnë në hapësirë si retë» (27:88)*. Po ashtu, ajetet 38-39 e 40 të "Jasin-it" bëjnë fjalë për diellin, hënën e për trupa të tjerë qiellorë **që notojnë në hapësirë.** Lëvizjen heliocentrike të Njutonit, myslimanët e kishin mësuar nga Kur'ani qëkur ai u shpall në shek. 1 të Hixhretit. Mesazhet e Kur'anit janë "leksione", mësime, udhëzime për të ndritur mendjen e njeriut. H. Muhammedi nuk ishte astronom; mandej, ai ishte "i l l e t t r è" Premisat të çojnë në arsyetimet e mëtejshme dhe deduksionet i nxjerr gjithkush në zemrën e vet, sepse Islami ka shpallur parimin e njohur: «*…Nuk ka detyrim në fe* ». *(2:256)*
-Ajeti: «*Ai ( Zoti ) krijoi dy dete që e hasin njëri-tjetrin gjatë rrjedhës nëpër masën ujore të oqeanit. Ndërmjet është një pengesë që ata nuk përzihen». (55:19-20) Dy* rrymat detare, nga të cilat, njëra me ujë të kripur e tjetra me ujë të ëmbël, tek rrjedhin Brenda masës ujore oqeanike, nuk përzihen. Edhe ky fenomen njihet nga oqeanologët. Është e tepërt të bëhen komente, se kjo mrekulli kur'anore, flet vetë. Fenomene natyrore të shpallura nga Kur'ani e të transmetuara para 15 shekujsh I vërteton shkenca bashkëkohore. Ajeti: «...Një *ditë që zgjat sa 50000 vjet sipas ditëve tona...» (70:4)* Ky problem është trajtuar në shtypin islam shqiptar dhe është shpjeguar me etapat gjeologjike nga Muharrem Mitrovica. (shiko artikulli: "A pajtohet feja islame me shkencën rreth vjetërsisë dhe krijimit së botës", Rev. "NJERIU" V. II, No. 2, Gusht 1943, fq. 9-10. Po për këtë çështje ka shkruar edhe Haki Sharofi në revistën

"Kultura Islame", V. IV, nr. 12, Gusht 1943, fq. 206-209). Edhe Sharofi është I atij mendimi si Mitrovica.

Ajo çka mund të thuhet me këto pak shembuj është se Kur'ani qerimi jo vetëm nuk e refuzon shkencën, por ai e shtyn njeriun të vazhdojë sa të mundet në kërkime shkencore, sikurse mësojmë nga ajeti: *«Nëse keni mundësi të dilni përtej kufijve të qiejve e të tokës, depërtoni pra ! ...» (55:33)*

Zbulesat kur'anore, secila më e rëndsishme, më tërheqëse se tjetra, vetë ato, e bëjnë aq të mirëpritur e aq shumë të lexuar librin hyjnor të myslimanëve dhe po kaq të respektuar nga besimtarët, po edhe nga shumë të tjerë që nuk janë deklaruar myslimanë.

Vlera të posaçme ka filozofia kur'anore, dispozitat, urdhrat e këshillat në fushën e së drejtës, të jurisprudencës, të legjislacionit. Bota e sotme nuk do të kishte mundur të shkruante ligje të cilësisë bashkëkohore, pa ndikimin e Islamit sidomos në aspektin e **mbrojtjes civile.**

Ligjvënësit perëndimorë, jo rrallë, janë detyruar të konsultohen me të drejtën islame, me definicionet e procedurat e praktikuara nga Sheriati.

Le të sjellim ndonjë shembull: Për shkak të masakrave, të krimeve kundër njerëzimit, akte dhune e raprezaljesh të kryera ndaj popujve, është dashur që krerë shtetesh dhe personalite kryesore institucionesh në ditët tona kanë qenë të detyuruar të kërkojnë falje publike. Inkuizicioni, apo fushatat luftarake shfarosëse, iu shkaktuan popujve dete gjaku. Fatkeqësi të tilla janë të panumurta edhe për shkaqe ideologjike e politike . Kur'ani përmban një postulat të shprehur në më shumë se një ajet. Ja njëri prej tyre: *"Askush nuk mbart fajin e tjetrit..." (17:15)*. Ky ajet u ka nxjerrë ngatërresa gjyqtarëve e gjykatave perëndimore, sepse sipas tyre njeriu lind mëkatar. Kjo sentencë ka origjinë fetare, përveç Islamit. Mandej, në mënyrë abuzive, është përdorur në dëm të jetës së qytetarit e të

shoqërisë. Sot e kësaj dite, shumë krime nuk zbulohen, nuk kryhen fare hetime për të. Në procesin e luftrave për hegjemoni, të luftrave koloniale, të luftrave të frymëzuara nga parime politike e ideologji antipopullore dhe antikombëtare, janë kryer masakra barbare. Islami i ka evituar me vendosmëri padrejtësitë e terrorin. Në historinë e përhapjes, Islami nuk ka praktikuar kurrë dhunë, sepse Islami frymëzohet nga humanizmi e drejtësia. Shkencat islame udhëhiqen nga principe përparimtare: "Kush vret një njeri është sikur ka vrarë gjithë njerëzinë". Xhorxh Sale thonte: "*Unë nuk dua të hulumtoj shkaqet e mirëkuptimin e paparë që ka hasur feja islame në botë, por atyre që mendojnë se ajo është përhapur me shpatë, mund t'u them se ata mashtrojnë vetveten*" (Thomas W. Arnold: "Historia e përhapjes së Islamit", Shqip, fq. 14)

Baza teorike që ofron Kur'ani hap perspektiva të pakufishme për zhvillimin e kulturës dhe ecjen përpara të shkencave e të diturisë. Nga ana tjetër, në aspektin praktik Islami zhduku pengesat, barrierat artificiale, mënjanoi disproporcionet mes grupimeve, klaneve e fiseve; refuzoi me vendosmëri diskriminimin racial, pabarazinë mes nacionaliteteve dhe ato gjuhësore dhe lartësoi kriterin se sa është i përkushtuar besimtari për të përmbushur detyrimet fetare. Kur'ani urdhëron: "*...Sigurisht, më i preferuari ndër ju (më i dalluari) është ai që ruhet më shumë nga gjynahet...*" *(Kur'ani, 49:13)*. Në shoqërinë islame askush nuk e ndien veten të huaj, pavarësisht nga prejardhja racore, nacionale, nga gjuha që flet personi, nga shkalla shoqërore, apo nga mundësitë ekonomike. Islami zgjidhi në mënyrë të përkryer barazinë mes njerëzve brenda një kohe të shkurtër dhe hodhi themelet e qytetërimit i arabomysliman, i cili la gjurmë të thella në kulturën botërore megjithë faktorët negativë nga armiqtë tradicionalë që njeh me hollësi historia. Deri në shek. XVI, për shembull, librat e dijetarit Ibn Sinai (Avicena) në fushën e mjekë-

sisë, të përkthyer në gjuhën latine, mbaheshin si veprat më të mira e më të preferuara nga mjekët europianë.
Rënia e famës së qytetërimit islamo-arab erdhi si rrjedhojë e pushtimeve koloniale të këtyre vendeve nga ushtritë agresore intervencioniste të shteteve europiane. Ky fenomen pengoi për një kohë relativisht të gjatë zhvillimin e shkencës e të kulturës të popujve të robëruar. Vendet islame të pushtuara vuajtën shumë, po nuk u gjunjëzuan. Ata kishin një armë të sigurt që i bashkonte, i frymëzonte dhe i kompaktësonte me mësimet e tij e me gjuhën e përbashkët. Ky ishte Kur'ani, Libri i madhëruar i myslimanëve, i cili mbrojti identitetin e tyre kombëtar, gjuhësor e shpirtëror të atyre popujve.
Sot popujt myslimanë përbëjnë një faktor me rëndësi në arenën e planetit. Pikërisht këtu fshihet sekreti i forcës së madhe çudibërëse të Kur'anit. Këtu fshihet një tjetër mrekulli e Kur'anit emërmadh.

**Sulejman ef. Rexhepi**[1]

# Vlera e jetës së njeriut

Është një anekdotë arabe që thotë "Delja pas therjes nuk ndien asgjë." Kështu, kur njeriu vritet nga një grup njerëzish, vdekja është një, që me të drejtë thuhet: "Ai që nuk vdes nga shpata, vdes nga diçka tjetër. Çfarëdo të jenë shkaqet, vdekja është një." Nuk mund të flitet për vdekje të kuqe apo të kaltër, sepse mbarimi i afatit të jetës është i njëjtë për të gjithë, siç përfundon edhe jeta e deles. Mirëpo, gjëja më e çmueshme është vlera e njeriut, për të cilën në Kur'an thuhet: ***"Kush vret një njeri (pa të drejtë), pa patur vrarë ai ndonjë tjetër dhe pa patur bërë ai ndonjë shkatërrim në tokë, atëherë është si t'i kishte vrarë të gjithë njerëzit."*** ("El Maide", 23) Përfundimisht, ndalohen të gjitha llojet e terrorizmit e me këtë rast, ndalohet dhuna. Allahu i Lartmadhëruar thotë në Librin e Shenjtë: ***"Allahu urdhëron drejtësi, bamirësi, ndihmë të të afërmve, ndalon nga imoraliteti, nga e neveritura dhe dhuna..."*** ("En Nahl", 90)

Në një ajet tjetër, Allahu ndalon nga padrejtësia: ***"Ti përqendrohu me vendosmëri, ashtu si je i urdhëruar, e bashkë me ty edhe ata që u penduan e mos tejkaloni kufijtë e caktuar..."*** ("Hud", 112)

1. Mendimtar, intelektual, pedagog islam. Lindi në vitin 1947, në fshatin Sfillare e Sipërme të Shkupit. Mbaroi Universitetin e Kuvajtit në Fakultetin e Drejtësisë dhe Sheriatit. Është një ndër themeluesit e Medresesë "Isa Beu" në Shkup. Është anëtar i Kuvendit të Lartë për Çështje Islame me seli në Kajro, anëtar i Kongresit Botëror Islam me seli në Tripoli, anëtar i unionit islamik për Evropën, zëvendëssekretar i përgjithshëm i Kuvendit të Këshillit për Europën Lindore me seli në Stamboll, anëtar i Forumit të Shkencëtarëve islamë, me seli në Rabat, zëvendëskryetar i Shurës Euro-aziatike, me seli në Ankara etj. Ka botuar dy vepra: "Për fe e atdhe" dhe "Vetëm Krijuesit Tim i përkulem".

Është drejtuar qortimi me dënim në fjalën e Allahut: ***"Vërtetë, Xhehenemi është në pritë. Është vendstrehim i arrogantëve."*** ("En Nebe'e", 22) ***"... E cilido që bën padrejtësi prej jush, Ne i japim atij të përjetojë një dënim të madh"*** ("Furkan", 19)

Më tej, duke iu kanosur të padrejtëve, Allahu thotë: ***"E ata që bënë padrejtësi, do ta kuptojnë se ç'përfundimi i shkojnë."*** ("Esh Shuara", 227)

Pastaj ajeti tjetër: ***"E të mjerët ata që janë të padrejtë nga dënimi i ditës së dhembshme."*** ("Ez Zuhruf", 65)

Në hadithin kudsi janë ndaluar këto veprime në mënyrë të rreptë, ashtu siç thuhet: *"O robtë e Mi, unë kam ndaluar rreptësisht padrejtësinë për Veten time, e të njëjtën e kam bërë rreptësisht të ndaluar edhe mes jush. Andaj, mos bëni padrejtësi"*. Veprimet armiqësore janë rreptësisht të ndaluara. ***"...si luftoni në rrugën e Allahut kundër atyre që ju sulmojnë, e mos e teproni se Allahu nuk i do ata që e teprojnë."*** ("El Bekare", 190)

Në Kur'an është e ndaluar tradhtia: ***"Allahu nuk i do ata që tradhëtojnë."*** ("El Enfal", 58)

Në një ajet tjetër, Allahu ka ndaluar mashtrimin: ***"Krijesat më të dëmshme te Allahu janë ata që mohuan, nuk pritet që ata të besojnë. Këta janë ata prej të cilëve ti pate marrë, e të cilin ata nuk e ruajtën, por si çdo herë e thyejnë premtimin e tyre."*** **("**El Enfal", 55-56)

Është e ndaluar vepra penale e vjedhjes me ajet në Kur'an ku thuhet: ***"Vjedhësit dhe vjedhëses prijini duart, si shpagim i veprës së bërë, dënim nga Allahu. Allahu është i Fuqishëm, Ligjdhënës i Urtë."*** ("El Maide", 38)

Është e ndaluar vepra penale e grabitjes: **"Dënimi i atyre që luftojnë Allahun dhe të Dërguarin e Tij dhe bëjnë shkatërrime në tokë, nuk është tjetër vetëm se të vriten ose të gozhdohen ose të gjymtohen, t'u priten duart dhe këmbët e tyre të anëve të kundërta, ose të dëbohen nga vendi. Kjo është poshtërim për ta në këtë botë dhe në**

**botën tjetër ata do të kenë dënim të madh. Përveç atyre që janë penduar para se t'i kapni. E, dijeni pra, se Allahu bën falje të madhe, është Mëshirues."** ("El Maide", 33-34)

*Vlerat dhe roli i tyre në sigurinë shoqërore*

Dr. Xhafer Abduselam, sekretar i përgjithshëm i Unionit të Universiteteve Islame, në librin e tij "Islami dhe të drejtat e njeriut", ka hulumtuar vlerat njerëzore dhe raportin e tyre me të drejtat e njeriut për nga pikëpamja islame, si dhe rolin e tyre në sigurinë shoqërore. Këto vlera janë: drejtësia, barazia dhe liria. Hulumtimi i tij është përfshirë në katër kapituj. Në kapitullin e parë të librit të tij jep sqarime rreth kuptimit të këtyre vlerave. Kapitulli i dytë analizon qëndrimin e Islamit ndaj vlerave njerëzore dhe të drejtat që ia njeh sheriati islam. Kapitulli i tretë dhe i katërt përfshijnë hulumtime në dokumente rreth të drejtave dhe detyrimeve të myslimanëve dhe jomyslimanëve. Në dokumentin e dytë ka sqaruar çështjen rreth pushtetmbajtësit dhe popullatës. Me këtë studim analitik për nga pikëpamja islame rreth rolit të vlerave në sigurinë shoqërore, të argumentuar me ajete kur'anore dhe hadithe nga syneti i Muhamedit, i ka dhënë cilivizimit islam kuptimin e tij real dhe rolin e madh në mesin e gjitha cilivizimeve njerëzore. Autori me këtë e ka pasuruar edhe më shumë thesarin e kulturës islame bashkëkohore. Liria, për nga pikëpamja islame është një prej vlerave që luajnë rol të rëndësishëm në sigurinë shoqërore. Njeriu për nga natyra është krijuar i lirë. Atij i është dhuruar e drejta e veprimit, i është dhuruar logjika me të cilën ai dallon të dobishmen nga e dëmshmja, të mirën nga e keqja. Për të (njeriun) janë dërguar Pejgamberët, udhëzues që ia ndriçojnë atij rrugën si dhe, për veprimet e tij, pason shpërblimi dhe dënimi. Si rezultat i kësaj lirie, me të ciën e ka begatuar Allahu, përparojnë popujt. Me anë të lirisë së mendimit që e gëzojnë anëtarët e një populli, njëherit pos tjerash, me këtë ia tejkalojnë të tjerëve në

përparim. Mirëpo, kjo liri është e rregulluar me ligje që garanton mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. ***Liri*** nuk do të thotë që njeriu të veprojë çka të dëshirojë, të dëmtojë të tjerët ose të shkaktojë shqetësim. Liri, do të thotë, të veprosh atë që e dëshiron, pa i dëmtuar të tjerët, si dhe, pa shkelur fare në parimet fetare dhe ligjin. Ajetet që flasin për lirinë e të menduarit janë të shumta, ku mes tjerash theksojmë: ***"Lexo, me emrin e Zotit tënd, i Cili krijoi (çdo gjë). Krijoi njeriun prej një gjaku të ngjizur (në mitrën e nënës). Lexo! Se Zoti yt është më Bujari! Ai që e mësoi (njeriun) të shkruajë me pendë. I mësoi njeriut atë që nuk e dinte."*** ("El Alek", 1-5)
***"Shfaq haptas atë për të cilën urdhërohesh, e largohu nga idhujtarët."*** ("El hixhr", 94)
***"Ti (Muhamed) thirr për në rrugën e Zotit tënd me urtësi e këshillë të mirë dhe polemizo me ata (kundërshtarët) me atë mënyrë që është më e mira."*** ("En Nahl", 125)
El Hasan El Basriu, në ligjëratën e tij të njohur, ka thënë: "O biri Ademit, shite këtë botë për Ahiretin, do t'i fitosh që të dyja, e mos e shit Ahiretin për këtë botë, se do t'i humbësh të gjitha. Biri i Ademit, kur t'i shohësh njerëzit duke vepruar mirë, garo me ta, e kur t'i shohësh duke vepruar keq, mos i lakmo." Do të flas para jush për dy parime të mëdha prej parimeve islame: drejtësinë dhe paqen. Ajetet kur'anore që flasin për këto dy parime janë të shumta, në mesin e të cilave do të theksoj: **"O *njerëz, vërtet Ne ju krijuam juve prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj e fise që të njiheni ndërmjet veteve, e s'ka dyshim, se te Allahu, më i ndershmi ndër ju është ai që më tepër është ruajtur (këqijat), e Allahu është shumë i Ditur dhe hollësisht i Njohur për çdo gjë."*** ("El Huxhurat", 13)
***"Allahu urdhëron drejtësi, bamirësi, ndihmë për të afërmit, e ndalon nga imoraliteti, nga e neveritura dhe dhuna. Ju këshillon ashtu, që të merrni mësim."*** ("En Nahl", 90)
***"Kur të flitni (të dëshmoni), duhet të jeni të drejtë edhe***

***nëse është çështja për (kundër) të afërmit dhe zotimin e dhënë Allahut plotësoni."*** ("El En'am", 152)
***"... të mos u shtyjë urrejtja ndaj një populli e t'i shmangeni drejtësisë; bëhuni të drejtë, sepse ajo është më afër devotshmërisë."*** ("El Maide", 8)
Islami është një mesazh i kompletuar për gjithë njerëzinë, ku nuk ka dallim arabi nga i huaji, që do të thotë: nuk ka dallim mes individëve. Qëllimi i Islamit është që njeriun ta udhëzojë në rrugën që shpie për realizimin e devotshmërisë në jetën e njeriut. Parimet më të rëndësishme të një shoqërie të shëndoshë janë: drejtësia, paqja dhe vëllazëria. Islami është fe, në të cilën nuk ka vend për egoizëm njerëzor e as për monopol. Drejtësia, siç kërkohet në vepra, kërkohet të jetë edhe në fjalë. Islami është fe e tolerancës dhe e paqes. Islami është fe që u ka siguruar njerëzve qetësinë psikike dhe shpirtërore, me anë të të cilëve ua lehtëson atyre vështirësitë dhe dhembjet e jetës. Ai ka nxjerrë njerëzinë nga ambienti i urrejtjes, zilisë, përçarjes dhe racizmit, duke i përcjellë në ambientin e dashurisë, tolerancës, bashkëpunimit dhe barazisë para Allahut dhe ligjit. Në jetën shoqërore të gjithë njerëzit janë të barabartë, ku nuk lejohet dominimi i një etniteti ndaj tjetrit, e as një grupi ndaj një grupi tjetër, e as një populli ndaj një populli tjetër. E gjithë kjo shihet qartë në realitetin e jetës së myslimanëve dhe në shkencat islame. Islami është fe e paqes, e dashurisë dhe e tolerancës. Sipas Islamit, të gjithë njerëzit janë krijuar nga një baba dhe se homogjeneza e njeriut për gjithë njerëzit është një. Pas kësaj, sado që të ndahen njerëzit në popuj, fise, vende, lloje etj., kjo ndarje është si ndarja e anëtarëve të një shtëpie, ose e vëllezërve nga një baba. Çdo gjë që është kështu, atëherë rrugë e vetme për shpëtim është që kjo ndarje të shpie në bashkëpunim, njohje dhe ndihmë drejt së mirës. Feja islame nxit për drejtësi në vepra dhe fjalë. Muhamedi (paqja dhe bekimet e Allahut

qofshin mbi të!) ka thënë: "Popujt që kanë qenë para jush, janë shkatërruar për arsye se kur vidhte personi i ndonjë familjeje të ndershme, e lironin, ndërsa kur vidhte ndonjë i dobët, e zbatonin mbi të sanksionin. Për Allahun, sikur edhe Fatimja, e bija e Muhamedit të vidhte, do t'ia prisja dorën." Transmeton Buhariu, Myslimi dhe Ahmedi.

Islami është fe e paqes, e tolerancës dhe vëllazërisë. Muhamedi (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) e ka luftuar fanatizmin e xhahilijetit dhe ka thënë: "*Nuk është prej nesh ai, i cili thërret në fanatizëm.*" Në një tjetër hadhith Muhamedi (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: "*Nuk është fanatizëm që njeriu ta dojë popullin e vet, por fanatizëm është ta ndihmojë popullin e vet në padrejtësi.*"

Xhon Loku, në librin e tij "Mesazhi i tolerancës", i cili llogaritet një ndër librat më të rëndësishëm, që sqaron mendimin fetar të krishterë, pa fanatizëm dhe anim, ka përfshirë dy dimensione: historik dhe atë ideologjik. Ai thotë: "Mendoj se çdo njeri parafytyron se është i përgatitur për ta dëmtuar njeriun tjetër, me arsyetimin se do të shpëtojë veten. Një lloj i tillë i njerëzve është i papranuar për mua dhe për çdo person tjetër. Është mëse e vërtetë, se nuk ka asnjë njeri që beson se një vepër e tillë lind nga dashuria ose dëshira e të mirës për tjetrin." Ai, mesh të tjerash, në librin e tij, shkruan: "Toleranca mes atyre që besojnë fe të ndryshme përputhet plotësisht me Dhiatën e Re, që i ka zbritur Isait, sikurse që përputhet me kërkesat e logjikës së vërtetë njerëzore. Është shumë e çuditshme për njerëzit që njeriu i verbër nuk e ndien deri në atë shkallë nevojën për domosdoshmërinë e tolerancës."

Të gjitha fetë e Zotit rrjedhin nga i njëjti burim.

Allahu thotë: ***"Ai ju përcaktoi juve për fe atë që ia pat caktuar Nuhut dhe atë që Ne ta shpallëm ty dhe atë me çka e patëm porositur Ibrahimin, Musain dhe Isain. (I porositëm) ta praktikoni fenë e drejtë e mos u përçani në të."*** ("Esh Shura", 13)

Kërkesat e Islamit janë të qarta për mbarë botën. Ato

thërrasin mbarë njerëzinë për drejtësi dhe paqe. Gjithë Pejgamberët janë vëllezër. Nuk ka dallim mes tyre për nga pejgamberia. Prandaj myslimanët detyrohen t'i besojnë të gjithë. Allahu thotë: ***"Ju (besimtarë) thoni: "Ne i besuam Allahut, atë që na u shpall neve, atë që iu shpall Ibrahimit, Ismailit, Is'hakut, Jakubit dhe pasardhësve (të Jakubit që ishin të ndarë në dymbëdhjetë kabile), atë që i është dhënë Musait, Isait dhe atë që u është dhënë nga Zoti i tyre pejgamberëve, Ne nuk bëjmë dallim në asnjërin prej tyre dhe Ne vetëm atij i jemi bindur."***
("El Bekare", 256)
Thirrja për në Islam nuk mund të jetë thirrje me dhunë, por thirrje me bindje dhe pëlqim. ***"Në fe nuk ka dhunë".***
("El Bekare", 256)
***" Sikur të kishte dashur Zoti yt, do t'i besonin çka janë në tokë që të gjithë. A do t'i detyrosh njerëzit të bëhen besimtarë"?*** ("Junus", 99)
Të gjitha vendet për adhurim, qofshin xhami, kisha apo faltore, duhet të çmohen dhe duhen mbrojtur siç mbrohen xhamitë e myslimanëve.
***"E sikur Allahu të mos i zmbrapste disa me disa të tjerë, do të rrënoheshin manastiret, kishat, havrat e edhe xhamitë që në to përmendet shumë emri i Allahut."*** ("El Haxh", 40)
Dallimet mes njerëzve në fe, nuk duhet të jenë shkak që të mbysin njëri-tjetrin, e as të bëjnë padrejtësi ndaj njëri-tjetrit, por duhet të bashkëpunojnë drejt të mirës dhe për të luftuar të keqen.
***"Ndihmohuni mes veteve me të mira dhe në të mbara, e mos bëni mëkate e armiqësi."*** ("El Maide", 2)
Gjykues mes tyre për mospajtimet e tyre është vetëm Allahu në Ditën e Kiametit.
***"Po në Ditën e Gjykimit për atë që ata nuk pajtoheshin, Allahu gjykon ndërmjet tyre."*** ("El Bekare", 113)
Dallimi në vlera mes njerëzve në këtë jetë dhe tek Allahu varet nga ajo se sa njerëzit ofrojnë vepra të mira për vete

dhe të tjerët.
***"S'ka dyshim, se te Allahu, më i ndershmi ndër ju është ai që më tepër është ruajtur."*** ("El Huxhurat", 13)
Për të kuptuar dallimet e njerëzve në fe, duhen zhvilluar polemika e diskutime mes tyre në nivel dhe brenda kufijve të etikës, argumentit dhe të bindjes.
***"Ithtarët e Librit mos i polemizoni ndryshe (kur i thirrni në fenë tuaj), vetëm ashtu siç është më së miri, përveç atyre që janë mizorë."*** ("El Ankebut", 46)
Nuk lejohet fyerja në kundërshtarë, e as sharja e besimit të tyre, qofshin ata edhe idhujtarë.
***"Ju mos ua shani ata (zota) që u luten (idhujtarët), pos Allahut, e (si hakmarrje) të fyejnë Allahun nga armiqësia, duke mos ditur."*** ("El En'am", 108)
Nëse sulmohen myslimanët, atëherë duhet një kundërvënie për këtë armiqësi për ta mbrojtur besimin dhe për ta larguar fitnen.
***"Luftoni ata (idhujtarët), derisa të zhduket propagandimi i idhujtarëve dhe derisa të aplikohet feja vetëm për Allahun."*** ("El Bekare", 193)
Feja islame ndalon nga hakmarrja. Nëse myslimanët triumfojnë ndaj atyre që duan të okupojnë vendet e tyre ose t'ua privojnë lirinë e tyre, nuk lejohet hakmarrja ndaj tyre e as detyrimi për të lënë fenë e tyre. *"Atyre u takojnë të njëjtat të drejta që na takojnë neve dhe kanë të njëjtat obligime që kemi edhe ne"*. Ky është Islami, fe e drejtësisë dhe e paqes, pa fanatizëm, që ofron barazi dhe tolerancë. Fe që synon të lehtën, mëshirën dhe drejtësinë. Fe që e mbron interesin e individit brenda interesit të shoqërisë pa lënë anash interesin e përgjithshëm njerëzor dhe interesin e njerëzisë pa i humbur karakteristikat dhe veçoritë e popujve dhe pa asgjësuar dinjitetin e tyre. Fjala më e bukur që është thënë në këtë kontekst është se *"ekziston dallimi rrënjësor mes çlirimit nga prangat e nënçmimit, dobësisë dhe shtypjes dhe çlirimit nga parimet njerëzore"*. E para

do të thotë *liri e vërtetë*, ndërsa e dyta do të thotë *heqje dorë nga vlerat që e kanë bërë njeriun njeri dhe e kanë dalluar nga krijesat e tjera."*

**Prof. dr. Feti Mehdiu, akademik**

# Muhafizët shqiptarë në 100 vjet

Dijetarët myslimanë shqiptarë dhe jo vetëm ata shqiptarë, kanë kontribuar që Kur`ani Kerim të gjejë shtrirje dhe të zërë vendin e merituar në mesin e këtij populli për rreth gjashtë shekuj.[1] Këtu bëjnë pjesë të gjithë ata që ia kanë mësuar, qoftë edhe vetëm një fëmije *"elifin"* a *"elhamin"* – çelësin e Kur`ani Kerimit, në meitep a në universitet, në xhami a në çarshi. Ata janë bërë hallka të atij zinxhiri që shtrihet nga shekulli i katërmbëdhjetë e deri sot.[2] Ndërkaq, pas vitit 1912 – pas shpalljes së Pavarësisë - dijetarët myslimanë shqiptarë janë ata që përkundër peripecive që përjetuan nga ndërrimi i pushteteve, sidomos pushteti totalitar komunist, e ruajtën, e kultivuan dhe e përhapën dashurinë për këtë libër në mesin e bashkëkombasve të vet. Në këtë periudhë njëqindvjeçare, 1912 – 2012, dijetarët myslimanë shqiptarë ngritën më lart format dhe rrugët e përhapjes së Kur`anit në mesin e shqiptarëve, përpiluan a hartuan librat për të mësuar shkrimin dhe gjuhën e Kur`anit.[3]

Zhvillimi i shtypit shqiptar islam, pas shpalljes së Pavarësisë, ka luajtur rol të rëndësishëm në shtrirjen e

1. Kemi para sysh periudhën 1389 - pas betejës së Kosovës, kur feja islame përhapet në formë institucionale. Që nga ajo kohë, Kur`ani Kerim gjallëron në mesin e shqiptarëve.
2. Le të mbetet detyrë e brezave të ardhshëm për të hulumtuar më hollësisht dhe më thellësisht periudhën e kaluar.
3. Deri në vitin 1912 ato mësime merreshin nga doracakë në gjuhën turke ose arabe, si Emthile, Bina, Avamil, etj., ndërsa pas shpalljes së Pavarësisë kemi **Sintaksën e gjuhës arabe** të hfz Ali Korçës, **Fonetikë dhe morfologji të gjuhës arabe** nga Feti Mehdiu**, Hyrje në shkronjat e Kur`anit** nga Idriz Demriri, etj.

Kur'anit në masat shqiptare islame. Në këtë periudhë zunë fill: *Zani i Naltë, Kultura Islame, Njeriu, Jeta Muslimane Shqiptare, Takvimi, Edukata Islame, Dituria Islame, Hëna e Re, Drita Islame, Këshilla, Drita e Kur'anit* dhe të tjera, në faqet e të cilave, duke filluar nga viti 1923, opinioni shqiptar është ushqyer dhe është rritur me ajete a me fragmente të përkthyera të Kur'anit.[4]
Gojarisht, Kur`ani Kerim është përkthyer në gjuhën shqipe, shumë më herët; kurse me shkrim, që nga viti 1922, në Ploeshti - Rumani; dhe më 1924, 1929, 1997, Tiranë, më 1985, 1988, në Prishtinë etj. [5]. Përveç në letër, opinioni shqiptar e ka sot Kur`anin të përkthyer në gjuhën shqipe edhe në DVD.[6] Sot, ka edhe shumë mundësi të tjera për drejtlexim, për interpretim, për komentim etj.[7] Muhafizët shqiptarë [8] janë ata dijetarë myslimanë, të cilët pas shpalljes së Pavarësisë – 1912-2012, kontribuan në përhapjen e Kur`anit te shqiptarët. Ata janë, kryesisht të përkatësisë kombëtare shqiptare.[9] Krahas rolit të dijetarëve në përgjithësi, që me kontributet e tyre, në xhami, jashtë xhamisë - nëpër ndenja e ceremoni fetare, me përpilimin a me përhapjen e librit për Kur`anin, me zërin e tyre tërheqës në minare a në përkujtimin e Lindjes së Pejgamberit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) – Mevludit etj., muhafizët kanë një kontribut të veçantë

4. Shih: Feti Mehdiu, *Literatura islame shqiptare jashtë Shqipërisë londineze pas Luftës së Dytë Botërore, Feja, kultura dhe tradita islame ndër shqiptarët*, Prishtinë, 1995; *Shtypi islam dje, sot dhe nesër*, Prishtinë, 2005 etj.
5. Feti Mehdiu, *Përkthimet e Kur`anit në gjuhën shqipe,* Shkup, 1996.
6. Feti Mehdiu, Përkthimi i Kur`ani Kerimit nga Hasan ef. Nahi dhe veçoritë e ribotimit të këtij përkthimi, *Takvim, 1435 h. - Kalendar*, 2013, Prishtinë.
7. Janë botuar disa Texhvidë, doracakë për fëmijë e në kohët më të vona, kemi edhe incizime në CD etj.
8. Kushtimisht mund të quhen edhe instruktorë ose trajner, por termi më i saktë mbetet MUHAFIZ – ai që i mëson dikujt, i ndihmon dikujt të nxërë përmendsh Kur`anin.
9. Për hollësi të përkatësisë së muahfizëve shih: ***Hafizët tonë gjatë historisë – leksikon***, Prishtinë, 2010.

për ruajtjen e Kur`ani Kerimit te masa jonë, sepse ata ua mbjellin në tru SHPALLJEN E ZOTIT– Kur`anin.
Do të përmendim muhafizët më të njohur të hapësirës shqiptare, të vetëdijshëm se shumëkujt do t`i mbetemi borxh, por pa qëllim.[10]

*Hfz. Ahmet ef. Shatoku – Tetovë*

Një nga muhafizët më të suksesshëm në Tetovë ndërmjet dy luftërave botërore. Nga hafiz Ahmeti e kanë mësuar hifzin shumë hafizë të Tetovës me rrethinë. Pas Luftës së Dytë Botërore, emigroi në Turqi.[11]

Hfz. *Ali ef. Ahmedi*, 1878 - 1952 - Preshevë

Ka kryer hifzin në vitin 1890 te hfz. Ahmeti në Preshevë. Ishte profesor në Daru-l-Mual-limin në Prizren dhe drejtor i asaj shkolle në fillim të shekullit XX, deri pas Luftës së Parë Botërore. [12]

Hfz. *Ali ef. Pakashtica, 1888-1968 - Prishtinë*

Ka kryer studimet në Stamboll. Pas kthimit nga Stambolli, ka shërbyer në vendlindje në fushën e arsimit islam dhe shqiptar. Nga ky, mësuan hifzin hfz. Rushiti dhe hfz. Mehmeti. [13]

10. *Për arsye objektive, nuk kemi prezantuar shkollat e hifzit në Sauk dhe në Gjakovë, të cilat në dhjetëvjetëshin e fundit kanë kontribuar dukshëm në kultivimin e hifzit në hapësirën shqiptare.*
11. Dr. Feti Mehdiu, *Hafizët tanë gjatë historisë – Leksikon, shek. XVIII-2010,* Prishtinë, 2010.
12. Po aty.
13. Po aty.



Hfz. *Besir ef. Imeri*, 1952 - *Gostivar*

U lind në fshatin Raven. Hifzin e kreu në vitin 1970 te hfz. Kamberi në Banjicë. Ka kryer medresenë Alauddin në Prishtinë. Studioi Usulud-dinin në Rijd, ka diplomuar në degën e Orientalistikës në Universitetin e Prishtinës në vitin 1990. Punoi mual-lim në xhaminë e sahatit në Gostivar dhe arkëtar i Myftinisë në Gostivar. Edhe në periudhën sa ishte edukator në Medresenë Isa Beg në Shkup, nga viti 1991 deri në vitin 1999, ka udhëhequr hafizë të ri, deri në arritjen e diplomës së hifzit. [14]



Hfz. *Berzat* ef. Kasami, 1918-1987 - *Gostivar*

Ka lindur në fshatin Reçan-Gostivar. Hifzin e kreu në vitin 1938 te hfz. Hamdiu në Gostivar, për vetëm nëntë muaj. Ka shërbyer imam në Reçan deri në vitin 1969. Sa ishte në këtë detyrë, ua mësoi hifzin: hfz. Nexhat Ibrahimit, hfz. Zenun Miftarit, hfz. Nuriman Abdylit dhe hfz. Sali Musliut. Në vitin 1970 shpërngulet për Turqi dhe ndërroi jetë në Stamboll.[15]



Hfz. *Elmaz* ef. Qamili, 1933 – *Tetovë*

U lind në Poroj të Tetovës. Hifzin e kreu te hfz. Ejupi. Te hafiz Elmazi kanë mësuar hifzin disa hafizë dhe ka kënduar mukabele në Mitrovicë në vitet 50'. [16]

14. Po aty.
15. Po aty.
16. Po aty.

Hfz**.** *Fetije* Alija, (**Hafëska madhe),** 1939 - *Kumanovë*

Hifzin e filloi te Ferat Efendiu, por e ka kryer te Mulla Qazim Efendiu, në vitin 1949. Provimin e hifzit e ka dhënë përpara komisionit të përbërë nga hafizët: hfz. Abdurrahimi dhe hfz. Hasanit, në Shkup. Për kontributin e çmuar që ka dhënë në mësimin e Kur`ani Kerimit shumë brezave, në vitin 2007, nderohet me Mirënjohje nga Forumi Rinor Islam, për kontribut **të dalluar që ka dhënë në përgatitjen e një numri të konsidrueshëm të hafizëve të Kur`anit Fisnik.**[17]

Hfz *Ibrahim* ef. Prishtina, i biri i hfz. Jusufit

Sipas mbiemrit që mban kuptohet se është nga Prishtina. Ka qenë me shërbim në Stamboll. Sa ishte në Turqi, e kjo ishte koha përpara vitit 1887, tek hfz. Ibrahim Prishtina ka kryer hifzin hfz. Ibrahim ef. Maglajliq nga Bosnja. Hfz Maglajliq është reisu-l-ulema i Bosnje e Hercegovinës nga viti 1930 deri në vitin 1936.[18]

Hfz. (*Idrizi*) ef. Idrizi, 1936- 2005 – *Shkup*



Mësimet e para i kreu te hfz. Ibrahimi, në vitin 1947. Në vitin 1952, bashkë me vëllanë e vet, hfz. Ademin, hapin xhaminë në lagjen Dyqanxhik, ku shërben si imam. Pas tërmetit të Shkupit të vitit 1963, kur u rrënua xhamia e lagjës Dyqanxhik, hfz. Idirizi emërohet imam në xhaminë Jelen Kapan dhe shërben deri në vitin 1969, kur kjo xhami rrënohet me vendim të organeve të pushtetit komunist. Punoi imam dhe mual-lim e muhafiz edhe në

17. Po aty.
18. Hfz. Dr. Fadil Fazliq, *Hafizi u Bosni i Hecegovini u poslednjih 150 godina*, Sarajevo, 2006.

xhaminë Allaxha. Pas 47 vjetësh shërbimi në këtë institucion, në shtator të vitit 1999 del në pension. Në vitin 1981 ka marrë pjesë në garat e Kur'anit në Libi. Nga hfz. Idrizi shumë gjenerata morën dijen për Kur`ani Kerimin dhe disa prej tyre kanë nxënë hifzin, si hfz. Sabiti, hfz. Abdulbakiu, hfz. Atullahi, hfz. Bunjamini, hfz. Adnani etj. Ndërroi jetë më 17 nëntor të vitit 2005 dhe u varros në varrezat "Butell", në Shkup. [19]



*Hfz*. *Irfan* ef. Mehmedi, 1885-1964 - *Shkup*

U lind me 5 maj 1885 në lagjen Haxhi Kasam, në Shkup. Hifzin e kreu tek Arab hoxha në vitin 1903 në Shkup. Ka punuar imam në xhaminë Haxhi Kasam dhe Isa Beg. Ka qenë i ngarkuar edhe me detyrën e ofiqarit, si edhe mësues në Medresenë Isa Beg. Në vitet 1950 ka qenë anëtar i Kuvendit të vakfit, të Ulema Mexhlisit në Shkup dhe anëtar i komisionit të hifzit pranë Myftnisë së Shkupit. Ndërroi jetë më 26 shtator dhe u varros në varrezat "Butell" në Shkup.[20]



Hfz. *Isa* ef. Bekteshi, 1965 – Shkup

U lind në fshatin Tanushec –Shkup. Hifzin e kreu tek Idriz ef. Ibrahimi, imam i Allaxha xhamisë në Shkup. Hfz. Isa i fali taravihët me hatme të Kur`anit. Përveç në xhaminë Mehmet Çelebi në Shkup, namazin e teravihëve e ka falur me hatme edhe në Sarajevë në xhaminë Terzi Basha. Nga viti 1990 punon imam në xhaminë Allaxha në Shkup. Te hafiz Isa kanë kryer hifzin: hfz. Reshati, hfz. Llukman Arifi, hfz. Muhsin Sulejmani dhe

19. H*afizët tanë gjatë historisë.....*
20. Po aty.

hfz. Imer Iseni. Ka qenë anëtar i komisionit për hifz në Myftininë e Shkupit për një periudhë dyvjeçare.[21]



Hfz. *Izet ef. Zenuni,* 1909-1973 - *Gostivar*

U lind në Debresh të Gostivarit. Hifzin e kreu te hfz. Sulejmani i Koxhaxhikut në vitin 1922. Për shkak të pikëpamjeve të tij politike antikomuniste, ishte i ndjekur nga organet e pushtetit komunist. Ka qenë i burgour politik. Në bashkëpunim me Ahmet Peron, hapi shkollën shqipe në Gostivar. Ishte muhafiz i rreth tridhjetë hafizëve. Ka qenë edhe kryetar i Vakfit në Gostivar.[22] Ndërroi jetë dhe u varros në vitin 1973, në Gostivar.

Hfz. *Jusuf* ef. Kelmendi, 1876-1943 - *Shkodër*

U lind në Dudas, Shkodër. Hifzin e kreu te hfz. Halid Bushati. Pas mejtepit vazhdoi mësimet në Medresenë e Pazarit të vjetër dhe pastaj vazhdoi studimet në Stamboll. Pas kryerjes së studimeve, kthehet në Shkodër dhe fillon punën si imam në xhaminë e Bardhë, lagjja Perash. Shërbeu edhe në xhami të tjera si imam, madje ishte edhe kryeimam në Shkodër. [23]

Hfz. *Jahja ef. Abazi,* 1927- 2007 - *Tetovë*

U lind në fshatin Çollopek – Tetovë. Hifzin e kreu në vitin 1946 te hfz. Ahmet Shatoku në Tetovë, ndërsa në vitin 1966 iu nënshtrua provimit të hifzit edhe para komisionit të Kryesisë së Bashkësisë Islame të Maqedonisë në përbërje nga hfz. Kamil Abazi, hfz. Shaban Salih dhe hfz. Sami Nebiu.

21. Po aty.
22. Po aty.
23. Smajl Bala, *Instituionet Islame dhe Hoxhallarët e Shkodrës*, Shkodër, 2005.

Ka falur teravihët me hatme në Bosnjë. Këndonte mukabele edhe në xhaminë e fshatit deri në vitet 2000, me Kur`an të mbyllur. Ajo që e bën të veçantë Hfz. Jahjanë është fakti se me Kur`anin të hapur nuk mund të këndonte mukabele. Këtë formë të memorizimit të Kur`anit e ka dëshmuar edhe në kohë të vona përpara kolegëve të tij hafizë, hfz. Qebiri me shokë, të cilët e përcillnin me Kur`an hapur. Te hfz. Jahja kanë kryer hifzin shumë kandidatë, ndër të cilët edhe dy hafize.[24]



Hfz. *Jakup ef. Jakupi,* 1952 - *Gostivar*

Kreu hifzin te hfz. Kamber Kamberi në Banjicë në vitin 1963. Nga viti 1974 punon imam në xhaminë e Sahatit në Gostivar. Ka nxjerrë dy hafizë: hfz. Arafatin dhe Muhamedali Shabanin. [25]



Hfz. *Jusuf ef. Abdullahu, 1946 – Kumanovë*

U lind në fshatin Hotël-Kumanovë. Në vendlindje kreu shkollën fillore, kurse hifzin e filloi te babai i tij, por e kreu në vitin 1962 te hfz. Besim Abazi. Nga viti 1978 jetoi në Shkup dhe punoi imam në xhaminë Mehmet Çelebi nga viti 1989-1993. Në vitin 1993 kalon me detyrë të imamit në xhaminë Isa Beg, në Shkup. Është anëtar i komisionit të hifzit në Myftininë e Shkupit.[26]

24. *Hafizët tanë gjatë historisë....* Prishtinë , 2010.
25. Po aty.
26. Po aty.



Hfz**.** *Kamber ef. Kamberi, 1918 - 2003 – Gostivar*

Hifzin e kreu në vitin 1924 te hfz. Hamdiu. Ndoqi mësimet islame te Qemal Efendija i Çegranit. Ka shërbyer imam në vendlindje dhe kultivoi me shumë sukses hifzin që dëshmohet me hafizët: hfz. Namik Shabani, hfz. Hëzëri, hfz. Rexhep dhe hfz. Shequr Kamberi, hfz. Feuzi Beqiri, hfz. Galib Sulejmani, hfz. Besir Imeri, hfz. Jakup Jakupi, hfz. Xhemil Abdiu, hfz. Rexhep Selimi dhe hfz. Abdusetar Kamberi. Emigroi në Turqi dhe atje ndërroi jetë në vitin 2003.[27]



Hfz**.** *Nexhati* ef. *Ahmedi,* 1910 - 1984 – Preshevë

Hifzin e kreu në vitn 1924 te hfz. Aliu. Ka vazhduar shkollimin në medresenë Meddah në Shkup. Në vitet 1980 ishte kryetar i Këshillit të Bashkësisë Islame në Preshevë. Nga hafiz Nexhati kanë mësuar hifzin një numër i madh hafizësh.[28]

Hfz. *Refi, ef. Ajeti,* 1930- 2011 – Kumanovë

Hifzin e kreu në vitin 1947 te hfz. Azizi, myfti i Shkupit. Është muhafiz i njohur në Maqedoni, tek i cili kanë mësuar hifzin shumë hafizë, përfshirë këtu edhe të birin hfz. Bajramin. [29]



Hfz**.** *Sabri ef. Bushati*, 1889- 1971 - Shkodër

Pas vitit 1913 merrte mësime nga dijetarët vendës: Haxhi Vehbi Dibra, hfz. Jusuf Kelmendi dhe Tahir Myftia, të cilët i kanë lëshuar

27. Po aty.
28. *Hafizët tanë gjatë historisë....* Prishtinë , 2010.
29. Po aty.

diplomën për kualifikim të lartë dhe hafiz i Kur`anit. Mësoi metodat e recitimit të Kur`anit nga hfz. Maliq Gakova. Punoi vaiz në xhamitë e qytetit, sidomos në xhaminë e Kuqe të Perashit. Ishte përkrahës i Hoxhë Kadri Prishtinës për Komitetin për Mbrojtjen e Kosovës dhe ka qenë delegat i Kongresit të Lushnjës në vitin 1920. Në vitin 1924 emërohet kryemyfti i Shkodrës. Ka shërbyer imam në Xhaminë e Kuqe, kurse në Xhaminë e Bardhë ka kryer detyrën e vazit deri në vitin 1967. Është dekoruar nga Presidenti i Shqipërisë, Sali Berisha me Urdhrin: *"Për veprimtari politike të Kl.I" me motivacionin "Për veprimtari të shquar politike në organizimin e mbarëvajtjes së punëve të Kongresit Kombëtar të Lushnjës.*[30]

Hfz. *Abdulxhemil* ef. Jusufi, (**Xhemil efendija**)
1853-1961, Tetovë

U lind në Tetovë, ku ka kryer edhe hifzin te haxhi Jusuf Lakushi, por kur shkon për të vazhduar shkollimin në Stamboll, kah vitet 1870, edhe një herë e verifikon hifzin në një afat prej gjashtë muajsh te hafiz Kamil Islambuli, imam në xhaminë Valide Sulltan në Aksraj. Vazhdoi studimet në Fatih, ku përvetësoi lëndët bazë të islamologjisë: Akaid, Fikh, tefsir, ilmu-l-kelam, hadith etj. Nga Ixhazetnameja e tij shihet se mori mësime nga dijetarët më të shquar të kohës, si hfz. Ibrahim bin Ali Timurhisari, Shejh Ismail ef. Konjevi, Haxhi Osman ef Razgadi dhe të tjerë. Kthehet në vendlindje pas rënies së halifatit osman dhe hap medresenë në lokalet e xhamisë së Pashës në Tetovë. Bashkë me vëllain e vet Bidajet efendiun kultivuan hifzin deri në përfundimin e Luftës së Dytë Botërore. Ndërroi jetë në vitin 1961 dhe u varros me nderime të mëdha në varrezat e qytetit në Tetovë. Nga hfz. Xhemil efendija kanë nxënë Kur`anin, kanë bërë

30. Smajl Bala, *Institucionet Islame....* Shkodër, 2005.

hifz, shumë kuadro nga Tetova, Gostivari dhe më gjerë. [31] Me nismën e hfz Xhemil efendiut në vitin 1940 fillon të këndohet hatme ditore në xhaminë e sahatit në Tetovë që vazhdon deri në ditët e sotme pa ndërprerje. Këtë e dëshmon një nga koordinatorët e gjallë të kësaj praktike, Hfz. Nurikemali, i cili jeton në këtë lagje të Tetovës.

Hfz**.** *Sadudin* ef. Murati, 1972 - Shkup



U lind me 30 shtator 1972. Hifzin e filloi te hfz. Fadil Aliti, në vitin 1985, kurse e përfundoi, krahas medresesë Isa Beg, te hfz. Shafi Osmani, në vitin 1990. *Për muajin Ramaza*n, në Jeni Pazar (Sanxhak) fal namazin e teravihut me hatme. Në vitin 1990 me rekomandim të Medresesë Isa Beg, si nxënës i asaj shkolle shkon *në Mostar – Bosnjë Hercegovinë, ku këndon mukabele në namazin e drekës dhe në* namazin e ikindisë. Studimet e Sheriatit i vazhdoi në Universitetin Zejtun në Tunis.[32]



Hfz. *Sadudin ef. Sulejmani, 1957 – Shkup*

Hifzin e kreu te imami i xhamisë Allaxha, Idriz Efendiu, **në vitin 1966. Deri në vitin 1984**, ka kënduar mukabele nëpër xhamit**ë** e Shkupit, sidomos në xhaminë Isa Beg. Në vitin 1984 emërohet imam dhe mual-lim në xhaminë "Murat Pashë". Deri në vitin 1991, ka pas shkuar edhe në Sarajevë për teravih namaz, **në xhamin Husrev Beg, kurse në vitin 1992 ka fal**ur teravihët me hatme në xhaminë Mehmet Çelebi. Në vitet 1994-1995 ka qenë imam Ramazani në Jeni Pazar (Sanxhak) në Arap xhami dhe Mellaiska.
Aktualisht është imam në xhaminë "Murat Pashë", ku fal namazin e akshamit dhe të jacisë me hatme. Në vitin 2005 dhe 2006 e ka falur edhe namazin e teravisë me

31. *Hafizët tanë gjatë historisë...*
32. Po aty.

hatme. Në vitin 1988, në Zagreb, fitoi vendin e parë për hifz, kurse në vitin 1989, vendin e dytë. Në vitin 1991 zuri vendin e tretë për hifz në garat ndërkombëtare që u mbajtën në Iran, kurse në vitin 1993 zuri vendin e katërt për të njëjtën disiplinë. Në vitin 1999, në garat e Kur`anit në Zagreb ishte anëtar i komisionit për hifz në nivel të Gadishullit Ilirik. Është anëtar i komisionit të hifzit në Myftininë e Shkupit.[33]



Hfz. *Sulejman ef. Shehapi, 1892 – 1948 - Tetovë*

***U*** lind në Tetovë. Hifzin dhe mësimet e para islame i mori te hfz. Xhemil Efendija. Vazhdoi studimet e mëtejshme në Turqi dhe për njëfarë kohe ka punuar në Stamboll. Kthehet në vendlindje në vitin 1921 dhe emërohet imam në xhaminë e Qarshisë së Epërme, ku shërbeu deri më 1945. Ishte myfti në Tetovë në vitet 1940 – 1942. Ka ushtruar edhe detyrën e Gjykatësit në Gjykatën e Tetovës në vitet 1939-45. Udhëhoqi medresenë e Qarshisë së Epërme. Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, kalon një kohë në Prizren, ku arrestohet në vitin 1948 dhe transferohet në burgun e Sarajevës. Prej atje e transferojnë në Burgun Hetues në Shkup, ku edhe ndërroi jetë. Xhenazja e tij mbetet fshehtësi edhe sot e kësaj dite.[34] Nga hfz. Sulejmani kanë nxënë Kur`anin në Tetovë, por edhe në Prizren.



Hfz. *Mustafa ef. Shemo, 1912-1991 – Shkup*

U lind në fshatin Nerez i Epërm - Shkup. Hifzin e kreu te Arab Hoxha, bashkë me hfz. Abdurrahimin dhe hfz. Hysenin. Ka kryer medresenë Meddah në Shkup. Nga viti 1934 punon imam dhe vaiz në vendlindje. Ka ushtruar me sukses edhe

33. Po aty.
34. Po aty.

detyrën e muhafizit, nga i cili mësuan Kur'anin: hfz. Mustafa nga Prilepi, hfz. Halimi nga Sallareva, hfz. Rifati nga Saraji. Në vitet 1960-1967 punoi në Institutin e Historisë në Shkup, si ekspert i leximit të dokumenteve osmane, prej nga jep dorëheqje dhe kthehet përsëri në fshatin e lindjes në detyrën e imamit. Ka qenë anëtar i komisionit të Hifzit në myftininë e Shkupit. Ndërroi jetë me 8 prill dhe u varros në vendlindje.[35]



Hfz. *Zihni* ef. Ahmedi, 1932- 2009 – Preshevë Hifzin e kreu në vitin 1945 te hfz. Lutfi Ahmedi, kurse ixhazetin e ka marrë te hfz. Nexhat Ahmedi. Ka shërbyer imam në xhaminë Ibrahim Pasha në Preshevë dhe ua mësoi Kur`anin disa hafizëve. [36]

Hfz. *Taip* ef. Aliu, 1953 – Shkup

U lind me 20 qershor në fshatin Gërçec – Shkup. Hifzin e përfundoi në Shkup, në vitin 1970 te hfz. Idriz Shabani dhe e dëshmoi para komisionit: hfz. Shaban Sali, hfz. Ali Qahili dhe hfz. Hasan Lila. Në vitin 1980 ka kryer shkollën e mesme në Hums - Siri. Ka punuar imam, hatib, vaiz, por kontributi i tij më i rëndësishëm është si muhafiz. Ai ua ka mësur hifzin 21 hafizëve nga rajoni i Shkupit e më gjerë.[37] Ka qenë drejtor i kursit të hifzit në kuadër të Meshihatit të BIM. Gjithashtu ka qenë anëtar i komisionit të hifzit edhe në myftinitë e tjera të Republikës së Maqedonisë. Nga viti 1970 ka kënduar mukabele, me Kur`an të mbyllur, deri në vitin 1985 në tërë xhamitë e Shkupit.[38]

Është interesant fakti se përveç muhafizëve që u

35. Po aty.
36. Po aty.
37. Po aty.
38. *Hafizët tanë gjatë historisë...* Prishtinë, 2010 .

përmendën më lart, janë edhe dy muhafizë shqiptarë të cilët nuk janë hafizë të Kur`anit, por si muhafizë janë shumë të suksesshëm. Kanë arritur rezultate të shkëlqyeshme në kultivimin e hifzit te masat shqiptare. Këta dy janë: **Mulla Mahmut ef. Asllani** – Tetovë[39] dhe **Mulla Jakup ef. Hasipi** – Kumanovë.

*Mulla Mahmut ef. Asllani – 1932- Tetovë*

Është i lindur në fshatin Çiflik – Tetovë. Nga viti 1967 e deri sot, Mulla Mahmut efendi Asllani udhëheq shkollën e hifzit në Xhaminë e Pashës në Tetovë. Sado që nuk është emërtuar zyrtarisht si shkollë e hifzit, këtu Mulla Mahmuti e ka ditarin e hafizëve me pedanteri të rrallë, ku gjejmë shënimet për secilin hafiz që ka ndjekur dhe ka përfunduar hifzin përpara këtij muhafizi dhe përpara cilit komision e ka dëshmuar nxënien e Kur'anit, datën kur e ka filluar dhe datën kur e ka kryer. Në ditarin e tij ka edhe shënime për kandidatë që akoma nuk e kanë kryer hifzin, porse numri i atyre që kanë kryer hifzin te Mahmut Efendiu kalon numrin dyqind.

Hafizët e mulla Mahmutit, përfshirë këtu edhe djalin edhe mbesën e tij, janë të pajisur me diploma të hifzit, që ruhen edhe në administratën e myftinisë në Tetovë.[40]

*Mulla Jakup ef. Hasipi, 1954 – 2006 - Kumanovë*

Është i njohur si pjesëmarrës i Luftës së UÇK, të vitit 2000-2001 në Maqedoni, por edhe si pjesëmarrës i tribunave islame, duke filluar nga viti 1990 e deri në frymën e fundit të jetës së tij. Mulla Jakupin, opinioni islam shqiptar, e gjen sidomos gjatë muajit Ramazan në tribunat e organizuara në Shkup, në Shkodër, Kumanovë-Kaçanik

39. Feti Mehdiu, Tradita treshekullore e hifzit dhe hafizët në hapësirën shqiptare 1667-2007, *Drita e Kur`anit*, nr. 1/2007, Tiranë.
40. Po aty. *Hafizët tanë gjatë historisë*.... Prishtinë, 2010, etj.

e Kërçovë; Prishtinë – Preshevë e Prizren; Tetovë e Tiranë, gjithkund ku kishte nevojë. Ky aktivitet i tij, disa qindra ligjërata nëpër tribuna, ruhet në videoinçizime dhe forma të tjera.

Ndërkaq, kontributi i tij si muhafiz është më pak i njohur. Në periudhën 1995 – 2000, te Mulla Jakup Hasipi e kryen hifzin: hfz. Emine Ismaili, hfz. Haxhere Shahini, hfz. Zejnebe Shahini, hfz. Nesibe Hasipi, hfz. Rejhane Hasipi, hfz. Sizana Zymberi, hfz. Hamide Zamberi, hfz. Fatime Elezi, hfz. Ajshe Shahini etj.[41]

Dihet se disiplinat islame nuk e bëjnë dot asnjë hap pa Kur`anin. Prandaj, mendojmë se ata që i kanë kontribuar këtij segmenti më së shumti janë muhafizët (instruktorët) e Kur`anit Kerim.

Brezat që vijnë, me ndonjë rast jubilar, për 110 vjetor ose 120 vjetor do t`i ofrojnë opinionit shkencor kontribute më të hollësishme.

Nëse nuk i arrin të gjitha, mos i lër të gjitha, thoshte pejgamberi Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!).



41. Shih: Feti Mehdiu, *Hafizët tanë gjatë historisë*... Prishtinë, 2010; *Eduka Islame*, nr. 76/2005, Prishtinë.

**Xhemal Balla**

# Kur'ani, mrekulli e përjetshme e profetësisë së Muhamedit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)

Kur'ani i është shpallur profetit Muhamed për një periudhë kohore 23-vjeçare. Ai është mrekullia më madhore që është dhuruar nga Zoti i Madhërishëm, Krijuesi i çdo gjëje që ekziston dhe në fund, i njeriut, për ta udhëhequr atë në çështjet themelore të jetës, të një jete plot harmoni dhe paqe, në planin individual dhe në atë shoqëror. Është një vepër e intelektit universal, e një udhëheqjeje **të vetme jashtë arsyes dhe përvojës** njerëzore, që nëpërmjet tij, për mbarë njerëzimin, i shpalli profetit Muhamed fenë islame. ***"Sot përsosa për ju fenë tuaj, e plotësova dhuntinë time ndaj jush dhe zgjodha për ju Islamin fe."***[1]

Pra, Zoti është burimi i Islamit që nga lindja e shoqërisë së parë njerëzore, deri më sot, e do të vazhdojë deri në fund të kësaj bote. ***"Thuaj: Ne besojmë Allahun, atë që na është shpallur Neve, atë që i është shpallur Ibrahimit, Ismailit, Is'hakut, Jakubit e bijëve të tij dhe atë që i është dhënë Musait dhe Isait dhe profetëve nga Zoti i tyre. Ne nuk bëjmë kurrfarë dallimi midis tyre dhe ne vetëm Atij i përkasim."***[2]

Nga ajeti kuptohet se të gjithë profetët kanë përcjellë të njëjtin mesazh, atë të besimit të Një Zoti, mesazhin e Islamit, të paqes dhe të mëshirës. Është ky Kur'an që kanë në duar myslimanët e mbarë botës, është fjala

1. "El-Maide", 3.
2. "Al-Imran", 84.

e mrekullueshme e Zotit Fuqiplotë, që iu shpall profetit Muhamed në muajin e shenjtë të Ramazanit dhe u shkrua për t'ua transmetuar brezave pasardhës. ***"Muaji Ramazanit është ai, në të cilin ka zbritur Kur'ani, që është udhërrëfyesi për njerëz plot me shenja të qarta për rrugën e drejtë dhe dallues i së mirës nga e keqja."***[3]

Duke studiuar Kur'anin gjejmë dallimin e së vërtetës nga e pavërteta, një udhëzim i Zotit që e çon njeriun drejt një sigurie në këtë jetë sprove provizore, për t'u integruar në shoqëri pa asnjë dallim. Ky është Islami që Kur'ani e shpall si të vetmen alternativë në mënyrën e ndryshme jetësore, për të përmbushur qëllimin e krijimit të tij nga fuqia absolute e Zotit. ***"Ne nuk e kemi krijuar kot qiellin, tokën dhe çfarë ndodhet midis tyre."***[4]

**Çdo njeri që vë arsyen si baraspeshë në veprimet e tij, gjykon sipas Kur'anit, i cili të bën thirrje dhe të këshillon gjithmonë për të vërtetën. Ai është një mjet bashkimi i** të gjitha dimensioneve të qenies njerëzore, i v**ëllazërimit, pa dallim gjinie,** race e ngjyre. Në Kur'an përfshihen të gjitha llojet e diturive, si fetare, ashtu dhe shpirtërore, si shoqërore, ashtu dhe shkencore, etiko-morale, ligjore e filozofike. Në të vërtetohet me saktësi ekzistenca e Një Zoti të Vetëm, të dërguarve të Tij, historia e popujve dhe gjithmonë këshilla për vendosjen e drejtësisë në to, pa lënë mënjanë edhe përgjegjësinë në botën e përtejme për ata që largohen nga rruga e tij.

Besimtarët islam që e kanë **në duar Kur'anin, kur ta shfle**tojnë do të gjejnë parimet bazë të besimit, rregullat që kanë të bëjnë me jetën e çdo njeriu e në veçanti të myslimanit, normat morale të çdo njeriu në marrëdhëniet me të tjerët, deklaratën për të drejtat universale, për familjen, barazinë gjinore etj. Por ai nuk lë mbas dore dhe argumentat shkencore, vrojtimin, zbulimin dhe argumenti-

3. "Bekare", 185.
4. "Sad", 27.

min logjik se ka një Krijues mbi gjithçka, që i ka bërë në mënyrë të përsosur, që nuk ka mjet në botë të arrijë këtë harmoni universale. Nga ana tjetër, për lexuesit e rregullt të Kur'anit, ai është burim shërimi, një terapi e sëmundjeve psikologjike dhe me të cilët pacienti do të gjejë qetësi shpirtërore. Vargjet e tij plot ndjenjë e emocion, me një elokuencë të jashtëzakonshme do të prekin ndërgjegjen, shpirtin e çdo besimtari, do t'i japin shpresë e siguri në jetë, do ta largojnë nga pesimizmi, duke i dhënë siguri në përballimin e çdo vështirësie. Gjuha e shpalljes është arabishtja, që përbën trupin e jashtëm të Kur'anit, por brendësia është fjala e Zotit **që depërton nëpër të gjitha qelizat ndjesore të trupit duke ushqyer mendjen dhe shpirtin me dashurinë dhe mëshirën që ka nevojë çdo besimtar. Asnjë sistem shoqëror nuk mund të premtojë lumturi të përjetshme ashtu siç premton Kur'ani**, sepse kjo jetë është e kufizuar bashkë me sistemet e saj. Ndërsa myslimanit i garantohet jeta e pasosur për të cilën Kur'ani porosit: "Të Zotit jeni dhe tek Ai do të ktheheni."

Lexuesit e Kur'anit do të gjejnë në të një parim shumë të rëndësishëm për qenien njerëzore, që duhet ta shoqërojë në këtë botë. Ky është djepi i vëllazërimit që duhet të përkundi të gjithë njerëzit pa dallim, duke i larguar nga luftërat, vrasjet, krimet, hakmarrjet etj. për të jetuar në paqe e harmoni këtë jetë të çmueshme që Zoti i dhuroi njeriut për këtë botë. Kur'ani mbetet aktual për të sotmen e të ardhmen. Parimi themelor i drejtësisë që e karakterizon atë, është domosdoshmëri të zbatohet nga të gjitha organet drejtuese administrative, shoqërore e familjare. ***"Kushdo që vret një njeri pa të drejtë, konsiderohet sikur të kishte vrarë gjithë njerëzimin."***[5]

Pastaj vijnë shumë parime të tjera që ruajnë të pastër familjen, shoqërinë e shtetin, duke ndaluar përdorimin e alkolit, drogës, prostitucionit, trafikimit, marrëdhëniet

5. “El-Maide”, 32.

intime jashtëmartesore etj. Këto janë shqetësime sot në shoqërinë tonë dhe kërkojnë bashkimin në unitet **të të gjithë institucioneve qeveritare e jo**qeveritare me në krye familjen, për të parandaluar këto fenomene negative që degjenerojnë familjen e shoqërinë.

Duke iu rikthyer besimit me në krye Kur'anin do të gjejmë forca për t'i parandaluar, sepse në të do gjejmë dashurinë e Zotit, që nëpërmjet vetëdijes së njohjes së Tij, marrin premtimin për një jetë më të lumtur e të pasosur, por njëkohësisht, dhe pasojat për njerëzit që përfshihen në këto sende të ndaluara. Kjo kërkon një besim të shoqëruar me bindje, për të bërë të mundur zbatimin e urdhrave të Kur'anit, që i bën besimtarët të jenë të palëkundur nga tundimet e pasioneve të shfrenuara që shkatërrojnë moralin e njeriut. Profeti Muhamed që mbarti shpalljen e Zotit dhe e përcolli me saktësi të vërtetë tha: "Jam i D**ërg**uar të përsos moralin njerëzor."

Këtë e kupton dhe duhet ta zbatojë çdo besimtar pa dallim gjinie, i cili ka pranuar deklaratën e hyrjes në islam dhe që pohon se: "Nuk ka Zot tjetër, veç Allahut dhe Muhamedi është i D**ërguari i** Tij."

Kjo dëshmi bën thirrje dhe të detyron për një mënyrë jetese të pastër në përputhje me ligjet e fesë, duke iu nënshtruar vullnetit **të** Zotit me ndërgjegje të plotë e të lirë. Kur'ani i porosit besimtarët, që në çdo moment e rrethanë të ndodhur, të ruajnë e ta mbajnë të pastër besimin e tyre, për të mos rënë në gabime nga joshjet e çastit. ***"O ju që besuat! Besoni Allahun, të Dërguarin e tij, Librin që i ka zbritur të Dërguarit të Tij dhe librat që kanë zbritur më parë. Kushdo që mohon Allahun, engjëjt e Tij, librat e Tij, të dërguarit e Tij dhe botën tjetër, ai, me të vërtetë, ka humbur nga udha e drejtë."***[6]

Në këtë ajet tregohet se si duhet të jetë besimtari me cilësitë e tij. Por, nuk mjafton me kaq, sepse ai duhet të

6. "En-Nisa", 136.

mbartë në vetvete nivele dhe shkallë të shumta duke filluar që nga perceptimi i thjeshtë, i bazuar mbi arsyen dhe pohimin me zemër, e deri tek gradat e depërtimit në të gjitha organet e trupit që ai kontrollon, si dhe shkallët që drejtojnë gjithë jetën e tij, me bindje ndaj urdhrave të Kur'anit dhe zbatimin në praktikë t**ë** adhurimit ndaj Zotit Fuqiplot**ë**.

Muhamedi ka ndërruar jetë, por mesazhi dhe shembulli i tij janë gjallë. Kur'ani fisnik mbetet kod jetësor për ndjekësit e tij, që e ndoqën, po e ndjekin dhe do ta ndjekin me besnikëri. M**ësimet e tij do t'i paraprijnë përparimit të shoqërisë, në zhvillimin e shkencës e** t**ë** kulturës, të cilat do ta mbajnë gjallë famën e këtij profeti të madh të njerëzimit.

Paqja e bekimi i Zotit qoftë mbi Muhamedin!

# Bibliografi per Kur’anin në revistat “Zani i Naltë”, “Njeriu” dhe “Kultura Islame

| | | |
|---|---|---|
| Hafiz Ali Korça | Tefsiri i sures El-Ihlas | Viti I Nr 3, tetor 1923 fq 75-77 |
| Hafiz Ali Korça | Tefsiri i sures Muanit | Viti I Nr 5, Fruer 1924 fq 131-136 |
| Hafiz Ali Korça | Tefsiri i sures Nasër | Viti I Nr 6, mars 1924 fq 163-169 |
| Hafiz Ali Korça | Tefsiri i sures Kadirit | Viti I Nr 7, Prill 1924 fq 195-202 |
| Hafiz Ali Korça | Tefsiri i sures Fatiha | Viti I Nr 8, Maj 1924 fq 228-238 |
| Hafiz Ali Korça | Tefsiri i sures | Viti I Nr 9, Qeshor 1924 fq 261-266 |
| Hafiz Ali Korça | Tefsiri i sures Humeze | Viti I Nr 10, Korrik 1924 fq 291- 296 |
| Hafiz Ali Korça | Tefsiri i sures Fil | Viti I Nr 11, Gusht 1924, fq 328-336 |
| Hafiz Ali Korça | Tefsiri i sures Alak | Viti I Nr 12, Shtator 1924 fq 355-330 |
| Kryemif-tiu Vehbi | Tefsiri i sures | Viti II Nr 12, Shtator 1924 fq 384 |
| Nr Hafiz Ali Korça | Nr Porositëm lexuesit të mos lexojnë nga përkthimet e Kur’anit | Viti II Nr 1, Mars 1925 fq 401-402 |
| Shefqet Dain | Tefsiri mbi Kumtesën muslimane | Viti III Nr 3 Maj 1925 fq 465-446 |
| Hafiz Ali Korça | Përmbi një ajet të sures Jusuf | Viti IV Nr 5, 1926 131-138 |

| | | |
|---|---|---|
| Hafiz Ali Korça | Tefsiri i sures Zibrailit | Viti IV Nr 6, 1927, 163-167 |
| Hafiz Ali Korça | Tefsiri i sures Zibrailit | Viti IV Nr 8, Mars 1927, fq 228-236 |
| Hafiz Ali Korça | Tefsiri i sures Duha | Viti IV Nr 10, Maj 1927 fq 299-304 |
| Hafiz Ali Korça | Tefsiri përmbi ajetin që tregon profetësinë e përgjithshme të Profetit Muhamed | |
| Hafiz Ali Korça | Tefsiri përmbi ajetin që… | Viti IV Nr 11, Qeshor 1927 fq 324-326 |
| Hafiz Ali Korça | Tefsiri përmbi ajetin që… | Viti IV Nr 12, Korrik 1927 fq 364-372 |
| Hafiz Ali Korça | Tefsiri përmbi ajetin që… | Viti IV Nr 1, Nëndor 1927 404-405 |
| Hafiz Ali Korça | Tefsiri përmbi ajetin që… | Viti V Nr 2, Shtator 1927 420-424 |
| Hafiz Ali Korça | Tefsiri përmbi ajetin që… | Viti V Nr 3, ….... 1928 fq 447 |
| Hafiz Ali Korça | Tefsiri përmbi ajetin që… | Viti V Nr 4……. 1928 fq 479-488 |
| Hafiz Ali Korça | Tefsiri përmbi ajetin që… | Viti V Nr 6, Prill 1928 fq 1928 f 543-550 |
| Hafiz Ali Korça | Tefsiri përmbi ajetin që… | Viti V Nr 7, Maj 1928 fq 569-575 |
| Hafiz Ali Korça | Tefsiri përmbi ajetin që… | Viti VI Nr 9, Korrik 1928 fq 635-640 |
| Hafiz Ali Korça | Tefsiri i sures Felek | Viti VI Nr 2, …… 1929 fq 774-180 |
| Hafiz Ali Korça | Tefsiri i sures Nas | Viti VI Nr 3, Mars 1929 fq 794-800 |

| | | |
|---|---|---|
| Hafiz Ali Korça | Tefsiri i sures Tin | Viti VI Nr 4, Prill 1929 fq 825-833 |
| Junuz Buluqi | Ç'asht Kur'ani I | Viti VI Nr 1……. 1929 fq 871-873 |
| J u n u z Buluqi | Ç'asht Kur'ani II | Viti VI Nr 2 ….. 1930 fq 897-903 |
| Junuz Buluqi | Ç'asht Kur'ani III | Viti VI Nr 3 …. 1930 fq 930-934 |
| Junuz Buluqi | Bota Islame nën dritën e Kur'anit | Viti VI Nr 11-12 Tetor - Nentor 1930 fq 120 |
| ? | Ç'na urdhëron Kur'ani | Viti VI Nr 2 Tetor 1931 fq 42-47 |
| ? | Ç'na urdhëron Kur'ani | Viti VI Nr 3 Nëntor 1931 fq 80-85 |
| ? | Ç'na urdhëron Kur'ani | Viti VI nr 5 …. 1931 fq 108-110 |
| Vehbi Demiraj | Ç'na urdhëron Kur'ani | Viti VI Nr 6 Fruex 1932 fq 142-146 |
| Hafiz Shaqir Oruri | Ç'na urdhëron Kur'ani si e kane perfytyruar europianet | Viti VI Nr 9 -10, Maj-Qeshor fq 239-256 |
| ? | Ç'na urdhëron Kur'ani përmendia në Kur'an | Viti VI Nr 11 Korrik 1932 fq 306-322 |
| Haran Selami | Ç'na urdhëron Kur'ani | Viti VI Nr 12 Gusht 1932 fq 350-357 |
| ? | Ç'na urdhëron Kur'ani | Viti VIII Nr 1 Shtator 1932 fq 381-394 |
| Hafiz Ismet Dibra | Ç'asht Kur'ani | Viti VIII Nr 2 Tetor 1932 fq 432-439 |

| | | |
|---|---|---|
| Vehbi Dibra | Ç'asht Kur'ani | Viti VIII Nr 4-5 kalema Frur 1933 448-508 |
| Salih Vuntermi | Ç'asht Kur'ani | Viti VIII Nr 4-5 kalema Frur 1933 509-512 |
| Hafiz Ismet Dibra | Hytbe për fillimin e Kur'anit | Viti VIII Nr 4-5 kalema Frur 1933 513-519 |
| Hafiz Qazim Ismaili | Ç'asht Kur'ani | Viti VIII Nr 4-5 kalema Frur 1933 524-530 |
| Hafiz Qazim Ismaili | Ç'na urdhëron Kur'ani (nga varri i V,Didrës) | Viti VIII Nr 4-5 kalema Frur 1933 520-523 |
| Vehbi Dibra | Ç'na urdhëron Kur'ani | Viti VIII Nr 7, Mars 1933 fq 565 |
| Vehbi Dibra | Ç'na urdhëron Kur'ani pjesa e II | Viti VIII Nr 8 Prill 1933 fq 598-603 |
| Vehbi Dibra | Ç'na urdhëron Kur'ani pjesa e III | Viti VIII Nr 9 Maj 1933 fq 629-635 |
| Vehbi Dibra | Ç'na urdhëron Kur'ani pjesa e IV | Viti VIII Nr 12 Gusht 1933 fq 733-741 |
| Vehbi Dibra | Ç'na urdhëron Kur'ani Pjesa e V | Viti IX Nr 1 Shtator 1933 fq fq 3-15 |
| Vehbi Dibra | Ç'na urdhëron Kur'ani pjesa VI | Viti IX Nr 2-3 Tetor-Nëntor 1933 fq fq 35-41 |
| Vehbi Dibra | Ç'na urdhëron Kur'ani pjesa e VII | Viti IX Nr 4-5 Shtator 1933-34 fq fq 105-114 |
| | | |

| | | |
|---|---|---|
| Vehbi Dibra | Ç'na urdhëron Kur'ani pjesa e VIII | Viti IX Shkurt, Mars 1934 fq 169-176 |
| | | |
| Vehbi Dibra | Ç'na urdhëron Kur'ani pjesa e IX | Viti IX Nr 8-9, Prill-Maj 1934 fq 338-345 |
| Hafiz Ali Korça | Thelbi i Kur'anit (kap Fatiha) | Viti IX Nr 8-9, Prill-Maj, 1934 fq 375-378 |

## Në revistat "Kultura Islame"

| | | |
|---|---|---|
| Sadik Bega | Kur'ani dhe Letersia | Viti i I Nr 2 Tetor 1939 fq 53-57 |
| Sadik Bega | Ç'zëvëndëson Kurani nga pikpamja Legjislative I | Viti i I Nr 1 Shtator 1939 fq 20-29 |
| Sadik Bega | Ç'zëvëndëson Kurani nga pikpamja Legjislative II | Viti i I Nr 2 Tetor 1939 fq 58-64 |
| Sadik Bega | Ç'zëvëndëson Kurani nga pikpamja Legjislative III | Viti i I Nr 3 Nëntor 1939 fq 87-92 |
| Sadik Bega | Ç'zëvëndëson Kurani nga pikpamja Legjislative IV | Viti i I Nr 5 Kallmua 1940 fq 167-172 |
| Ferid Vokopola | Surja e Agimit | Viti i I Nr 5 Kallmua 1940 fq 194-195 |
| Sadik Bega | Ç'zëvëndëson Kurani nga pikpamja Legjislative IV | Viti i I Nr 6-7 Shkurt-Mars Fq 1940 fq 243-253 |
| Ali Kazazi | Tefsiri i sures Asr | Viti i I Nr 6-7 Shkurt-Mars Fq 1940 fq 276-279 |

| | | |
|---|---|---|
| Sadik Bega | Ç'zëvëndëson Kurani nga pikpamja Legjislative VI | Viti i I Nr 10-11 Qeshor-Korrik 1940 fq 376-384 |
| Muslimani | Kur;ani dhe Umeri | Viti i I Nr 12 Gusht 1940 fq 458-463 |
| Sadik Bega | Ç'zëvëndëson Kurani nga pikpamja Legjislative VII | |
| | Lutemi të na tregoni shprehimisht.: "Kur'ani a Ashit" | Viti i II Nr 15 Nëntor 1940 fq 71-74 |
| Sadik Bega | Fjala parandisa: Përgjigje (pjesa e parë) | Viti i II Nr 16 Shtator 1940 fq 86-89 |
| Përkthim | Lutemi të na tregoni "Kur'ani asht fjla e perësndisë" | Viti i III Nr 23-24 Korrik-Gusht 1941 fq 243 |
| | Pjesë Kur'anore: kapitulli 130 koha (El Asr) | Viti i III Nr 8-9 Prill-Maj 1942 fq 239 |
| Readksia e F.k | Versete Kur'anore | Viti i III Nr 12 Prill-Maj 1942 fq 283-284 |
| Readksia e F.k | Kur'ani shqip | Viti i III Nr 12 Gusht 1942 fq 341-347 |
| Sadik Bega | Mirësia sipas Kur'anit të shenjtë | Viti i IV Nr 3-7, Gusht 1942 fq 352-356 |
| H.Sh (Haki Shafafi F.K) | Fleta e tefsirit. Tefsiri i kur'anit (El Bekare verseti 21) | Viti i IV Nr 3-7, Shkurt-Mars 1942, fq 49-53 |
| | Pjesë edukative. Pjesë ng Kur'ani Mbi bamirësinë | Viti i IV Nr 3-7 Janar Shkurt Mars 1943 fq 99-105 |

| | | |
|---|---|---|
| | Flota kuranore. Tefsiri i Kur'anit (ajeti 29 El Bekare ) | Viti i IV Nr 8 Prill 1943, fq 94-100 |
| H.Sh (Haki Shafafi F.K) | Tefsiri i Kur'anit (kapitulli II El Bekare ajeti 164) | Viti i IV Nr 9-10, Maj-Qeshor 1943 fq 125-127 |

**Kur'ani në revistën "Kultura Islame"**

| | | |
|---|---|---|
| | Tefsiri i Kur'anit (kaptina 50 ajeti 38) | V.IV Nr 11, korrik 1943 fq 179-150 |
| | Tefsiri i Kur'anit (1, kaptina 50 verseti 38) | V.IV Nr 12, Gusht 1943 fq 206-209 |
| H.SH | Shiko edhe: Shoh Muharrem Mitrovica Revista "Njeriu" | |
| | Apagohet faqja islame me shkencën rreth vjetores" ("Njeriu " viti i II Nr 2-14, Gusht 1943, faqja 9-10) | |
| H.SH | Tefsiri i Kur'anit verseti 50\38, 7\54, 25\59 10\3, 11:7, 32:4, 57:4 | V.V Nr 1-49, Shtator 1943 fq 3-8 |
| | Flota e Tefsirit. Tefsiri i Kur'anit (5:32) | V.V Nr Nr 2-3, Kallmar-Freuar 1944, fq 125-128 |
| H.SH | Flota e Tefsirit. Tefsiri i Kur'anit | V.V Nr 4 (52), Shtator 1943 fq 99-102 |
| | Flota e Tefsirit. Tefsiri i Kur'anit (5:67) | V.V Nr 5-6 (53-54) Mars-Prill 1944, fq 173-179 |

| | | |
|---|---|---|
| | Tefsiri i Kur'anit: Kap 23, versete 12, 13, 14 | V.V Nr 7-8 (55-56), Maj 1944 fq 247-250 |
| Haki Sharafi | Tefsiri i Kur'anit, kaptina El Baked | V.V Nr 9 (57) , Qeshor 1944 fq 272-277 |
| | Tefsiri i Kur'anit, (sure 8, ajeti 45, 46, 47, e 60) | V.V Nr 10 (58), Korrik 1944 fq 296-297 |
| Haki Sharafi | Tefsiri i Kur'anit, (sure 44, ajeti 1-6) | V.V Nr 11 (59), Gusht 1944 fq 137 |
| | Tefsiri i Kur'anit, (2:185) | V.V Nr 12 (60), Gusht 1944 fq 137 |
| | Kaptina e Kadrit | V.V Nr 12 (60) Tetor 1944 fq 34-35 |
| Sadik Bega | Tefsiri i Kur'anit, kaptina XCIV (94) | V.V Nr 2 (62), Tetor 1944 fq 34-35 |
| | El Inshiran | |
| | Kur'ani dhe Morali | Viti. VI Nr 3-4 (63-64) Prill 1945 fq 68 |
| | Tefsiri i Kur'anit, Ver-seti El Fatiha verseti 1-7 | Viti VI 5-8 (63-68), Maj-Gusht fq 76-78 |
| | Komentimi i Kur'anit verseti 285 i El Bekare | Viti VI Nr 9 (69), Shtator 1945, fq 115 |
| | Sistetmi moral ne Kur'an cakton kundër-shtimin në siste-min moral që nuk mbështet në dobi dhe ne vetitë e interes | V.VI nr 10-11, tetor 0Nentor 1945 fq 129-131 |
| | Flota e te komentuarit të Kur'anit El Emram ajeti 52 | v. VI Nr 10-11, tetor -Nentor 1945 fq 131-132 |

| | | |
|---|---|---|
| | Flota e komentimit të Kur'anit , Kap. II ajeti 1-5 | V.VI Nr 12(70), Dhjetor 1945 fq 161-165 |
| | Flota e komentimit të Kur'anit , | V. VI Nr 1-2, Kalenduer-Shkurt 1946 fq 10-12 |

**Shenim:**

Revista "Njeriu" nuk ka botuar e shkruar lidhur me Kur'anin "Shoh Muharrem Mitrovica ka botuar një shkrim me titull "a pajtohet feja islame me shkencoren rreth vjetërsisë dhe ktijesës së botës" shiko vjetërsinë 12 vite II Nr 2 (14), gusht 1943, fq 9-10

**"Zani i Naltë" Kur'ani**

| | | |
|---|---|---|
| Junuz Buliqi | Ç'urdhëron Kur'ani (II) | V.XIII, NR 1-2, Kallmur-Fruer 1938, fq 4-7 |
| Sheh Qazim Hoxha | një lutje një falenderim, një mësim | V.XII, Nr 12, shtator 1937, fq 398 |
| Qazim Hoxha | Ç'urdhëron Kur'ani (III) | V. XIII, Nr 3, Mars 1938, fq 66-71 |
| Qazim hoxha | Ç'urdhëron Kur'ani (IV) | V.XIII, Nr 4, Prill 1938, fq 117-126 |
| Junuz Buliqi | Një falenderim dhe një mësim (Klerikun Atë Pelegrinin) | V.XIII, Nr 5, Prill 1938, fq 132-136 |
| Sheh Qazim Hoxha | Ç'urdhëron Kur'ani (V) | V.XIII, Nr 6 Qeshor 1938, fq 161-167 |

| | | |
|---|---|---|
| Sheh Qazim Hoxha | Ç'urdhëron Kur'ani (VI) | V.XIII, Nr 7, Korrik 1938, fq 208-210 |
| Mudariz Qazim Hoxha | Ç'urdhëron Kur'ani (VII) | V.XIII, Nr 8, Gusht 1938 fq 230-236 |
| Sheh Qazim Hoxha | Ç'urdhëron Kur'ani (VIII) | V.XIII, Nr 9, Shtator 1938, fq 260-262 |
| Sheh Qazim Hoxha | Ç'urdhëron Kur'ani (IX) | V.XIII, Nr 10-11, Tetor-Nentor 1938, fq 290-300 |
| Sheh Qazim Hoxha | Ç'urdhëron Kur'ani (X) | V.XIII, Nr 12, Dhjetor 1938, fq 353-361 |
| Sheh Qazim Hoxha | Ç'urdhëron Kur'ani (I) vazi i mbajtur në Ramazan | V.XIV, Nr 1, Kallsuar 1939 fq 353-361 |
| Sheh Qazim Hoxha | Ç'urdhëron Kur'ani (nga vazi me xhami) | V.XIV, Nr2-3, Fruer-Mars 1939 fq 2-11 |
| Sheh Qazim Hoxha | Ç'urdhëron Kur'ani (III nga vazi) | V.XIV, Nr V.XIV, Nr Fruer-Mars 1939 fq 33-36 |
| Ferid Vokopola | perkthime hynore. Surja e Kijametit (poezi) | V.XIV, Nr 2-3 Fruer-Mars 1939 fq 47-48 |
| Abaz Xhapaj | Kur'ani në histori | V.XIV, Nr 2-3 Fruer-Mars 1939 fq 49-62 |
| hysni Hoxha | qytetëri Islam sipsa parashikimit të Kur'anit | V.XIV, Nr 2-3, Fruer-Mars 1939 fq 63-67 |

| | | |
|---|---|---|
| Ferid Voko-pola | Ç'urdhëron Kur'ani (nga vazi) | V.XIV, Nr 4, Prill 1939, fq 105- 116 |
| Sheh Qazim Hoxha | Ç'urdhëron Kur'ani (nga vazi) | V.XIV, Nr 5, Maj 1939, fq 137 |
| Sheh Qazim Hoxha | qytetëri Islam sipsa para-shikimit të Kur'anit | V.XIV, Nr 5 Maj 1939, Fq 138-142 |
| Vehbi Dibra | Ç' urdhëron Kur'ani (X) | V.IX, Nr 10-11, Qeshor-Korrik 1934, fq 297-304 |
| H.Ali Korça | Thelbi i Kur'anit (IV) kap muzzemil | V.IX, Nr 10-11, Qeshor-Korrik 1934, fq 346-347 |
| Vehbi Dibra | Ç' urdhëron Kur'ani (XI) | V.IX, Nr 12, Gusht 1934, fq 368-376 |
| H.Ali Korça | Thelbi i Kur'anit (V) kap. El Mud0dehir (vija) | V.IX, Nr 12, Gusht 1934, fq 378-389 |
| Vehbi Dibra | Ç' urdhëron Kur'ani (XII) | V.IX, Nr 13-14, Shtator-Tetor, fq 395-402 |
| Vehbi Dibra | Ç' urdhëron Kur'ani (XIII) | V.IX, Nr 15, Nën-tor 1934 fq 463-470 |
| H.Ali Korça | Thelbi i Kur'anit kap. Mused Takvir | V.IX, Nr 15, Nën-tor 1934, fq 477-478 |
| Vehbi Dibra | Ç'urdhëron Kur'ani (XIV) | V.IX, Nr 16, Dhje-tor 1934, fq 489-495 |
| Vehbi Dibra | Ç' urdhëron Kur'ani (XV) | V. X, Nr 1, Kalen-duar 1935, fq 1-6 |

| | | |
|---|---|---|
| Haxhi Tahir Hallulli | Naltësia e Kur'anit | V. X, Nr 1, Kalenduar 1935, fq 18-19 |
| Vehbi Dibra | Ç' urdhëron Kur'ani (XVI) | V. X, Nr 2, Fruer 1935, fq 43 |
| Vehbi Dibra | Ç' urdhëron Kur'ani (XVII) | V. X, Nr 3, Mars 1935, fq 73-80 |
| Vehbi Dibra | Ç' urdhëron Kur'ani (XVIII) | V. X, Nr 4, Prill 1935, fq 97-102 |
| H.Ali Korça | Thelbi i Kur'anit (VII) kap. E Teqririt | V. X, Nr 5, Maj 1935, fq |
| Vehbi Dibra | Ç' urdhëron Kur'ani (XIX) | V. X, Nr 7, Korrik 1935 fq 193-197 |
| Vehbi Dibra | Ç' urdhëron Kur'ani (XX) | V. X, Nr 8, Gusht 1935, fq 229-230 |
| | Mrekullite e Kur'anit Kaptina e Rumit Surja XXX E Kur'amit | V. X, Nr 9-10, Shtator-Tetor 1935, fq 262-269 |
| | Kur'an 75 | V. X, Nr 11, Nëntor 1935, fq 324-333 |
| | Ç' urdhëron Kur'ani për kamatën | V. XI, Nr 2 Freur 1936, fq 38-39 |
| | Ç' urdhëron Kur'ani për fajdexhijtë | |
| | Ç' urdhëron Kur'ani ? | V. XI, Nr 3, Mars 1936, fq 69-67 |
| | Ç' urdhëron Kur'ani | V. XII, Nr 1, Kalenderuar 1937, fq 1-8 |
| Qazimi Hoxha | Ç' urdhëron Kur'ani (I) | V. XII, Nr 12 Dhjetir 1937 fq 369-372 |

| Nr | Autori | Titulli i shkrim-it | |
|---|---|---|---|
| 1 | Haxhi Ve-hbi Dibra | Hytbe e Parë | Viti I, Nr I, Tetor 1923, fq 10-13 |
| 2 | Hafiz Ali Korça | Tefsiri i sures Alak (Kultura kuranore) | Viti II, Nr 2, Prill 1925, fq 421-429 |
| 3 | Junuz Buliqi | Ç'asht Kur'ani | Viti VI, Nr 3, Fruer 1930, fq 930-934 |
| 4 | Junuz Buliqi | Bota islame në dritën e Kur'anit | V.VI, Nr 11-12,Tetor-Nëntor 1930, fq 1209-1211 |
| 5 | Sali Vuçi-termi | Ç'asht Kur'ani | V.VII, 4-5, Janar-Shkurt 1933, fq 513-519 |
| 6 | Hafiz Ismet Dibra | Ç'asht Kur'ani | V.VIII, 4-5, Janr-Shkurt 1933, fq 513-519 |
| 7 | H.Vehbi Dibra | Ç' urdhëron Kur'ani | V.X, Nr 1, Kalen-duar 1935, fq 1-6 |
| 8 | nuk është dhënë emir i autorit | Ç' urdhëron Kur'ani | V.XII, Nr I, Kalen-duar 1937, fq 1-8 |
| 9 | Redaksia e F.K | Mevlana Vehbi Dibra | V.XII, Nr 4, Prill 1937, Fq 98-120 |
| 10 | Redaksia e F.K | dy fjalë për 25 vjetorin Vet-eranët e Klerit Musliman | V.XII, Nr 11, Nën-dor 1937, fq 321-368 |
| 11 | Z.Qazim Hoxha | Ç' urdhëron Kur'ani (I) | V.XII, Nr 12, Shta-tor 1937, fq 369-372 |
| 12 | z.Qazim Hoxha | Ç' urdhëron Kur'ani (VI) | V.XIV, Nr 4, prill, 1937, fq 105-116 |

## “Zani i Naltë” për Kur’anin

| | | |
|---|---|---|
| Hafiz Ali Korça | Tefsiri i sures Ihlas | V. I, Nr 3, Dhjetor 1923, |
| Hafiz Ali Korça | Tefsiri i sures Muaminit | V. I, Nr 5, Fruer 1924 |
| Hafiz Ali Korça | Tefsiri i sures Naserit | V. I, Nr 6, Mars 1924 |
| Hafiz Ali Korça | Tefsiri i sures Kadrit | V. I, Nr 7, Prill 1924 |
| Hafiz Ali Korça | Tefsiri i sures Fatiha | V. I, Nr 8, Maj 1924 |
| Hafiz Ali Korça | Tefsiri i sures Teqthyr | V. I, Nr 9, Qeshor 1924 |
| Hafiz Ali Korça | Tefsiri i sures Humeze | V. I, Nr 10, Korrik 1924 |
| Hafiz Ali Korça | Tefsiri i sures Fil | V. I, Nr 11, Gusht 1924 |
| Hafiz Ali Korça | Tefsiri i sures Alak | V. I, Nr 12, Shtator 1924 |
| Kryemif-tiu Vehbi Dibra | Porositëm besimtarët të mos lexojnë nga përk-thimi i Kur’anit | V. I, Nr 12, Shtator 1924 |
| Hafiz Ali Korça | Tefsiri mbi kulturën muslimane | V. II, Nr 1,Mars 1925 |
| Shefqet Dalliu | Përmbi një ajete të surës Jusuf | V. II, Nr 3, Maj 1925 fq 465 |
| Hafiz Ali Korça | Tefsiri i sures Zilzazit | V. III, Nr 5, Dhjetor 1926 |
| Hafiz Ali Korça | Tefsiri i sures Zilzazit | V. VI, Nr 6, Kllmuer 1927 |
| Hafiz Ali Korça | Tefsiri i sures Duha | V. VI, Nr 8, Mars 1927 |

| | | |
|---|---|---|
| Hafiz Ali Korça | Tefsiri përmbi ajetin që tregon profetësinë e përgjithshme të H. Muhamedit | V. VI, Nr 10, Maj 1927 |
| Hafiz Ali Korça | Tefsiri përmbi ajetin që tregon profetësinë e përgjithshme të H. Muhamedit | |
| Hafiz Ali Korça | Tefsiri përmbi ajetin që tregon profetësinë e përgjithshme të H. Muhamedit | V. VI, Nr 11, Qeshor 1927 |
| Hafiz Ali Korça | Tefsiri përmbi ajetin që tregon profetësinë e përgjithshme të H. Muhamedit | V. VI, Nr 12, Korrik 1927 |
| Hafiz Ali Korça | Tefsiri përmbi ajetin që tregon profetësinë e përgjithshme të H. Muhamedit | V. VI, Nr 1, Nëntor 1927 |
| Hafiz Ali Korça | Tefsiri përmbi ajetin që tregon profetësinë e përgjithshme të H. Muhamedit | V. VI, Nr 2, Dhjetor 1927 |
| Hafiz Ali Korça | Tefsiri përmbi ajetin që tregon profetësinë e përgjithshme të H. Muhamedit | V. V, Nr 3, Kallmuer 1928 |
| Hafiz Ali Korça | Tefsiri përmbi ajetin që tregon profetësinë e përgjithshme të H. Muhamedit | V. V, Nr 4, Fruer 1928 |

| | | |
|---|---|---|
| Hafiz Ali Korça | Tefsiri përmbi ajetin që tregon profetësinë e përgjithshme të H. Muhamedit | V. V, Nr 6, Prill 1928 fq 543 |
| Hafiz Ali Korça | Tefsiri përmbi ajetin që tregon profetësinë e përgjithshme të H. Muhamedit | V. V, Nr 7, Maj 1928 |
| Hafiz Ali Korça | Tefsiri përmbi ajetin | V. V, Nr 9, Korrik 1928 fq 635 |
| Hafiz Ali Korça | Tefsiri përmbi ajetin | V. VI, Nr 2, Fruer 1929 fq 774-778 |
| Hafiz Ali Korça | Tefsiri përmbi ajetin | V. VI, Nr 3, Mars 1929 fq 794 |
| Hafiz Ali Korça | Tefsiri përmbi ajetin | V. VI, Nr 4, Prill 1929 fq 825 |
| Junuz Buliqi | Ç'asht Kur'ani I | V. VI, Nr 1, Dhjetor 1929 fq 871 |
| Junuz Buliqi | Ç'asht Kur'ani II | V. VI, Nr 2 Kalenuer 1930 fq 897 |
| Junuz Buliqi | Ç'asht Kur'ani pjesa e III | V. VI, Nr 3, Fruer 1930 |
| Junuz Buliqi | bota islame në dritën e Kur'anit | V. VI, Nr 11-12, Tetor-Nëntor 1930 |
| ? | Ç' urdhëron Kur'ani | V. VI, Nr 2, Tetor 1931 |
| ? | Ç' urdhëron Kur'ani | V. VI, Nr 3, Nëntor 1931 |
| ? | Ç' urdhëron Kur'ani | V. VI, Nr 5, Kalemuar 1931 |
| Veseli Demiraj | Ç' urdhëron Kur'ani | V. VI, Nr 6, Fruer 1932 |

| | | |
|---|---|---|
| Hafiz Shaqir Omur | Ç' urdhëron Kur'ani | V. VI, Nr 9-10, Maj-Qeshor 1932 |
| ? | Ç' urdhëron Kur'ani, si e kanë përfytyruar eyro-pianët | V. VI, Nr 11 Korrik 1932 |
| Hasan Selami | Ç' urdhëron Kur'ani Perëndia në Kur'an | V. VI, Nr 12, Gusht 1932 |
| ? | Ç' urdhëron Kur'ani | V. VIII, Nr 1, Shta-tor 1932 |
| Hafiz Is-met Dibra | Ç'urdhëron Kur'ani | V. VIII, Nr 2, Tetor 1932 |
| Vehbi Dibra | Ç'asht Kur'ani | V. VIII, Nr 4-5 Kalenuar-Fruru 1933 |
| Salih Vuçtetemi | Ç'asht Kur'ani | V. VIII, Nr 4-5 Kalenuar-Fruru 1933 |
| Ismet Dibra | Ç'asht Kur'ani | V. VIII, Nr 4-5 Kalenuar-Fruru 1933 |
| Hafiz Qazim Ismaili | Hytbe mbi Fillimin e Kur'anit | V. VIII, Nr 4-5 Kalenuar-Fruru 1933 |
| Muderriz Qazim Hoxha | Ç'asht Kur'ani | V. VIII, Nr 4-5 Kalenuar-Fruru 1933 |
| Vehbi Dibra | Ç'urdhëron Kur'ani (nga vazi i V.Dibrës) | V. VIII, Nr 7 , Mars 1933 |
| Vehbi Dibra | Ç'urdhëron Kur'ani II | V. VIII, Nr 8 Prill 1933 |
| Vehbi Dibra | Ç'urdhëron Kur'ani III | V. VIII, Nr 9 Maj 1933 |

| | | |
|---|---|---|
| Vehbi Dibra | Ç'urdhëron Kur'ani IV | V. VIII, Nr 12, Gusht 1933 |
| Vehbi Dibra | Ç'urdhëron Kur'ani V | V. IX, Nr 1, Shtator 1933 |
| Vehbi Dibra | Ç'urdhëron Kur'ani VI | V. IX, Nr 2-3, Tetor-Nëntor, 1933 |
| Vehbi Dibra | Ç'urdhëron Kur'ani VII | V. IX, Nr 4-5, Shtator-Klenduar 1933-1934 |
| Vehbi Dibra | Ç'urdhëron Kur'ani VIII | V. IX, Nr Shkurt-Mars 1934 |
| Vehbi Dibra | Ç'urdhëron Kur'ani IX | V. IX, Nr 8-9, Prill-Maj 1934 |
| Hafiz Ali Korça | Thelbi i Kur'anit kap. Fatiha | V. IX, Nr 8-9, Prill-Maj 1934 |

**Numri i shkrime për Kur'anin në revistën "Zani i Naltë"**

| | | |
|---|---|---|
| Vitin e I | 10 shkrime | 1923-1924 |
| Vitin e II | 2 shkrime | 1925 |
| Vitin e III | 1 shkrim | 1926 |
| Vitin e IV | 7 shkrime | 1927 |
| Vitin e V | 5 shkrime | 1928 |
| Vitin e VI | 14 shkrime | 1929, 1930, 1931, 1932 |
| Vitin e VII | | |
| Vitin e VIII | 11 shkrime | 1932, 1933 |
| Vitin e IX | 14 shkrime | 1933, 1934 |
| Vitin e X | 10 shkrime | 1935, 1936 |
| Vitin e XI | 2 shkrime | 1936 |
| Vitin e XII | 3 shkrime | 1937 |
| Vitin e XIII | 11shkrime | 1938 |
| Vitin e XIV | 8 shkrime | 1939 |

| | | |
|---|---|---|
| | 98 shkrime | |

**Nr i revistave në "Kultura Islame"**

| | | |
|---|---|---|
| I | 10 shkrime | 1939-1940 |
| II | 3 shkrime | 1940-1941 |
| II | 4 shkrime | 1941-1942 |
| IV | 6 shkrime | 1942-1943 |
| V | 10 shkrime | 1943-1944 |
| VI | 7 shkrime | 1944-1945 |
| VII | 2 shkrime | 1946 |
| Më shumë | 42 shkrime | |

**P**ërgatiti: **Faik Kasollja**

# نور قرآن


فصلنامه علمی قرآنی

صاحب امتیاز: مؤسسه قرآن کریم آلبانی

مدیر مسئول: محمد رضا حاج خضر

سردبیر: پروفسور دکتر خیری شهو

اعضای هیئت تحریریه:

پروفسور دکتر بدری دولوکو

پروفسور دکتر فتحی مهدیو — استاد دانشگاه پریشتینا (کوزوو)

حاج افندی سلیمان رجبی — رئیس مشیخه اسلامی کشور مقدونیه

حاج سلیم اسطفی

حاج یتمیر چیلا

شیخ ولنت مریا

ویرایش ادبی: خانم لیسیدا رامای

صفحه آرایی: فاتمیر هوتینا



شماره 2012/3 (21)

# KUJTESË PËR AUTORËT

Revista pranon me kënaqësi bashkëpunimin e të gjithë teologëve e të studiuesve të Kur'anit dhe të fushave të tjera të shkencës. Prandaj, janë të lutur autorët që të sjellin në redaksi artikuj studimorë që kanë të bëjnë me Kur'anin dhe kur'anologjinë.

Që të shqyrtohen artikujt nga redaksia, autorët janë të lutur të ndjekin udhëzimet e mëposhtme:

● Shkrimi nuk duhet të jetë më shumë se 10-12 faqe kompjuteri, bashkë me një abstrakt.

● Është e detyrueshme gjuha shqipe standarde.

● Nuk pranohet zëvendësimi i shkronjave ë dhe *ç* me e dhe *c*.

● Të mos përdoret shkronja e madhe I aty ku nuk duhet.

● Midis shenjës së pikësimit dhe fjalëve pasardhëse të lihet vetëm një hapësirë.

● Citimet në tekst të jepen me shkrim të pjerrët.

● Referencat në tekst të jepen me numra arabë dhe të numërohen sipas rendit që citohen. Ja, si mund të ishte një shembull citimi: Shih M. Golshani, *Kur'ani i Shenjtë dhe shkencat e natyrës*, Tiranë, 2007, f. 73. Librat e pabotuar e dorëshkrimet nuk citohen, por mund të jepen në tekst në kllapa.

● Artikulli të jetë i radhitur në "Word" dhe të dorëzohet në CD, USB ose të dërgohet nëpërmjet postës elektronike (e-mail): (f_quran114@yahoo.com).

● Shkrimi nuk duhet të jetë botuar askund tjetër.

● Shkrimi nënshkruhet nga autori dhe jepet adresa e plotë, numri i telefonit dhe e-maili.